

**ANALIZË LIGJORE  
MBI TË DREJTAT E  
PRONËSISË SË GRUAS  
NË ZONËN  
BREGDETARE TË  
JUGUT**

*Kjo analizë ligjore është përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të projektit me temë: “Provision of public survey and study on women’s rights to own and access property rights in the coastal area of southern Albania”, financuar nga OSCE Presence in Albania.*

## **PËRMBAJTJA**

### **KAPITULLI I: TË PËRGJITHSHME**

1. Hyrje
2. Qëllimi i Projektit
3. Qëllimi i dokumentit
4. Përmbajtja e dokumentit

### **KAPITULLI II: EVOLUCIONI I TË DREJTËS SË PRONËSISË DHE GRUAJA SI SUBJEKT I MARRËDHËNIEVE SHOQËRORE DHE JURIDIKO-CIVILE TË PRONËSISË**

1. Gruaja si subjekt i marrëdhënieve shoqërore dhe juridiko-civile në zonën bregdetare jugore
  - i. Karakteristikat gjeografike të zonës;
  - ii. Zhvillimi ekonomik dhe social i zonës;
  - iii. Pozicioni i gruas në familje dhe shoqëri;
2. Të drejtat pronësisë së gruas, sipas të drejtës zakonore Shqiptare (Kanuni i Labërisë )
3. Të drejtat pronësisë së gruas pas viti 1912 dhe deri në vitin 1929
4. Regjimi i Zogut: Kodi Civil i Zogut 1929-1944
5. E drejta Socialiste 1944-1990

### **KAPITULLI III: GRUAJA SI SUBJEKT I MARRËDHËNIES JURIDIKE CIVILE TË PRONËSISË NË REGJIMIN DEMOKRATIK**

Hyrje

#### **1. Gruaja si subjekt i marrëdhënies juridike të pronësisë.**

- a. Kuadri ndërkombëtar
- b. Kuadri ligjor mbi barazinë gjinore
- c. Kuadri politik

#### **2. Analizë e akteve ligjore në këndvështrim gjinor dhe të barazisë gjinore: Problematikë ligjore apo mentalitete zakonore?**

- i. Mënyrat e fitimit të të drejtës së pronësisë;

- a. Mënyrat e fitimit të pronësisë në bazë të një veprimi juridik;
  - b. Të drejtat e pronësisë në kuadër të bashkëpronësisë midis anëtarëve të familjes bujqësore;
  - c. Fitimi i së drejtës së pronësisë nga trashëgimia;
  - d. Të drejtat e pronësisë nga martesat;
- ii. Akte juridike të posacme mbi bazën e të cilave janë krijuar të drejta pronësie;
- a. Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën”, i ndryshuar;
  - b. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.452, datë 17.10.1992, “Per ristrukturimin e ndermarrjeve bujqësore”;
  - c. Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 : Për tokat bujqësore të pandara”;
  - d. Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”;
  - e. Ligji Nr.7652, datë 23.12.1992 “ Për privatizimin e banesave shtetërore”;
  - f. Ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 “ Për kthimin dhe kompensimin e pronës”;
  - g. Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
  - h. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 29.8.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”;
  - i. Vendimi nr. 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre.
- iii. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme: Menyrë fitimi pronësie apo publicitet;
- iv. Administrimi dhe tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme.
- a. Administrimi dhe tjetërsimi i pronësisë së familjes bujqësore;
  - b. Administrimi dhe tjetërsimi i pasurisë gjatë martesës;
  - c. Të drejtat e gruas në administrimin e pasurisë së fëmijës ;
  - d. Administrimi i pronës dhe zhvillimi ekonomik i gruas (Kredia, huaja bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kreditit financiar).

### **3. Aksesit në drejtësi në mbrojtje të të drejtave të pronësisë dhe statusi aktual i përpunimit të të dhënave zyrtare.**

- i. Aksesit në gjykatë dhe praktika gjyqësore
- ii. Aksesit në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
- iii. Statusi aktual i përpunimit të të dhënave zyrtare

- a. Përpunimi i të dhënave statistikore nga Ministria e Drejtësisë
- b. Përpunimi i të dhënave statistikore nga noterët
- c. Përpunimi i të dhënave statistikore nga ZRPP
- d. Përpunimi i të dhënave statistikore nga gjykatat
- e. Roli i organizatave jo-fitimprurëse

#### **KAPITULLI IV: STUDIM MBI NJOHURITË DHE PERCEPTIMIN E GRAVE MBI TE DREJTAT E PRONËSISË DHE KAUDRIT LIGJOR AKTUAL**

1. Të dhëna statistikore mbi perceptimin e grave mbi të drejtat e pronësisë dhe kuadrit ligjor
2. Analizë mbi këndvështrimin e gruas mbi të drejtat e pronësisë dhe kuadrit ligjor

#### **KAPITULLI V: KONKLUZIONE**

1. Kuadri ligjor
2. Kuadri institucional
3. Politika sociale dhe ekonomike

#### **KAPITULLI VI: REKOMANDIME**

1. Kuadri ligjor dhe aplikimi i tij në praktikë
2. Ndryshimi praktikave dhe sjelljeve
3. Hartimi i politikave të reja

## KAPITULLI I: TË PËRGJITHSHME

### 1. Hyrje

Reformimi i të drejtave të pronësisë i shërben konsolidimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të ekonomisë së një vendi. Në Shqipëri, zhvillimet e Regjimit Juridik dhe vete zhvillimet në të drejtat e raportet juridike të Regjimit Juridik të Tokës, janë kryer me evolucion e revolucion gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit dhe ka njohur si periudha regjimesh atë të pushtimit otoman (5 shekullor), periudhës pas shpalljes së pavarësisë e në vazhdimësi deri në vitin 1945, periudha e regjimit komunist e mandaj ajo e vendosjes së demokracisë mbas vitit 1990.

Përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe vecanërisht zbatimi me korrektësi i tij, kontribuon në shndërrimin e tregut të pasurive të paluajtshme në një faktor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik. Për këtë arsye, ndërmarrja e hapave konkret dhe të koordinuar për zbatimin me efikasitet të legjislacionit në fuqi, është metoda më e mirë për të arritur sukses dhe zhvillim.

Vetë e drejta e pronësisë në Shqipëri është komplekse dhe shpesh burim konfliktesh administrative dhe gjyqësore. Edhe raportet e Progresit të Bashkimit Europian, i kanë kërkuar shtetit shqiptar të marrë masa energjike për të përmirësuar dhe respektuar të drejtat e pronësisë. Një rol orientues në këtë drejtim ka luajtur edhe jurisprudenca e Gjyqës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila jo në pak raste ka evidentuar cënime të të drejtës së pronësisë nga shteti shqiptar. Detyrë e shtetit shqiptar është jo vetëm të përmirësojë legjislacionin që rregullon çështjet e të drejtës së pronësisë, por vecanërisht të sigurojë dhe të angazhohet maksimalisht, në mbrojtjen dhe promovimin e kësaj të drejte.

Një fushë e ndjeshme dhe që kërkon ndërmarrjen të politikave gjithëpërfshirëse, është të drejtat pronësore të grave. Shpesh në praktikë është vërejtuar mungesa e grave në tregun e pronës, duke u shndërruar kështu në faktor frenues të zhvillimit social dhe ekonomik të tyre. Ky fakt pranohet edhe në dokumentet strategjike të qeverisë shqiptare, ku specifikohet se nga studime të organizatave ndërkombëtare është evidentuar se Shqipëria duhet të bëjë më shumë për të respektuar ashtu sic duhet të drejtat pronësore të grave. Të dhënat e grumbulluara nga këto studime tregojnë se gjendja e grave në zonat rurale është më pak e favorshme. Faktorët kryesor që kanë kontribuar në këtë situatë janë:

- a) Njohuritë e kufizuara të grave mbi të drejtat e tyre të pronësisë;
- b) Problematikat dhe mangësitë në legjislacion;
- c) Pasaktësitë në praktikën gjyqësore dhe administrative; si dhe
- d) Mungesa e monitorimit të zbatimit të ligjit për respektimin e barazisë gjinore.

Të gjitha këto problematika të evidentuara duhet të analizohen, me qëllim përcaktimin e faktorëve që kanë ndikim përcaktues në këtë situatë. Edhe pse situata ka ardhur gjithmonë e në përmirësim, përsëri evidentohet se të drejtat pronësore të grave duhet të përmirësohen dhe promovohen më tej. Situata duhet përmirësuar përmes garantimit dhe zhvillimit të të drejtave pronësore të grave. Nevojiten përmirësime në legjislacion, trajnime të stafeve qendrore dhe lokale për promovimin e këtyre të drejtave, si dhe fushata sensibilizuese për informimin dhe promovimin e të drejtave të grave.

## **2. Qëllimi i Projektit**

Qëllimi i këtij projekti është të identifikojë problemet në të drejtat pronësore të grave, si dhe aksesin e tyre në pasuritë e paluajtshme, me qëllim përgatitjen e rekomandimeve për masat që duhet të ndërmerren për të siguruar të drejtat pronësore të grave. Nëpërmjet këtij projekti, synohet që:

- a) Të sigurohet një informacion i hollësishëm për të drejtat e grave dhe aksesin dhe preceptimin mbi të drejtën e pronës në zonën e brengdetit të jugut, duke bërë edhe një analizë statistikore.
- b) Përgatitja e një analize nëpërmjet diskutimit me grupin e interesit, për të gjeneruar informacion mbi perceptimin e grave për të drejtat ligjore që sanksionohen në aktet ligjore dhe nënligjore.
- c) Studimi i legjislacionit aktual dhe rregullave për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe analiza e rezultateve mbi to.

## **3. Qëllimi i dokumentit**

Qëllimi i këtij dokumenti është përgatitja e një studimi mbi legjislacionin në fuqi dhe mënyrën e zbatimit të tij, si dhe evidentimi i perceptimit mbi të drejtën e pronës. Nëpërmjet analizimit të legjislacionit në fuqi, synohet të qartësohet nëse problem përbën përmbajtja e ligjit apo mentaliteti i shoqërisë shqiptare, që pamundëson respektimin e plotë dhe efektiv të të drejtave të pronësisë.

#### 4. Përmbajtja e dokumentit

Ky studim përmban 6 Kapituj të cilët bëjnë një pasqyrim të qartë dhe të plotë të situatës legjislative mbi të drejtat pronësore të gruas, si dhe evoluimin e legjislacionit në këtë fushë.

***Kapitulli i parë – Të përgjithshme*** – përmban një hyrje të shkurtër, qëllimi e projektit dhe të dokumentit, si dhe strukturën e tij.

***Kapitulli i dytë – Evolucionin e të drejtës së pronësisë dhe gruaja si subjekt i marrëdhënies juridike civile të pronësisë*** – përmbledh një përshkrim të shkurtër të evoluimit të legjislacionit shqiptar në këtë fushë, duke marrë në analizë Kanunin e Labërisë; të drejtat e pronësisë së gruas në periudhën 1912 – 1929; Kodin Civil të Zogut; të drejtën socialiste në periudhën 1944 – 1990; si dhe periudhën e regjimit demokratik.

***Kapitulli i tretë – Kuadri ligjor aktual*** – i cili trajton në mënyrë të detajuar kuadrin ligjor mbi barazinë gjinore; kuadrin ligjor ndërkombëtar; mënyrat e fitimit të pronësisë sipas legjislacionit në fuqi; aktet juridike të posacme mbi bazën e të cilave janë krijuar të drejta pronësie; të drejtat reale mbi pronën; si dhe legjislacioni në fuqi për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

***Kapitulli i katërt – Studim mbi njohuritë dhe perceptimin e grave mbi të drejtat e pronësisë dhe kuadrin ligjor aktual*** – ku janë përfshirë të dhënat statistikore mbi perceptimin e grave mbi të drejtat e pronësisë dhe kuadrin ligjor, si dhe një analizë mbi këndvështrimin e gruas mbi të drejtën e pronësisë dhe kuadrin ligjor.

***Kapitulli i pestë – Konkluzione*** – ku përmbledhen gjetjet e studimit dhe një analizë koncize e konkluzioneve mbi kuadrin ligjor dhe institucional.

***Kapitulli i gjashtë – Rekomandime*** – ku përmbledhen masat që duhet të ndërmerren institucionet në kuadër të përmirësimit të kuadrin ligjor dhe aplikimit të tij në praktikë, ndryshimi i praktikave dhe sjelljeve, si dhe hartimi i politikave të reja.

## KAPITULLI II: EVOLUCIONI I TË DREJTËS SË PRONËSISË DHE GRUAJA SI SUBJEKT I MARRËDHËNIES JURIDIKE CIVILE TË PRONËSISË.

### 1. Të përgjithshme

#### *i. Karakteristikat gjeografike të zonës;*

Zona e bregdetit të jugut është një nga zonat e cila nga antikiteti deri në kohët bashkëkohore ka ruajtur identitetin e saj. Ajo është një krahinat më të lakmuara përse i përket peisazhit gjeografik, sepse ka një peisazh mjaft piktoresk. Shumëllojshmëria e relievit i jep një bukuri të rralë. Kjo zonë ka një ndërthyrje midis detit, maleve, luginave, pllajave dhe fushëgropave. Nga ana tjetër, vlerat klimaterike dhe shumëllojshmëria e bimësi e bëjnë këtë zonë një rezervat tërheqës.

#### *ii. Zhvillimi ekonomik dhe social i zonës;*

Bregdeti Jugor mbetet kryesisht i pazhvilluar. Ndonëse zhvillimi i pakontrolluar dhe zhvillimi i rregulluar në mënyrë të pamjaftueshme apo sporadik në disa zona ka kompromentuar në nivel vendor vlerën e peizazhit, Bregdeti Jugor mbetet potencialisht një vlerë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik në nivel kombëtar; dhe në nivel nen-rajonar, një vlerë e madhe e zhvillimit ekonomik të Bregdetit Jugor. Ruajtja e mjedisit unik Bregdetar Jugor, veçanërisht: a) peizazhet natyrore – konturet e tokës, drenazhimet natyrore dhe biodiversiteti); dhe b) peizazhet kulturore – ngulimet dhe ndërtesat tradicionale në aranzhimet e tyre dhe vlera të tjera trashëgimie, bashkë me prodhimet e zakonshme të pemëtarisë dhe të degëve të tjera të bujqësisë përbëjnë një rëndësi të veçantë në funksion të formulimit të një strategjie të preferuar të zhvillimit ekonomik dhe social të zonës.

Turizmi (së bashku me tregtinë shoqëruese dhe me shërbimet plotësuese) është sektori udhëheqës i ekonomisë rajonale dhe si katalizatori kryesor i rritjes së ekonomisë. Nga ana tjetër, industri kryesore tradicionale për zonën mbeten bujqësia (kryesisht prodhimet e pemëtarisë dhe perimeve për treg) dhe peshkimi (ferma dhe pika të vogla artizanale të rritjes së peshkut për t'i shërbyer tregjeve lokale dhe pikave të vogla). Nivelet e larta të rritjes ekonomike në disa zona kanë nxitur ekonominë vendore të pjesës jugore të rajonit Bregdetar Jugor, kjo është shoqëruar me shpopullimin dhe rënien e zhvillimit në zona të tjera, në të cilat popullsia në moshë të vjetër dhe nivelet e larta të emigrimit përbejnë kërcënim për qëndrueshmërinë e këtyre komuniteteve.



### iii. Pozicioni i gruas në familje dhe shoqëri

Përgjithësisht pozicioni i gruas në familje dhe shoqëri në këtë zonë ka qenë më i fortë krahasuar me pozicionin e gruas në zonat e tjera të Shqipërisë. Gratë e zonës kanë qenë të përfshira në procesin e vendimmarrjes në familje. Megjithatë, roli i tyre në familje dhe shoqëri është larg të qënurit i barabartë me atë të burrave.

*Kjo pjesë do të përpunohet dhe plotësohet edhe mëtej nga ALTRI në varësi të disa të dhënave cilësore të cilat do të gjenerohen nga studimi i IDRA.*

## 2. Të drejtat pronësisë së gruas, sipas të drejtës zakonore Shqiptare (Kanuni i Labërisë)

Zakonet e vjetra patriarkale ishin skllavëruese për gruan. Ato nuk i njihnin asaj të drejta në krahasim me burrin, veçse mbronin nderin e saj. Nga gjysma e dytë e shekullit XIX, pas reformave të normave të vjetra, pozita e gruas në Labëri shkoi duke u forcuar brenda familjes, ashtu dhe në marrëdhëniet martesore që gradualisht u liberalizuan në një masë ose në tjetrën. Marrëdhëniet patriarkale-fisnore, autoriteti absolut prindëror dhe sundimi absolut i burrit ndaj gruas, pësuan zbutje, natyrisht, duke ruajtur, diku më fort e diku më pak, gjurmët e patriarkalizmit të kohës së kaluar. Gruaja fitoi disa të drejta e liri, që i mohoheshin më parë.

Popullsia e Labërisë, e zonave të vetëqeverisjes vendore, nuk ka qenë krejtësisht e izoluar, e shkëputur nga kryeqendrat si Gjirokastra, Delvina, Vlora dhe Janina, ku zhvillohej tregtia dhe jeta kulturore. Kontaktet e Labërisë me shkollat dhe me jetën kulturore të qyteteve kryesore, e posaçërisht kurbeti, lidhjet tregtare me shtete të tjerë si Greqia, Turqia e Italia, kanë luajtur rol të madh përparimtar në Labëri. Të gjithë këta faktorë të harrur së bashku vepruan aktivisht në *ndryshimin e mentaliteteve të njerëzve, për qytetërimin e shoqërisë dhe, si rrjedhojë edhe për ndryshimet pozitive të normave të Kanunit të vjetër të Labërisë, që pasqyrohen në rregullimin e marrëdhënieve juridike.*

### a) Familja si strukturë sociale, ekonomike, juridike.

Familja si koncept është një dukuri sociale, ekonomike si dhe juridike. Në zonën e Labërisë familja ishte njësi bazë me e vogël e organizimit shoqëror. Familja ishte ndërtuar mbi një koncept patriarkal, ku sundonte burri i cili kishte përqendruar në duart e tij ekonominë shtëpiake. Familjet patriarkale në Labëri ishin dy llojesh: (i) familja e madhe patriarkale; (ii) familja e vogël patriarkale. Familja e madhe patriarkale mbledh disa breza, të cilët rrjedhin nga një at bashkë me gratë e veta dhe të gjithë jetojnë së bashku në një shtëpi si një bashkësi e madhe njerëzish, si një

bazë ekonomike e përbashkët, prodhuese dhe konsumi. Me zhvillimin e marrëdhënieve si dhe evoluimin e marrëdhënieve shoqërore familjet e mëdha patriarkale u shndërruan në familje të vogla (shtëpia e re) me ekonomi private më vete.

#### **b) Marrëdhëniet e pronësisë.**

Duke mbajtur në konsideratë faktin se marrëdhëniet e pronësisë janë pjesë të marrëdhënieve juridike civile, vlerësohet se e drejta zakonore civile e cila vepronte në Labëri, ishte i njëjti me të drejtën që vepronte edhe në zonat e tjera të Shqipërisë, krahas të drejtës civile otomane. E drejta zakonore civile që vepronte në zonën e Himarës dhe rrethinat, kishte karakteristika të njëjta me Kanunin e Lek Dukagjinit (pa mohuar disa dallime për shkak të zhvillimit ekonomik dhe marrëdhënieve kapitaliste). Në këtë periudhë pronësia ishte e kategorizuar në 3 drejtime: (i) toka; (ii) prona kolektive; (iii) prodhimet blegtorale.

E drejta e pronësisë mbi tokën përbënte një nga institutet më të rëndësishme të së drejtës zakonore në Labëri. E drejta e pronësisë në këtë kohë rregullohej tërësisht nga e drejta otomane (*Mexheleja*), e cila sanksiononte se toka i përkiste shtetit dhe individët kishin vetëm të drejta të shfrytëzimit të saj. Fillimisht e drejta e pronësisë mbi tokën u fitua nëpërmjet metodave origjinale, si pushtimit të tokave ekzistuese apo duke çelur toka të reja. Mbrojtja e tokave si dhe caktimi i kufijve të tyre realizohej sipas të drejtës zakonore. Nga ana tjetër, një mënyrë tjetër e fitimit të pronësisë ishte dhe trashëgimi apo pjesëtimi i pasurive si pasojë e shpërbërjes së bashkësisë fisnore, në struktura më të thjeshta me ekonomi më vete, apo konfiskimi për borxhe si dhe shitja e tyre. Pronari në këtë kohë kishte të drejtë të dispononte lirisht pronën e tij. Megjithatë në këtë kohë konkurronin parimet e pronës private me atë të përbashkët të cilat vinin si pasojë e ekzistencës së lidhjes farefisnore dhe të gjakut, i dhe në të njëjtën kohë në qytet vepronte ligji otoman, ndërsa në fshatra e drejta zakonore.

Një rregullim të veçantë, në të drejtën zakonore të Labërisë, gjente dhe shtëpia. Shtëpia ishte objekt i pronësisë si dhe në të njëjtën kohë shtëpia konsiderohej si pasuri e paluajtshme, e cila mund të trashëgohej si dhe të shitej. Prona kolektive ishte pylli, si dhe kullotat malore apo fushore. Këto prona përdorshin bashkërisht nga i gjithë fshati, por gradualisht në kuadër të diferencimit ekonomik shoqëror edhe këto prona kaluan në përdorim të vëllazërive, barqeve dhe në fund të familjeve. Për sa i përket të drejtës së pronësisë mbi bagëtinë dhe pasurive të tjera të luajtshme, pronarë gëzonte të drejta absolute të pronësisë si nëdorësia, gëzimi dhe disponimi lirisht i tyre.

#### **c) Subjektet e marrëdhënies juridiko civile të pronësisë.**

Në kuadër të ekzistencës së familjeve të mëdha patriarkale, por të bazuara në pronën e vogël private me ekonomi më vetë, subjekti i të drejtës civile, sidomos në fushën e pronësisë ishte

Kryefamiljari. Kryefamiljari ishte subjekt i të drejtave dhe detyrimeve në marrëdhëniet juridike civile. Zotësia juridike varej nga pozita që zinte çdo anëtar i familjes si dhe nga seksi, sidomos në pozitën e gruas (*Gruaja në cilësinë e zonjës së shtëpisë, gëzonte më shumë tagra se gatë e zakonshme të cilat gëzonin cilësinë e vajzave, grave të tjera, apo motra dhe mbesa*).

Gruaja si subjekt i së drejtës civile në marrëdhëniet e pronësisë dhe të detyrimeve kishte tagra të kufizuara, dhe vetëm për sa i përket sendeve të përdorimit të përditshëm, por kurrsesi sendeve të paluajtshme. Në mungesë të të zotit të shtëpisë apo pasardhëse të tjerë meshkuj, gruaja mund të gëzonte dhe cilësinë e të zotit të shtëpisë. Gruaja në cilësinë e zotit të shtëpisë, kishte më shumë të drejta për kryerjen e veprimeve juridike civile. Pas miratimit të *Sharteve të Idriz Sulit* (Shek XIX), ku u pranua pjesëmarrja e gruas në punë, gradualisht u zgjerua edhe cilësia për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime në fushën e marrëdhënieve të pronësisë dhe trashëgimisë. Megjithatë vazhdonte të kishte ndikim e drejta otomane, e cila sanksiononte përjashtimin e gruas nga të gjitha funksionet shoqërore. Mosha për të fituar zotësi juridike për të vepruar, si rregull ishte mosha 14-16 vjeç për djemtë, ndërsa për gratë kjo zotësi fitohej pas martesë ose në një moshë që nuk kishte shpresë për t'u martuar.

#### **d) Marrëdhëniet familjare si dhe regjimi pasuror martesor.**

E drejta zakonore e Labërisë rregullon edhe marrëdhëniet të cilat burojnë nga martesë, gjinia si dhe ato midis prindërve dhe fëmijëve dhe pjesëtarëve të tjerë të familjes. Si pasojë e zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste në prodhim kishte filluar shpërbërja e familjeve të mëdha patriarkale dhe krijimi i familjeve të vogla me ekonomi më vete. Në marrëdhënien e brendshme të familjes vendin kryesor e zinte Kryefamiljar, ndërsa në përbërje të saj ishin zonja e shtëpisë, djemtë, vajzat, nusët e djemve, fëmijët e tyre (nipërit mbesa) deri në shkallën e pestë të gjinisë. Marrëdhëniet familjare kishin një karakter patriarkal me elementë të rendit fisnor dhe rendit kapitalist në zhvillim e sipër.

E drejta zakonore i njihte tagra të shumta Kryefamiljarit. Pushteti dhe tagrat e tij shpreheshin ekskluzivisht në të drejta e pronësisë, pasi vetëm ai kishte të drejtë të blinte, të shiste, tokën, shtëpinë, bagëtinë ose çdo pasuri tjetër me përjashtim të pasurisë së veçantë të cilat kishin të bënin me dhuratat e gruas. Kryefamiljari përfaqësonte shtëpinë në marrëdhënie me të tjerët. Gruaja si anëtare e familjes kishte për detyrë të merrej me administrimin e përditshëm dhe të brendshëm të shtëpisë. Gruaja nuk gëzonte të drejta pronësie, por vetëm të drejtën të mbante dhe të dispononte vetë të hollat e nusërisë, d.m.th dhuratat të cilat kishte marrë si nuse. Të hollat si dhe pasuritë e fituara gjatë martesës nuk kishte të drejtë ti dispononte pasi ato ishin pasuri e të zotit të shtëpisë.

Një institut tjetër i rëndësishëm i të drejtës zakonore të Labërisë është edhe paja apo prika. Paja është pasuri vetjake e gruas të cilën ajo kishte të drejtë ta merrte me vete në rast se ndahej nga

burri. Ndërsa prika të cilën myslimanët e quanin *miraz* përbëhej nga paja (sende vetjake) si dhe tokë apo pasuri të paluajtshme. Në këtë kuadër vlerësohet se prika ka një kuptim më të gjerë se paja, si dhe jepet në formën e shpërblimit.

Marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, sipas të drejtës zakonore familjare të Labërisë, ndaheshin në marrëdhënie vetjake dhe pasurore të cilat bazoheshin në mosbarazim dhe ishin të mbështetura në marrëdhëniet patriarkale. Marrëdhëniet vetjake konsistonin në jetën e përbashkët martesore. Ndërsa për sa i përket marrëdhënieve pasurore, mund të thuhet se këto marrëdhënie ishin të pabarabarta, pasi pasuria bashkëshortore ishte në duart e burrit, i cili administronte dhe dispononte, kurse gruaja merrej me ekonominë shtëpiake pa pasur të drejtë të blinte, të shiste apo të dhuronte gjë nga pasuria bashkëshortore, me përjashtim të sendeve të përdorimit vetjak. Gruaja nuk mund të zgjidhte profesionin e saj si dhe nuk mund të merrte pjesë në asnjë veprimtari pa miratimin e bashkëshortit.

#### e) Trashëgimia.

Instituti i trashëgimisë ishte i lidhur drejtpërsëdrejti me pronën private. Në normat e të drejtës zakonore të trashëgimisë, ashtu si dhe në normat të cilat rregullonin marrëdhëniet martesore, ka pasur një ndikim shumë të madh normat e të drejtës otomane, *Sheriati*. Në kushtet e shoqërisë patriarkale, e drejta zakonore e trashëgimisë sanksiononte rregullin se aftësinë për të trashëguar e gëzonin vetëm meshkujt që rridhnin nga trungu i gjakut të babës dhe jo nga trungu i gjinisë së nënës. Sipas kanunit të Labërisë gruaja dhe vajza përjashtoheshin nga e drejta e trashëgimisë. Më pas u lejua që bashkëshortja të merrte  $\frac{1}{4}$  e pasurisë ashtu për sa parashikonte dhe e drejta otomane. E drejta zakonore e trashëgimisë parashikonte rregulla jo vetëm se kush mund të trashëgonte por njëkohësisht parashikonte dhe rregullimin e situatave të veçanta. Kjo e drejtë parashikonte se në rast se në shtëpi mbesnin vetëm vajza jetime dhe të pamartuara, atëherë pasuria administrohej nga një i afërm i tyre. Në të njëjtën kohë në rast vajzat apo gratë nuk kishin të afërm atëherë pasuria trashëgimore administrohej prej tyre, por nuk mund të disponohej, duke i kthyer këto vajza *de facto* në trashëgimtarë, pavarësisht se *de jure* kjo e drejtë u njihej vetëm meshkujve.

### 3. Të drejtat pronësisë së gruas pas viti 1912 dhe deri në vitin 1929.

#### 1. Marrëdhëniet e pronësisë

Marrëdhëniet e pronësisë ishin zhvilluar shumë si dhe kishin pësuar ndryshime. Shteti shqiptar mbas vitit 1912 filloi të zëvendësoje gradualisht legjislacionin turk mbi token, duke rikonfirmuar regjimin dhe rregullimin juridik të tokës dhe të të drejtave të subjekteve të saj juridike, duke respektuar njëkohësisht edhe Regjimin juridik nën të drejtën kanunore që vepronte me shume ne veri të Shqipërisë e në disa zona të jugut ( veçanërisht në Labëri ). Në kuadër të zhvillimit të

vrullshëm të marrëdhënieve kapitaliste, si dhe diferencimit ekonomik-shoqëror, ishin zhvilluar klasat e feudalëve si dhe çifligarëve.

Tërheqja e tokës në sferën e qarkullimit të mallrave, lidhja e prodhimit bujqësor të çifligut me tregun, pjesëmarrja e çifligarëve në veprimet tregtare dhe aspirata e tyre për investime në fushën e industrisë i futi pronarët çifligarë në rrugën e borgjezimit. Shprehja më e thjeshtë e borgjezimit të pronarëve feudalë ishte prirja që pushtoi çifligarët për të përqendruar në duart e tyre së bashku me tokën edhe veglat kryesore të punës. Përqendrimi i qeve, i farës e i banesës së bujkut në duart e çifligarit ishte një lloj investimi që pronari i tokës bënte në fushën e prodhimit, të cilin nuk e njihte rendi feudal. Si rrjedhim, përballë bujkut që zotëronte vetëm krahët e punës, qëndronte çifligari si zotërues i tokës, i mjetit kryesor të prodhimit dhe i veglave kryesore të punës, që e bënin atë të afërt me një pronar kapitalist.

Regjimi juridik i tokës, si dhe marrëdhëniet e pronësisë rregulloheshin si nga e drejta zakonore ashtu dhe e drejta e perandorisë osmane. Regjimi juridik i tokës deri në vitin 1925 vazhdoi të jetë ai i perandorisë osmane që rregullohej me ligjin e tokës të viti 1856. Qeveria e Ahmet Zogut nëpërmjet Statusit Themeltar të Republikës së Shqipërisë<sup>1</sup>, si dhe Statutin Themeltar të Mbretnis Shqiptare<sup>2</sup>. Sipas statutit toka nuk ndahej në 5 kategori siç ishte më parë por të gjitha tokat brenda territorit të shtetit shqiptar shpalleshin prona të thjeshta (mylk) , në pronësi të shtetit, të personave juridikë dhe të personave fizik. Në nenin 124 të statutit thuhej se në tokat rurale në Shqipëri me çdo titull kanë të drejtë pronësie vetëm shtetasit dhe personat moralë shqiptarë. Megjithëse rregullimi i ri e thjeshtëzoi regjimin juridik të tokës, në fakt ashtu si dhe më parë pronësia tokësore në fshat ishte heterogjene. Vepronin njëkohësisht pronat çifligare kapitaliste dhe prona e vogël.

## **2. Trashëgimia**

Në periudhën 1912-1929 në përgjithësi u zbatuan ato norma të së drejtës dhe ato institute juridike, që zbatoheshin përpara shpalljes së pavarësisë. Kjo për faktin se shteti shqiptar sanksionoi ndonëse përkohësisht se në çështjen e normave të së drejtës në Shqipëri do të zbatoheshin normat e pushtuesit osman deri në nxjerrje e një legjislacioni të ri nga ana e shteti shqiptar. Në këto kushte në Shqipëri janë zbatuar normat e së drejtës së pushtuesit turk për rregullimin e marrëdhënieve juridike në përgjithësi dhe marrëdhënieve të trashëgimisë në veçanti.

---

<sup>1</sup> Statuti Themeltar i Republikës së Shqipërisë përmbante 4 krerë dhe gjithsej 142 nene. Për nga përmbajtja e tij dhe mënyra e miratimit, Statuti Themeltar ishte një kushtetutë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

<sup>2</sup> Statuti Themeltar i Mbretnis Shqiptare ishte më i gjerë dhe më i plotë se Statuti Themeltar i Republikës së Shqipërisë. Ai përmbante 10 krerë dhe kishte gjithsej 234 nene. Edhe Statuti Themeltar i Mbretnis Shqiptare, për nga përmbajtja dhe mënyra e miratimit, ishte një kushtetutë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës.

Marrëdhëniet e trashëgimisë sipas të drejtës otomane, në vitet 1912-1929 nuk rregulloheshin nga Kodi Civil ose Mexheleja, por sipas normave të së drejtës së shenjtë myslimane, Sheriatit i cili kishte si burim kryesor Kuranin. Në lidhje me trashëgiminë ligjore, ligji turk (*libër i trashëgimit Feriazit*) i cili zbatohet në Shqipëri në këtë periudhë njihet tre Kategori kryesore trashëgimtarësh: (i) trashëgimtarë me pjesë të caktuar; (ii) trashëgimtarë pa pjesë të caktuar; (iii) trashëgimtarë të tjerë. Në bazë të këtij ligji, femra thirret në trashëgim si trashëgimtare me pjesë të caktuar dhe njëkohësisht në cilësinë e bashkëshortes së trashëgimlënësit, motrës praj nëne, vajzës së trashëgimlënësit, mbesës së trashëgimlënësit, motra gjermene, motra nga babai, nënës së trashëgimlënësit, gjyshja nga babi dhe nga nëna. Siç mund të përcaktohet nga përcaktimi radhës së trashëgimtarëve ligjorë të cilët ishin trashëgimtarë me pjesë të caktuara, legjislacioni otoman, sanksiononte pabarazinë ndërmjet fëmijëve meshkuj dhe femra, si dhe ndërmjet burrit dhe gruas. Çka duhet të thënë se ishte normale për legjislacionet e kohës. Sepse të gjitha legjislacionet e vendeve të ndryshme përfshirë dhe ato të shteteve më të zhvilluara të kohës e njihnin këtë pabarazi.

Përsa i përket trashëgimisë me testament sipas të drejtës së shenjtë myslimane, për këtë trashëgimi me ndryshim nga trashëgimi me ligj nuk zbatoheshin normat e sheriatit por trashëgimia me testament rregullohet sipas normave të fesë të cilës i përkiste trashëgimlënësi. Trashëgimia me testament në Shqipëri ka gjetur përdorim ndonëse të kufizuar, Kjo për faktin se jo vetëm në Shqipëri në këtë periudhë jetonin dhe popullsi shqiptare që i përkisnin feve të tjera jo myslimane si ortodoks dhe katolik, të cilët dispononin me testament pasuritë e tyre lirisht sipas normave të feve të tyre por dhe për faktin se një pjesë të madhe të popullsisë zbatohet e drejta zakonore e cila e njihet me kufizimet e veta trashëgiminë me testament. Sipas normave dhe rregulla disponimi me testament kishte vetëm kufizime për s ai përket pjesës së pasurisë dhe llojeve të veçanta të pasurisë, nga ana tjetër vlerësojmë se nuk ka pasur parashikime konkrete mbi ndalimin e të drejtave të gruas për të disponuar dhe për të përfituar nga trashëgimia testamentare, por gruaja nuk përfitonte për shkak, të së drejtës zakonore, ku mbizotëronte koncepti i përjashtimit të saj dhe pabarazisë përballë burrit.

### **3. Regjimi i Zogut: Kodi Civil i Zogut 1929-1944**

#### **1. Marrëdhëniet e pronësisë.**

Regjimi i Zogut u përpoq të bënte disa reforma në fushën e legjislacionit duke huazuar të drejtën borgjeze franceze dhe italiane. Hapi parë në këtë drejtim u bë më miratimin e statutit të republikës, por në fushën e pronësisë dhe të marrëdhënieve civile e bëri me miratimin e Kodit Civil të Mbretërisë së Shqipërisë. Kodi Civil i Mbretërisë shqiptare që hyri në fuqi në 1 Prill

1929, përcaktoi parimet kapitaliste, mbi pronësinë duke e shpallur pronën private si të shenjtë dhe të paprekshme.

Sipas nenit 794, të Kodit Civil *“Zotërimi është e drejta me gëzue dhe me disponue sende në mënyrë ma absolutem me kondit që mos të bahet një ushtrim i ndaluem prej ligjeve ose rregulloreve”*, ndërsa në nenin 798 përmendet se: *“Ai që ka zotnimin e tokës ka dhe atë të hapësirës që është mbi të, si dhe atë çka ndodhet mbi dhe nën sipërfaqen, përveç kur me ligj caktohet ndryshe”*. Baza e Kodit Civil ishte pronësia e pakufizuar private e cila mbështetej në të drejtën për të zotëruar sendet pa asnjë kufizim. Pronari i tokës e bënte të vetën gjithçka që prodhohej nga ajo dhe çdo gjë që bashkohej me të.

Kodi Civil përveç pronësisë njihte dhe disa të drejta mbi sendet që ndodheshin në pronësinë e të tjerëve siç ishin servitutet personale (uzufruktutet, përdorja dhe bajtjet); Servitutet tokësore pengu, hipoteka, dhe e drejta e parablerjes midis bashkëpronarëve). Kodi Civil Njihte gjithashtu nëndorësinë (posedimin e një sendi) ose gëzimin e një të drejte që personi kishte vetë ose me anën e një tjetri e posedonte atë ose e ushtronte të drejtën në emër të posedimit. Për mbrojtjen e saj, pavarësisht nga faktit se nuk ekzistonte e drejta korresponduese, Kodi Civil i jepte poseduesit të drejtën e padisë së posedimit dhe rivendikimit.

Pas hyrjes në fuqi të Kodit Civil u miratua dhe ligji *“Mbi zyrat e hipotekave dhe taksave tyre”*. Ligji përmbante një sërë dispozitash të huazuara nga ligjet otomane mbi tapitë duke u përshtatur kërkesave të kohës. Sipas këtij Ligji, hipotekat merreshin vetëm me transkriptimin e kateve të shitblerjes, të dhurimit, dhe me inskriptimin ose të të drejtave reale mbi pronat bujqësore ose urbane. Karakteristik është fakti se zyrat e hipotekave nuk merreshin aspak me regjistrimin e pronësisë, për shkak se kërkohej të kryheshin matjet gjeodezike. Kur pronari i ndonjë toke ose ndërtese të paregjistruar kërkonte ta shiste ose ta hipotekonte atë detyrohej ta regjistronte.

## **2. Regjimi martesor/Regjimi Juridik i pasurisë bashkëshortore.**

Ne Kodin Civil të vitit 1929 regjimi juridik i pasurisë bashkëshortore trajtohet në titullin III *“Kontrata e martesës”* (nenet 1321-1389). **Sipas këtij Kodi, pasuria e vene gjate martesës nuk prezumohej si pasuri në bashkëpronësi midis bashkëshortëve vetëm për shkak të martesës, kjo pasi duke ju referuar dispozitave të Kodit del qarte se secili bashkëshort gjate martesës kishte të drejte të kishte pasuri ekskluzive të tij të luajtshme dhe të paluajtshme.** Kjo del qarte nga nenet 1321 deri 1389, që në kuadrin e kontratës së martesës rregullojnë marrëdhëniet pasurore mes bashkëshortëve, duke rregulluar posaçërisht tre institute të të drejtës familjare: atë të *“Dotes”* (nenet 1331-1360), *“Pasurisë parafernale”* (nenet 1368-1375), si dhe *“Bashkepasunimit midis bashkëshortëve”* (nenet 1376-1389).

**Dota (nenet 1331-1367):** “Dota” ishte pasuri qe gruaja ose te tjerët ne vend te saj ia sillnin burrit për te përballuar detyrimet nga martesë (neni 1331), duke i njohur atij vetëm te drejtën e administrimit te kësaj pasurie deri sa te vazhdonte martesë (neni 1399). Dota duhet te konstituohet shprehimisht. Pra qe te kishim dote duhet qe palët te bënin një parashikim me shkrim te te mirave qe do te trajtohen si dote (neni 1331). Dota mund te përfshinte tërësisht ose pjesërisht pasurinë e tashme dhe te ardhme te gruas, ose dhe një send te caktuar (neni 1332). Ne kontratën e martesës bashkëshortët mund te binin dakord te parashikonin një fitim mbi shumën e dotes ne favor te bashkëshortit pasjetues. Gjate kohe-vazhdimit te martesës te drejtën e administrimit te dotes e kishte vetëm bashkëshorti (burri), i cili mund te ngrinte padi ne gjykatë kundër debitorëve dhe nedoresve te dotes, si dhe te mblidhte frutat dhe kamatat e saj. Përfundimisht nga ky rregull behej vetëm kur ne kontratën e martesës ishte parashikuar qe gruaja te merrte vit për vit një pjese nga te ardhurat dotale për shpenzimet e vogla dhe për nevojat personale te saj. Ne qofte se dota përbehej nga sende te luajtshme, vlere e te cilave ishte përcaktuar ne kontratën e martesës, bashkëshorti behej zot i tyre dhe ishte debitor vetëm i vleftës se tyre, ne qofte se ne kontrate dhënia e çmimit nuk kishte për efekt shitjen e tyre. Por ne qofte se nuk ishte parashikuar ne kontrate ne mënyrë te shprehur vlere e pronës qe përbente doten, bashkëshortit nuk i kalonte zotërimi i saj. Gjithashtu hipotekimi ose tjetërsimi i dotes nuk mund te behej, ne qofte se një gjë e tille nuk ishte parashikuar ne mënyrë te shprehur ne kontratën e martesës.

Në rast se dota keqpërdorej nga bashkëshorti, ose rrezikonte te përdorej vetëm për shlyerjen e borxheve personale te tij, gruaja mund t’i drejtohej gjykatës se shkalles se pare dhe t’i kërkonte veçimin e dotes. Gjithashtu veçimi i dotes mund te kërkohet nga gruaja edhe kur ishte vendosur veçimi personal për faj te bashkëshortit, ose te te dyve. Ne çdo rast veçimi i dotes duhet te behej nga gjykata, ne rast te kundërt ishte i pavlefshëm. Kur gjykata vendoste veçimin e dotes, gruaja detyrohej te kontribuonte sipas fuqisë ekonomike te saj ne shpenzimet familjare dhe ne mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve te tyre. Ne këtë rast gruaja merrte administrimin e lire te pasurisë se saj.

**Pasuria parafernale e gruas (nenet 1368 – 1375):** Pasuria parafernale ishte pasuria e gruas qe nuk përbënte dote (neni 1368) dhe te cilën burri nuk kishte te drejte ta administronte dhe as te kërkonte kreditë e saj, neqoftese nuk kishte porosi nga gruaja (neni 1370). Vete kodi parashikonte se ishin parafernale te gjitha te mirat qe nuk ishin përfshire ne dote (neni 1368). Pra ishin te tille te gjitha te mirat *extra dotem*. Per te dalluar se cilat te mira ishin parafernale duhet te analizohej nese ishte bere kushtituimi i dotes dhe cilat te mira ishin pjese e saj dhe me metodën e përjashtimit do te përcaktohej se parafernali do te ishin te gjitha ato te mira te gruas se martuar qe nuk ishin te përcaktuara si dotale. Nga ky formulim kuptohet se do te ishin parafernali jo vetëm te mirat qe gruaja kishte ne momentin e martesës ligjore, por edhe ato qe ajo kishte fituar me vone me çfarëdolloj titulli, qofte suksesimi, dhurimi, ose si rrjedhoje e punës se saj. Sipas këtyre dispozitave, gruaja mbante te drejta absolute mbi te mirat parafernale. Këtë qëndrim mbante dhe neni 1370, ne te cilin parashikohej se: “*Gruaja mban zotenimin, administrimin dhe*



*gëzimin e pasurisë parafernale të saj dhe burri nuk ka të drejtë ta administrojë, as të kërkojë kreditë e saj, neqoftese nuk ka porosi nga ajo.”* Pra gruaja e martuar mbante pronësinë mbi të mirat parafernale edhe gjatë jetesës bashkëshortore. Edhe e drejta e administrimit të të mirave parafernale i takonte gruas. Megjithatë ligji nuk e kishte ndaluar gruan që t’i besonte me ane të një prokure bashkëshortit të saj administrimin e kësaj pasurie (neni 1371). Në një rast të tillë prokura mund të ishte e pakushtëzuar, ose e kushtëzuar nga detyrimi i bashkëshortit për të dhënë llogari për frutet (neni 1371).

### **Bashkepasunimit midis bashkëshorteve - Bashkepasunim i fitimeve: (nenet 1376 – 1389):**

Në kaptinën e IV të titullit të III të kontratës së martesës behet fjale për bashkepasunimin midis bashkëshortëve. Nga këto dispozita, si dhe nga dispozitat e tjera të këtij Kodi Civil, del qarte se bashkepasunimi në kuptimin juridik dhe bashkezetnimi nuk janë e njëjta gjë. Bashkezetnimi përfaqëson në vetvete bashkepronësinë sipas kuptimit juridik, që i jepet bashkepronësisë në legjislacionin aktual. Ndërsa bashkepasunimi ka një kuptim më të gjërë sesa bashkezetnimi. Zetnimi ose bashkezetnimi është e drejta për të gëzuar ose për të disponuar sendet. Pra tek zetnimi dhe bashkezetnimi ekzistojnë të dy tagrat, e drejta e gëzimit dhe e drejta e disponimit (neni 794 i K.Civil). Ndërsa tek bashkepasunimi e drejta e gëzimit dhe e drejta e disponimit mund të qëndrojnë dhe të veçuara nga njëra-tjetra. Kjo del nga krahasimi i dispozitave që rregullojnë bashkepasunimin (titulli i IV i librit të tretë), me dispozitat që rregullojnë të drejtën e parablerjes (titulli të V të po këtij libri) midis bashkezetnuesve të pronave. Bashkepasunimi konsiston kryesisht në gëzimin dhe në nxjerrjen e fitimeve të përbashkëta mbi sende të veçanta. Bashkepasunimi ka me shumë karakteristikat e një shoqërie të thjeshtë ku secili pronar ruan të drejtën e tij të pronësisë, duke pasur të drejtën e disponimit të lire të këtyre sendeve tek të tretet pa pëlqimin e bashkepasunuesve të tjerë. Ky dallim del me qarte nëse i referohemi nënëve 1032 dhe 1682 të K.Civil. Në paragrafin e dytë të nenit 1682 është përcaktuar se: “gjithashtu shoqnia zgjidhet në çdo rast me hupjen e gjase, kur vetëm gëzimi i kësaj është vënie në bashkepasunim dhe zetnimin e ka rezervue shoku”. E përmendem këtë dispozite, jo vetëm për faktin se në nenin 1377 është përcaktuar se për bashkepasunimin midis bashkëshortëve aplikohen dhe dispozitat e titullit “Shoqnia”, por edhe për të treguar se gëzimi i një sendi mund të konsiderohet bashkepasunim pa u konsideruar sendet në bashkezetnim. Një konkluzion i tillë del edhe nga neni 1382 të po këtij Kodi. Ky Kodi Civil, duke patur këtë dallim mes bashkepasunimit dhe bashkezetnimit, ka bërë rregullimin juridik të bashkepasunimit midis bashkëshorteve në nenet 1376 deri 1389.

**Nga këto dispozita del qarte se behet fjale për bashkepasunim dhe jo për prezumim të bashkezetnimit midis bashkëshorteve. Prezumimi i bashkezetnimit është pranuar vetëm për sendet e luajtshme të fituara gjatë martesës në rastet kur nuk ekziston një përkrahim autentik i kësaj pasurie në emer të njerit bashkëshort. Ky prezumim i bashkezetnimit për pasuritë e luajtshme del nga neni 1380, në të cilin është përcaktuar se: “në mungesë të një përkrahimi të tillë, ose të një titulli autentik, tjetër sendet e luajtshme konsiderohen si fitime të**

bashkepasunimit”. Nga interpretimi qe i behet kesaj dispozite del se **sendet e luajtshme qe mund te jene fituar gjate marteses mbeten ne pronesi te bashkeshortit qe ka titullin autentik te pronesise. Nje interpretim i tille vlen edhe per pasurite e paluajtshme, per te cilat ekziston nje titull pronesie ne emer te njerit bashkeshort. Ne rastet kur mungojne pakte te posaçme te hartuara me akt publik para noterit para marteses dhe prona e vene gjate marteses figuron ne emer te njerit prej bashkeshorteve, kjo prone i takon bashkeshortit ne emer te te cilit eshte regjistruar.**

**Ekzistenca e titullit te pronesise ne emer te njerit prej bashkeshorteve eshte prove bindese se pronesia mbi sendin nuk eshte rezultat i fitimeve te bashkepasunimit dhe per pasoje pronesia i mbetet atij bashkeshorti qe ka titullin e pronesise. Pasuria e vene gjate marteses konsiderohet ne bashkepronesi vetem kur vertetohet se ajo eshte vene me fitimet e bashkepasunimit. Nje perfundim i tille del nga nenet 1376, 1378, 1379, 1383 te ketij Kodi Civil. Ne nenin 1378 eshte percaktuar ne menyre te qarte se bashkepasunimi per pasurine qe i vjen secilit bashkeshort gjate marteses shtrihet vetem ne tagrat e gezimit te kesaj pasurie. Kete qellim ka patur ligjvenesit kur eshte shprehur se: “por, gezimi i pasurise se luajtshme ose te paluajtshme te tashme, ose te ardhme te bashkeshorteve hyn ne bashkepasunim”. Nga interpretimi i ketyre dispozitave del qarte se bashkepasunimi i percaktuar ne nenet 1376 deri 1389 te K.Civil shtrihet vetem mbi te drejten e gezimit te kesaj pasurie dhe behet pasuri bashkeshortore vetem ajo pasuri e vene me fitimet e perbashketa te dy bashkeshorteve dhe se sendet qe figurojne ne pronesi individuale te secilit bashkeshort nuk perfshihen ne pasurine bashkeshortore.**

**Liria kontraktuale.** Legjislatori, ne hartimin e Kodit Civil te 1929, ka mbajtur qëndrimin se interesi i shtetit për ndërtimin e një familjeje të shëndoshë mbi bazat e martesës nuk imponon domosdoshmërisht kufizimin e lirisë individuale në zgjedhjen e regjimit pasuror bashkëshortor. Megjithatë, liria në përcaktimin e regjimit pasuror bashkëshortor nuk mund të jete absolute si në kontratat e tjera. Në këto të fundit janë në lojë vetëm interesat private dhe dihet që gjykatësit me të mirë të interesave të tyre janë vete palët kontraktore. Në të drejtën familjare përkundrazi nuk përqendrohet vëmendja tek individit si i tillë, por tek individit si një komponent i shtetit, dhe pikënisje merret nga principi se ky ka interes në organizimin e një instituti të së drejtës familjare. **Për këtë arsye dhe liria kontraktuale në kuptimin e regjimit pasuror bashkëshortor nuk mund të jete e pakufizuar, por duhet të pësojë disa kufizime, të cilat shteti i konsideron të nevojshme për organizimin e shëndoshë të familjes. Kjo shpjegon përse në ndryshim nga kontratat e tjera, në kontratat martesore hasen mjaft norma ndaluese që nuk mund të anashkalohen nga palët. Edhe pse mbetet principi i lirisë së palëve kontraktuese për të parashikuar në kontrate martesore, klauzola që legjislatori nuk i ka ndaluar (neni 1321), autonomia individuale ka një fushe veprimi jo shumë të shtrire, pasi legjislatori e ka konsideruar me vend të parashikojë shumë norma urdhëruese.**

Kështu bashkëshortët nuk mund të lidhnin pakte në kundërshtim me të drejtat që i takonin kryetarit të familjes, as me ato që ligji i atribuonte njërit apo tjetrit nga bashkëshortët, as edhe me dispozitat ndaluese që përmbante Kodi (neni 1322). Ata nuk mund të bënin në kontratën martesore asnjë parashikim që kishte për qëllim ndërrimin e radhës ligjore të trashëgimtarëve (neni 1323). Në Kod përcaktohej shprehimisht ndalimi i bashkëshortëve që të parashikonin në mënyrë të pa cilësuar që martesë e tyre të rregullohet sipas zakoneve të vendit, ose ligjeve të cilat nuk ushtroheshin ligjërisht (1324). Akti apo kontrata martesore duhet t'i nënshtrohet rregullave të vlefshmërisë që kishin të bënin me formën dhe kohën e lidhjes së kontratës. Kontrata e martesës duhet të bëhet me akt publik përpara noterit dhe përpara martesës (neni 1325). Akti publik është një kusht ekzistencial për vlefshmërinë e kontratës, "*forma dat esse rei*". Liria kontraktuale e palëve në përcaktimin e konvencioneve në kontratat martesore duhet që t'u nënshtrohet këtyre kushteve:

- i. Konvencionet të mos vinin në kundërshtim me dispozitat ndaluese të Kodit (neni 1322).
- ii. Parashikimi i konvencioneve të bëhet me anë të aktit publik para noterit dhe para martesës (neni 1326);
- iii. Në prezencë dhe me miratim të të gjithëve që kanë qenë palë në kontratën martesore (neni 1326).

Gjithashtu Kodi parashikonte se të gjitha konvencionet martesore të çdo lloji nuk mund të ndërroheshin me asnjë mënyrë mbas celebrimit të martesës (neni 1328).

Në Kodin Civil të Zogut ka mjaft dispozita që diktojnë pozicionin e pabarabartë të gruas, si parashikimi se burri është kreu i familjes. Për bashkëpronësinë midis bashkëshortëve, Kodi Civil i Zogut I parashikonte vetëm bashkëpronësinë mbi fitimet, pavarësisht nga fakti, nëse ishte parashikuar kushtituimi i dotës në kontratën e martesës ose jo. Marrëveshja lidhur me bashkëpronësinë mbi fitimet parashikohet në kontratën e martesës dhe fillon efektet e saj nga momenti i celebrimit të martesës. Sipas Kodit Civil nuk mund të bëjnë pjesë në bashkëpronësi as aktivi dhe as pasivi i tashëm i bashkëshortëve (në momentin e lidhjes së martesës) dhe as pasuria që u vjen atyre me trashëgim gjatë kohës së ekzistencës së bashkëpronësisë midis tyre. Në bashkëpronësi bën pjesë vetëm gëzimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, të tashme dhe të ardhme të bashkëshortëve. Të gjitha fitimet që nxjerr burri dhe gruaja së bashku ose secili prej tyre veç e veç gjatë kohës që vazhdon regjimi i bashkëpronësisë, qofshin këto fitime të rrjedhura nga industria e përbashkët ose nga ekonomia e tyre, janë të përbashkëta dhe të ndashme, duke zbritur më parë debitë që rëndojnë mbi bashkëpronësinë e bashkëshortëve. Sipas Kodit Civil vetëm burri mund të administrojë sendet në bashkëpronësi si dhe të kryejë veprime lidhur me to, gjë që tregon pabarazinë e plotë të burrit me gruan në shoqërinë e kohës. "Duke patur parasysh si doktrinën dhe praktikën gjyqësore të lidhur me Kodin Civil të vitit 1929, mund të themi se ishte një hap i rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve juridike familjare të asaj kohe, por që ruajti dhe nuanca të inferioritetit të gruas në raport me burrin".

### 3. Trashëgimia.

Në nenin 460/1 të Kodit Civil të viti 1929 përcaktohej se : “Atin amën dhe çdo tjetër të paralindun e trashëgojnë fëmijët legjitim, ose të paslindurit e tyre **pa dallim seksi** edhe sikur të kenë lë nga martesë të ndryshme” Në analizë të kësaj dispozite vërehet qartë se Kodi Civil i kësaj periudhë sanksiononte dhe garantonte një barazi të plotë ndërmjet femrës dhe mashkullit për sa i përket fitimit të së drejtave të pronësisë ndërmjet trashëgimisë ligjore. Në të njëjtën kohë në analizë të nenit 492 të Kodit Civil të viti 1929, ku parashikohej se: “Testamenti është një akt i revokueshëm me të cilin **ndokush**, sipas rregullave të caktuara prej ligjës disponon për kohën mas vdekjes të tanë ose një pjesë të pasurisë së vet në favor të një ose më shumë **personave**”. Edhe këtu duhet të mbajmë parasysh se termi “**ndokush**” apo “**person**”, përfshin si mashkullin ashtu dhe femrën. Në këtë kuadër vërehet qartë se Kodi Civil i kësaj periudhë sanksiononte dhe garantonte një barazi të plotë ndërmjet femrës dhe mashkullit për sa i përket fitimit të së drejtave të pronësisë ndërmjet trashëgimisë.

## 4. E drejta Socialiste 1944-1990

### 1. Marrëdhëniet e pronësisë.

**Ligji nr. 108, datë 29.08.1945 “Për Reformën Agrare”.** Në bazë të këtij ligji shpronësoheshin të gjithë çifligjet e shtetit, pronat bujqësore private dhe të enteve private dhe fetare, tokat e instaluarve nga reforma agrare e regjimit të zogut, pendët e punës dhe veglat bujqësore që ndodheshin në posedim të fshatarëve që shpronësoheshin. Në nenin 1 të ligjit 108/1945 parashikohej se: “Me shpalljen e këtij ligji shpronësohen detyrimisht dhe u ndahen fshatarëve, nënshetas shqiptar që nuk kanë toka të tyre ose që nuk ju mjafton toka”. Në këtë kuadër vlerësohet se më anë të këtij ligji u sanksionua jo vetëm shpronësimi i një kategorie të caktuar shtetasish, por në të njëjtën kohë dhe dhënia e pasurisë një kategorie tjetër shtetasve, të cilët përfitonin nga ky ligj. Në të njëjtën kohë vlen të theksohet se fshatari me anë të tapisë, bëhej pronar i tokës që përmbante akti administrativ/titulli/Autorizimi i lëshuar nga Zyra e Reformës Agrare. Ky autorizim kishte për qëllim përdorimin e pronës vetëm për nevojat të prodhimit dhe fshatari ishte i ndaluar të tjetërsonte pronën apo të kryente veprime të tjera në kuadër të ushtrimit të tagrave të pronësisë. Kalimi i pronësisë nëpërmjet tapisë nuk ishte një marrëdhënie juridiko civile ndërmjet shtetit dhe individëve.

Ligji mbi reformën agrare përmbante parashikime konkrete dhe mbi mënyrën e dhënies së titullit të pronësisë. Pas matjeve teknike të sipërfaqeve të pronës, fshatarit i jepej titulli përfundimtar i pronësisë (tapia) me anë të të cilës ai bëhej pronar. Ky titull regjistrohej në emër të kryetarit të familjes bujqësore. Në rast se prona punohej bashkërisht prej shumë personave që bashkëjetonin,

zotërimi i tokës u përkiste bashkërisht të gjithëve në pjesë të barabarta dhe titulli i zotërimit u jepej të gjithë pjesëtarëve. Norma e tokës që përfitonin shtetasit nga reforma agrare ose që u njihej pronësia e mëparshme ishte 5 hektarë për çdo familje bujqësore. Quhej familje bujqësore ajo që përbëhej nga të gjithë personat që vinin nga një trung dhe që bashkëjetonin dhe bashkëpunonin. Në qoftë se kishte pjesëtar të tjerë që lidheshin në gjini ose me krushqi, ose të martuar ose të veja me fëmijë meshkuj shtoheshin hektarë për çdo pjesëtar të kësaj kategorie (kurorë).

Zbatimi këtij ligji u shoqërua paralelisht me krijimin dhe zhvillimin e kooperativave bujqësore. Krijimi kooperativave u parashikua për herë të parë në Statusin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i cili u miratua nga Asambleja Kushtetuese në datën 14.03.1946 (*Kushtetuta e vitit 1946*). Sipas nenit 8 të këtij statuti, shteti kujdesej veçanërisht për lëvizjen kooperativiste të popullit si dhe e përkrah dhe favorizon atë. Në zbatim të parashikimeve të Statutit, nëpërmjet Dekretligjit, të datës 20.04.1946 “Mbi krijimin e kooperativave”, u parashikua ngritja dhe zhvillimi i kooperativave. Lidhur me tokën ky legjislacion i posaçëm parashikonte kolektivizimin e pronave dhe mjeteve të prodhimit, si dhe në të njëjtën kohë disiplinonte çështje të cilat kishin të bënin me kategorinë e tokës, mjeteve të prodhimit, çështjet e anëtarësisë, organizimin e punës, shpërblimin e anëtarëve, mënyrën e drejtimit, si dhe oborrin kooperativist. Anëtarë të kooperativës mund të ishin të gjithë punonjësit, si gratë ashtu dhe burrat që kishin mbushur moshën 16 vjeç.

Me Urdhëresën Nr. 49, datë 04.09.1947 “Mbi krijimin e kadastrës provizore”, u krijua kadastra provizore. Sipas kësaj urdhërese regjistrohej në librat e kadastrës sipërfaqja tokësore shtetërore, private e personave juridikë me përjashtim të zonave të qytetit. Në këto libra regjistrohej pronësia e subjekteve të mësipërme, sipërfaqja e tokës, si dhe lloji i tokës. Dy vjet më vonë me Dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor u përcaktua në shërbim të plotë shërbimi kadastral i tokave. Sipas Dekretit mbi shërbimin kadastral të tokave me regjistrimin e tokave në të gjithë vendin merrej kadastra. Regjistrimi i tokave ndahej në regjistrimin themeltar dhe në regjistrimin e vazhdueshëm.

Tokat e ekonomive individuale regjistroheshin në emër të kryetarit të trungut familjar, duke pasur të drejtën e përdorimit të tokës të gjithë pjesëtarët e trungut familjar. Tokat e kooperativave bujqësore, ndërmarrjeve bujqësore shtetërore, institucioneve të ndryshme, regjistroheshin në emrin tyre. Si tokat e ekonomike bujqësore individuale, ashtu dhe ato të kooperativave, për efekte kadastrale regjistroheshin njëllë. Legjislacioni i kohës riafirmoj dhe një herë qëndrimin e shtetit në lidhje me ndalimin e pronës private. Përveç kësaj u vunë edhe rregulla lidhur me trashëgiminë e tokës. Kështu kur anëtari i vdekur ishte anëtari i fundit i ekonomisë bujqësore individuale, e gjithë pasuria me përjashtim të tokës i kalonte trashëgimtarit të tij ligjor ose trashëgimtarit të caktuar me testament. Toka bujqësore nuk mund të disponohej me testament, por i kalonte trashëgimtarëve ligjor me kusht që këta të fillonin nga punimi i tokës brenda një viti

dhe më vonë 2 vjet nga çelja e trashëgimisë. Kur vdiste anëtari i fundit i kooperativës bujqësore toka që i ishte lënë për kopsht personal me përjashtim të tokës së zënë nga shtëpia e banimit i kalonte kooperativës bujqësore.

Në vitin 1955 janë miratuar një seri ligjesh: Kodi Civil (pjesa e përgjithshme); Dekreti mbi pronësinë dhe ai mbi sistemin agrar të tokave dhe regjistrimin e tyre” etj. Ligji mbi pronësinë përcaktonte llojet, format, objektet dhe subjektet, kufizimet, fitimin dhe humbjen e pronësisë, mjete e mbrojtjes së saj. Ky ishte një ligj i plotë lidhur me rregullimin juridik të pronës, ligj i cili do të përbënte një nga pjesët e Kodit Civil. Ndarja e tokës në toka bujqësore dhe jo bujqësore kishte një regjim të ndryshëm për secilën kategori. Toka bujqësore pavarësisht se në çfarë pronësie ndodheshin, nuk mund të tjetërsoheshin apo të jepeshin me qera, Ndërsa tokat jo bujqësore mund të disponoheshin nga pronari i tyre ose të tjetërsoheshin sipas rregullave të caktuar nga shteti. Më vonë u lejua disponimi dhe tjetërsimi nga pronarët, për tokat e zëna nga ndërtesat e ngritura mbi to si dhe oborret e këtyre ndërtesave ku tjetërsoheshin së bashku me ndërtesat. Në kadastrë regjistroheshin detyrimisht në bazë matjesh teknike (gjeodezike) të gjitha tokat bujqësore kudo që ndodheshin dhe në pronësi të kujt ishin. Regjistrimi kadastral shtrihej dhe në të gjitha tokat e tjera jobujqësore të fshatrave. Tokat jo bujqësore që ndodheshin në qytet regjistroheshin në zyrat e hipotekave. Në këtë mënyrë ligjvënësi sanksionoi për regjistrimin e tokave dy sistem kadastrën dhe hipotekën. Regjistrimi tokës kishte edhe rëndësi juridike për pronësi. Regjistrimi tokës në kadastrë shërbente për të provuar pronësinë mbi tokën. Quhej pronar i tokës ai që figuronte në regjistrat e kadastrës deri sa të provohej e kundërta. Kjo siguronte qëndrueshmëri të marrëdhënieve tokësore dhe mënjanonte çrregullime në pronësi.

## **2. Trashëgimia.**

Dekreti nr. 1892, datë 05.07.1954 “Mbi trashëgiminë” ishte hapi i parë legjislativ i nxjerrë nga pushtetit komunist pas çlirimit, i cili rregullon çështjet e trashëgimisë në Shqipëri. Në nenin 1/1 të Dekretit 1892/1954 parashikohej shprehimisht se: *“Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgim) së **personit** të vdekur (trashëgimlënës) një ose më shumë **personave** trashëgimtarë”*. Në analizë të kësaj dispozite vërehet qartë se Dekreti sanksiononte dhe garantonte një barazi të plotë ndërmjet femrës dhe mashkullit për sa i përket fitimit të së drejtave të pronësisë ndërmjet trashëgimisë ligjore. Në të njëjtën kohë në analizë të nenit 30 të Dekretit në të cilin parashikohet se: *“ Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm kryer nga vetë trashëgimlënësi me anë të cilit ky disponon pasurinë për kohën pas vdekjes...”* si dhe nenit (zotësia për të bërë testament) në të cilin parashikohet se: Testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç si dhe personi nën këtë moshë kur është i martuar...”. Edhe këtu duhet të mbajmë parasysh se termi *“trashëgimlënës”* apo *“**person**”*, përfshin si mashkullin ashtu dhe femrën. Në këtë kuadër vërehet qartë se Dekreti sanksiononte dhe garantonte një barazi të plotë ndërmjet femrës dhe mashkullit për sa i përket fitimit të së drejtave të pronësisë ndërmjet trashëgimisë. Në lidhje me trashëgimtarët ligjor në Dekretin “Mbi trashëgiminë” të vitit 1954,

vihet re një reduktim ose kufizim i rrethit të trashëgimtarëve ligjore deri në maksimum. Kjo po të bëjmë krahasim me rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të parashikuar nga Kodi Civil i vitit 1929. Kjo tendencë ishte në përputhje me qëndrimin që mbante shteti shqiptar i kësaj kohe ndaj pronës private.

Kodi civil i viti 1982 përbën në vetvete një kthim prapa në rregullimin e instituteve të së drejtës civile përfshirë dhe trashëgiminë, pasi prona private mbi sendet e paluajtshme ishte zhdukur përfundimisht sipas parashikimeve të Kushtetutës së viti 1976, dhe qarkullimi civil midis individëve ishte pakësuar në maksimumin e mundshëm. Në kushtet kur e gjithë prona e paluajtshme ishte shpallur pronë shtetërore dhe në kushte kur nuk ekzistonte pluraliteti i subjekteve të së drejtës kuptohet se dhe parashikimi i një numri të madh dispozitash për rregullimin e trashëgimisë ishte i panevojshëm. Kodi Civil i vitit 1982 nuk e konsideronte trashëgiminë si një institut të së drejtës civile por thjesht si një nga mënyrat e fitimit të pronësisë dhe instituti i trashëgimisë ishte përfshirë në institutin e pronësisë dhe rregullohej në Kreun III, të Pjesës së posaçme të këtij Kodi, konkretisht në kreun e mënyrave të fitimit të pronësisë.

Në nenin 94, të Kodit Civil të viti 1982 parashikohej se: *“Trashëgimia është kalimi me ligj ose me testament i pasurisë së **personit** të vdekur (trashëgimlënësit) një personi ose më shumë **personave** (trashëgimtarëve).”*. Në analizë të kësaj dispozite vërehet qartë se Kodi Civil sanksiononte dhe garantonte një barazi të plotë ndërmjet femrës dhe mashkullit për sa i përket fitimit të së drejtave të pronësisë ndërmjet trashëgimisë.

### **3. Marrëdhëniet familjare si dhe regjimi pasuror martesor**

E drejta socialiste në përgjithësi karakterizohet nga barazia ndërmjet burrit dhe gruas. Ky parim sanksionohej që në dokumentin e parë bazë që ishte Kushtetuta e vitit 1946, ku parashikohet shprehimisht një barazi ndërmjet burrit dhe gruas. Më pas ky parim u sanksionua dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të viti 1976, e cila parashikonte shprehimisht në nenin 41, të saj se burri dhe gruaja janë të barabartë, Ky barazim u materializua dhe në një sërë aktesh të tjera si në Kodin Civil të Viti 1981, apo edhe në Kodin e Familjes të Republikës së Shqipërisë të vitit 1982, në të cilin parashikohej se: Gruaja e çliruar nga shtypja politike dhe shfrytëzimi ekonomik si force e madhe e revolucionit gëzon të drejta të barabarta me burrin në familje (neni 6), apo edhe në Kreun IV të Kodit të Familjes “ Te drejtat dhe detyrat e bashkëshorteve.

### **KAPITULLI III: GRUAJA SI SUBJEKT I MARRËDHËNIES JURIDIKE CIVILE TË PRONËSISË NË REGJIMIN DEMOKRATIK**

Të drejtat e pronësisë në Shqipëri në periudhën postkomuniste ishin në qendër të reformave të ndërmarra për krijimin e një demokracie pluraliste të sundimit të ligjit. Ato kaluan në një proces që përfshiu ndryshime të mëdha legjislative dhe institucionale, duke vendosur mekanizma që do të ekuilibronin të drejtat individuale me ato kolektive. Për këtë arsye ka pasur një numër të madh masash të ndërmarra, të cilat mundësuan kalimin nga një sistem i centralizuar ekonomik në atë të ekonomisë së tregut dhe zhvillimit të lirë të tregjeve. Një aspekt kyç i këtij tranzicion ishte transferimi i pronës shtetërore, sidomos pasurisë së paluajtshme, në pronësi të private. U sanksionua në këtë mënyrë prova private, nisma e lire, veprimtarite tregëtare, investimet e huaja, e drejta për të marrë e për të dhënë kredi, e drejta për të punësuar e për tu punësuar dhe gjithë proceset dhe parimet e një ekonomie të tregut të lire.

Në kuadër të reformave shumëplanëshe një rol i rëndësishëm i është kushtuar edhe parimeve të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave. Shteti është angazhuar për forcimin e instrumenteve ligjore dhe institucionale që sigurojnë përfshirjen e politikave gjinore në çfarëdo niveli qeverisjeje. Në vitet e tranzicionit grave u është kushtuar një vëmendje e vecantë duke u përfshirë në grupet vulnerabël të shoqërisë, së bashku me fëmijët pleqtë apo personat me aftësi të kufizuara.

Sipas të dhënave nga Strategjia e Barazisë gjinore 2011- 2015, rezulton se struktura gjinore e popullsisë së Shqipërisë është e ekuilibruar, ku femrat zënë rreth 50% të popullsisë. Referuar raporteve midis popullsisë rurale dhe urbane, si pasojë e lirisë së lëvizjes, rezulton se popullsia urbane është rritur në 46% nga 36% që ka qenë në fillim të viteve '90-të. Tranzicioni ndikoi edhe për sa i përket strukturës së familjes. Një ndër treguesit që ka ndryshuar vitet e fundit është edhe moshja e martesës, nga 22.6 vjeç në 23.3 vjeç për femra dhe nga 27.2 vjeç në 29 vjeç për meshkuj. Po kështu kanë ndryshuar dhe numri i divorceve nga 9.6 divorce për 100 martesa në 2001 në 17 divorce për 100 martesa në 2008.<sup>3</sup>

Legjislacioni, duke filluar nga Kushtetuta dhe ligjet specifike, promovojnë konceptin e të drejtave civile, ekonomike e politike të barabarta për të gjithë. Angazhimi i shtetit për të garantuar të drejta të barabarta për burrat dhe gratë ka qënë i lartë dhe është pasqyruar në legjislacionin e miratuar, i cili ka bërë përpjekje për të sjellë gratë në një status sa më të afërt dhe të barabartë me burrat, përsa i përket çështjeve të punësimit, edukimit, shëndetit dhe pronës.

Megjithë strukturën e ngritur ligjore që promovon barazinë midis gjinive në realitet si në familje ashtu dhe në shoqëri roli i burrit mbetet dominant. Ai konsiderohet si shtylla e familjes, ndërsa

---

<sup>3</sup>Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, 2011-2015, miratuar me vendimin nr.573, datë 16.6.2011 të Këshillit të Ministrave



gruaja shihet më tepër si bashkëshorte dhe nënë. Ndonëse një perceptim i tillë është më i zbehtë në qendrat e mëdha urbane, dallimet mes gjinive, në qendrat larg kryeqytetit, apo në qytetet më të vogla dhe zonat rurale janë shumë të dukshme. Ndërkohë që gratë kujdesen për punët e shtëpisë, të bujqësisë, për fëmijët, burrat janë përgjegjës për mbarëvajtjen e ekonomisë familjare duke u marrëme biznes, shitjen e prodhimet bujqësore, menaxhimin e financave të familjes. Kjo gjë ka ndikuar ndjeshëm në aksesin e gruas në të drejtat e pronës dhe të drejtat të tjera reale që lidhen me të.

Pavarësisht nga një legjislacion bashkëkohor dhe jodiskriminues në lidhje me gratë, aplikimi në praktikë i të drejtave të barabarta, ka vend për përmirësim, vecanërisht në drejtim të promovimit të këtyre të drejtave dhe ndërgjegjsimi i grave mbi të drejtat e tyre në raport me burrat. Sa i përket gëzimit të së drejtës së pronës vihet re së toka është e regjistruar në emrin kryetarit të familjes që është burri, duke i kufizuar asaj të drejtat mbi pronën e përbashkët.

Sa i përket trashëgimisë, pavarësisht se Kodi Civil parashikon barazi ndërmjet burrave dhe grave në lidhje me problemin e trashëgimisë së tokës, në shumicën e rasteve është djali ai që trashëgon pronë, pasi gruaja me martesë konsiderohet se “humb” këto të drejta. Shpesh ky konstatim prezantohet si i saktë edhe nga vetë gruaja, e cila ndonëse ligjërisht gëzon të drejtën e trashëgimisë, vlerëson jo të domosdoshme që të kërkojë të drejtën, duke ecur drejt “parimeve” të aplikuara gjithmonë, në atë zonë apo krahinë.

Në këtë kuadër, ndonëse barazia ligjore midis burrit dhe gruas është snaksionuar në akte të detyrueshme për zbatim, ato humbasin efektin me vullnetin e lirë të gruas, apo për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit të tyre, se gëzimi i të drejtës së pronës dhe ekzistenca e një ekonomie të pavarur nga bashkëshortit, është thelbi i rritjes së rolit të gruas në familje dhe mundësia për të gëzuar me shumë të drejta vendimmarrëse në familje. Më poshtë, shkurtimisht kuadri ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar, që sanksionon detyrimimin e barazisë midis burrit dhe gruas.

## **i. Kuadri ndërkombëtar**

Për të vlerësuar rëndësinë e kuadrit ndërkombëtar të poshtëpërmendur duhet të mbahet në konsideratë roli i të drejtës ndërkombëtare dhe raportin i saj me të drejtën e brendshme. Ky raport, hierarkia, statusi dhe efekti e normave ligjore rregullohet nga vetë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë<sup>4</sup>. Bazuar në Kushtetutë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë një vend të rëndësishëm në rendin ligjor duke u radhitur në hierarkinë e normave menjëherëpas Kushtetutës e duke pasur në këtë mënyrëpersi mbi ligjet që nuk pajtohen me to. Dispozitat e

---

<sup>4</sup>Neni 116, 121-124 të Kushtetutës së R.Sh

marrëveshjeve zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe qytetarët apo ligjzotuesit mund t'iu drejtohen drejtpërsëdrejti atyre, me përjashtim të rasteve kur ato nuk janë të vetëzbatueshme dhe kërkojnë nxjerrjen e normave specifike.

Më poshtë, në kontekstin e këtij raporti, citohen aktet kryesore ndërkombëtare, të cilat sanksionojnë dhe garantojnë të drejta civile apo ekonomike të individit, përfshirë dhe gratësi pjesë e shoqërisë, apo instrumenta që përjashtojnë çdo formë diskriminimi ndaj grave në ushtrimin dhe gëzimin e këtyre të drejtave.

**1. Karta e Kombeve të Bashkuara**, e cila është ndërdokumentat e para të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, shpallur ndër parimet e saj të drejta të barabarta të burrit dhe të gruas.

**2. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut** përbën një dokument universal të të drejtave të njeriut, duke theksuar ndër vlerat e saj parimin e papranueshmërisë së diskriminimit. Ajo shpall se të gjithë njerëzit lindin të lirë e të barabartë në dinjitet e në të drejta dhe se secili mund të gëzojë të gjitha të drejtat dhe liritë që përmenden në të, pa asnjë dallim, duke përfshirë këtu dhe dallimin e bazuar në gjini. Ndër të tjera ajo garanton të se gjithkush ka të drejtën të ketë pasuri, si vetëm ashtu edhe në bashkëpronësi me të tjerët. Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij<sup>5</sup>.

**3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore**, i cili është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr.7511, Dt.08.08.1991, në nenin 3 të tij bën thirrje Shteteve palë për të siguruar të drejtën e barabartë të burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore të përfshira në Konventë

**4. Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike**, ratifikuar nga Kuvendi me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991, në nenin 23 të tij kërkon nga Shtetet Palë të marrin hapat e duhura për të siguruar barazinë e të drejtave dhe përgjegjësi të bashkëshortëve në lidhjen e martesës, gjatë martesës si dhe në rastin e mbarimit të saj.

**5. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore**, ratifikuar nga Kuvendi me ligjin Nr.8137, datë 31.7.1996, gëzimin e të gjithë drejtave dhe lirive, të përcaktuara në të, përfshirë këtu të drejtën e pronës<sup>6</sup>, e siguron duke mos bërë asnjë dallim të bazuar në gjininë e personit<sup>7</sup>.

Nëpërmjet **Protokollit 5 të KEDNJ** sanksionohet se barazia midis bashkëshortëve. Sipas këtij protokollit bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësi të karakterit të së

---

<sup>5</sup>Neni 17 i DUDNJ

<sup>6</sup>Parashikuar në protokollin shtesë të KEDNJ, amenduar me protokollin 11

<sup>7</sup>Neni 14 i KEDNJ

drejtës private midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj.

**Protokolli 12 i KEDNJ.** Nëpërmjet tij sanksionohet ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit. Ky protokoll parasheh se gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

**6. Karta Sociale Evropiane,** përbën një traktat kryesor evropian dhe e plotëson Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Karta Sociale Evropiane, e Rishikuar, e nënshkruar më 1998 dhe ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh në vitin 2002 po zëvendëson gradualisht Kartën Sociale Evropiane. Ajoka sanksionuar parimin e mosdiskriminimit duke parashikuar që gëzimi i të drejtave të parashikuara në të do të sigurohet pa diskriminim të çfarëdo shkak, përfshirë këtu edhe seksin.

**6. Konventa për Eliminimin e të Gjitha formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW),** ratifikuar nga Kuvendi me ligjin Nr.7767, datë 9 Nëntor 1993. Ky dokument me bindjen se gruaja meritonte vëmendje të posaçme dhe se ishte e diskriminuar për shkak të një sërë faktorësh historikë dhe kulturorë, sjell në vëmendje shoqërive gruan, me qëllim përcaktimin e një statusi të ri të saj në gëzimin e të drejtave të saj politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Kjo Konventë jep kuptimin e diskriminimit ndaj gruas<sup>8</sup> dhe ngarkon shtetet palë me detyrimin për të ndryshuar modele sociale e kulturore të sjelljes së burrit dhe të gruas, me qëllim zhdukjen e paragjyqimeve dhe praktikave zakonore, që e vendosin gruan në një pozicion inferior<sup>9</sup>.

Ndër të tjera kjo konventë detyron shtetet palë të marrin masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në fushat e jetës ekonomike dhe shoqërore e për t'i siguruar, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, të drejtat e njëjta. Ajo kërkon të sigurohen ndër të tjera<sup>10</sup>:

- barazia me burrin përpara ligjit, nënë fushën civile, zotësi juridike të njëjtë me atë të burrit dhe mundësi të njëjta për ta ushtruar këtë zotësi.
- të drejta të barabarta për të lidhur kontrata dhe për të administruar pasuri e i trajtojnë njësoj në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore.

---

<sup>8</sup>Ne nenin 1 të CEDAW shprehja "diskriminimi i gruas" nënkupton cdo dallim, përjashtim ose kufizim në bazë gjinie, që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë ose zhvlerësojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gruaja, cilado qoftë gjendja e saj martesore, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile ose në cdo fushë tjetër.

<sup>9</sup>Neni 5 i CEDAW Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme: (a) Për të ndryshuar karakteristikat dhe modelet sociale e kulturore të sjelljes së burrit dhe të gruas, në mënyrë që të arrijnë të zhdukin paragjykimet dhe praktikatat zakonore, dhe të gjitha praktikatat e tjera që mbështeten në idenë e inferioritetit ose të superioritetit të njërit apo të tjetrit seks, ose në rolet stereotipe të burrit dhe të gruas;

<sup>10</sup>Nenet 13, 14, 15 16 të CEDAW

- e drejta për hua bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kredisë financiare;
- eliminimin e diskriminimit ndaj gruas në zonat rurale, duke u garantuar atyre një sërë të drejtash, përfshirë këtu:
  - të drejtën për të përfituar kredi dhe ndihma bujqësore,
  - lehtësi tregtimi, trajtim të barabartë në fushën e reformave tokësore e agrare, si dhe në projektet e sistemit bujqësor,
  - të drejtën për të pasur kushte jetese të përshtatshme, sidomos lidhur me strehimin
- eliminimin e diskriminimit në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare. Në mënyrë të veçantë t'i sigurojnë gruas mbi bazën e barazisë mes saj dhe burrit:
  - Të drejtën dhe përgjegjësinë e njëjtë gjatë martesës dhe me rastin e prishjes së saj;
  - Të drejtat dhe përgjegjësitë e njëjta si prindër, pavarësisht nga gjendja martesore, për ato çështje që kanë të bëjnë me fëmijët. Në të gjitha rastet interesi i fëmijëve duhet të jetë në vend të parë;
  - Të drejtat e njëjta për secilin prej bashkëshortëve lidhur me pronësinë, blerjen, administrimin, gëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë.

Në kuadër të detyrimeve që burojnë nga kjo Konventë, Shqipëria raporton rregullisht mbi masat masat legjislative, administrative dhe gjyqësore të ndërmarra nga Qeveria për përmirësimin e statusit të grave në Shqipëri në përputhje me Konventën. Më datë 26 Korrik 2010, në selinë e OKB-së, u mbrojt Raporti i III i Qeverisë Shqiptare për zbatimin e Konventës paraqitur para Komitetit CEDAW në vitin 2008.

Sa i përket këtij raportimi, **Komiteti mbi Eliminimin e Diskriminimit të grave, paraqiti një sërë rekomandimesh kundër të tjera, në komentet përmbyllëse të datës 30 qershor 2010, i ka rekomanduar Shqipërisë:**

- që masat e përkohshme dhe të veçanta të zbatohen me qëllim që të sigurojnë barazinë e grave dhe burrave në mundësimin e pasurisë, kapitalit dhe kredive, ..., strehimit, dhe në përgjithësi të gjithë përbërësit e një standardi të përshtatshëm të jetesës, veçanërisht në lidhje me gratë që u përkasin grupeve të privuara, duke përfshirë gratë dhe vajzat që u përkasin minoriteteve gjuhësore dhe etnike, gratë e moshuara, gratë me aftësi të kufizuara, dhe gratë që banojnë në zonat rurale dhe të largëta.....
- që analiza e ndikimit gjinor i të gjithë politikave sociale dhe ekonomike dhe e masave që synojnë zbutjen e varfërisë të kryhet rregullisht. Ai rekomandon që të merren masa korrigjuese konkrete, duke përfshirë zgjerimin e mundësive për pasuri, hua dhe kredi dhe duke siguruar institucione të mjaftueshme të kujdesit ditor për fëmijët, në mënyrë që gratë, veçanërisht anëtarët e minoriteteve etnike ose që banojnë në zona rurale ose të largëta, si dhe gratë që janë kryefamiljare, të jenë plotësisht dhe njëjloj në gjendje të përfitojnë nga rritja dhe zbutja e varfërisë.

**7. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (2007/C 303/01)** në nenin 17 sanksionon të drejtën për të zotëruar, disponuar e të lërë trashëgim pasurinë e tij apo të saj të fituar ligjërisht, për të gjithë individët pa asnjë dallim. Askush nuk mund të privohet nga pasuria e tij/saj, përveçse në interes publik dhe në rastet dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj, në pajtim me një shpërblimi të drejtë duke u paguar në kohën e duhur për humbjen e pësuar.

**8. Direktivat e BE.** Ka një sërë direktivash të ndryshme të BE, që kërkojnë prej shteteve anëtare që parimi i trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave, të garantohet në një sërë fushash, si ekonomike, sociale, politike e kulturore. Roli i këtyre direktivave është i qartë në kushtet kur me statusin e vendit që aspiron për antarësimin në BE, Shqipërisë në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i duhet të përqsasë legjislacionin e brendshëm me atë të BE. Meqenëse e drejta e BE-së vendos standarde dhe mbrojtje në fushën ekonomike dhe të barazisë gjinore, ato do të duhet të përbëjnë një udhërfyes për legjislacionin apo praktikën e brendshme gjyqësore.

## ii. **Kuadri ligjor mbi barazinë gjinore**

Në vijim jepet një ide të përgjithshme e ligjeve më të rëndësishme kombëtare që lidhen me barazinë gjinore në Shqipëri. Sic do të vërehet ka një pasqyrim të primit të barazisë gjinore në dokumentat kryesore ligjore, por një nga shqetësimet kryesore në Shqipëri, sot, duket të jetë raportit midis barazisë *de jure* dhe *de facto*.

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë** me sanksionimin e parimit të barazisë e mosdiskriminimit<sup>11</sup>, bën që burri dhe gruaja, si subjekte të së drejtës, *de jure* të trajtohen njësoj, në mënyrë të barabartë dhe si pasojë të kenë edhe detyrime të njëjta. Parimi i barazisë përshkon të gjithë Kushtetutën dhe ligjet e tjera.

Kushtetuta ndër parimet e saj sanksionon se prona private, ekonomia e tregut dhe liria e veprimtarisë ekonomike janë shtyllat e sistemit ekonomik. Ajo vendos mbrojtje të njëjtë nga ligji si për pronën private ashtu edhe publike. Për kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike ajo parashikon rezervën ligjore, si dhe e lidh detyrimisht kufizimin me arsye të rëndësishme publike. Vetë Kushtetuta rendit disa nga mënyrat e fitimit të pronësisë si ajo me dhurim, me trashëgimi, me blerje duke deleguar mënyrat e tjera klasike tek Kodi Civil. Megjithëse e drejta e pronës hyn tek të drejtat që mund të kufizohet, vetë Kushtetuta parashikon garancinë që kufizime në të drejtën e pronësisë vendosen vetëm me ligj, për interes publik dhe përkundrajt një shpërblimi të drejtë. Prona nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

<sup>11</sup>Neni 18 I kushtetutës

**Ligji Nr. 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”** mbron qytetarët nga çdo lloj diskriminimi që kryhet mbi bazë gjinie, garantimi i mundësive dhe shanseve të barabarta si për meshkujt edhe për femrat, për të arritur standarde sa më të larta në fushën e barazisë gjinore. Ligji, i cili në bazë të tij mban parasysh parimet më të rëndësishme ndërkombëtare jep përkufizimin e diskriminimit gjinor: *“Diskriminim për shkak të gjinisë, përbën çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin në mënyrë të barabartë nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile”*.

**Kodi Civil dhe ai i Procedurës Civile** iu njohin grave zotësinë juridike që me lindjen e tyre, si dhe zotësinë juridike për të vepruar me mbushjen e moshës madhore, njësoj si edhe burrave. Në dispozitat e tyre përdoret gjuhë asnjëanëse dhe garantohen të drejtat pa bërë dallime midis dy gjinive. Kodi Civil rregullon, pa bërë dallime midis dy gjinive:

- mënyrat e fitimit dhe të humbjes së pronësisë<sup>12</sup>
- tagrat kryesore të pronarit, si e drejta për të poseduar gëzuar, e disponuar pasurinë<sup>13</sup>.
- kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to,<sup>14</sup>
- nevojën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në regjistrat publike<sup>15</sup>
- rregulla mbi bashkëpronësinë e detyrueshme, atë në pjesë, si dhe mbi pjestimin apo tjetërsimin e pasurisë së përbashkët<sup>16</sup>
- radhën dhe të drejtat që burojnë nga trashëgimia
- Kontratat që aplikohen në qarkullimin civil

**Kodi i Familjes** në të gjitha çështjet e trajtuara bazohet në reciprocitetin e bashkëshortëve në të drejta dhe detyrimet që derivojnë nga familja dhe martesë. Ai sanksionon barazinë e bashkëshortëve në lidhjen e martesës, duke parashikuar kushte dhe ndalime të njëjta si për gratë edhe për burrat, për pavlefshmërinë dhe mbarimin e martesës dhe pasojat e saj, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë, marrëdhëniet personale dhe të pasurore midis bashkëshortëve, çështjet e amësisë dhe atësisë, birësimi, kujdestarisë etj.

Martesa parashikon për bashkëshortët të drejta dhe detyrime me karakter **pasuror**, si detyrimin për ndihmë materiale apo kontributet e bashkëshortëve për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga martesë.

---

<sup>12</sup>Nenet 192-198 të Kodit Civil

<sup>13</sup>Neni 149 i Kodit Civil: Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji

<sup>14</sup>Neni 83 i Kodit Civil: Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm

<sup>15</sup>Neni 192 i Kodit Civil: Në regjistrat e pasurive të paluajtshme regjistrohen sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent.

<sup>16</sup>Neni 199-231

**Kodi i Punësiu** njeh të drejta të barabarta si burrit dhe gruas për të zgjedhur lirisht profesionin, të drejtën për shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë; të drejtën e pushimeve vjetore të paguara; etj. Në nenin 9 të tij ndalon çdo lloj diskriminimi në punësim dhe veprimtarinë profesionale, pa specifikuar punëdhënësin, i cili mund të jetë një institucion publik apo person privat.

Në **Kodin e Procedurave Administrative** mos-diskriminimi është një prej parimeve themelore. Ai përcakton se organet e administratës publike duhet të udhëhiqen nga parimi i barazisë. Askush nuk duhet të diskriminohet për shkak të seksit, racës, etnisë, bindjeve filozofike apo fetare, gjendjes ekonomike, arsimore apo prindërore (Neni 11).

**Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale** mbrojnë në mënyrë të barabartë si burrat dhe gratë, por i vendosin pa diskriminim edhe përpara përgjegjësisë penale kur ata janë subjekte të veprave penale. Kodi Penal përmban sanksionet më të rënda për diskriminimin. Neni 253 thotë se dallimet mbi bazë origjine, seksi... të kryera nga ana e punonjësit shtetëror apo në shërbim publik, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.

### iii. **Kuadri politik**

#### ➤ **Programi Politik i Qeverisë<sup>17</sup>**

Programi politik i qeverisë, paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë më 16.09.2009 parashikon ndër objektivat e shpallura reformat në fushën e pronësisë si dhe ato të promovimit të parimeve të barazisë gjinore.

Në këtë mënyrë qeveria angazhohet:

- Se do të vazhdojë reformën e nisur të garantimit dhe gëzimit të të drejtave të pronës. Përmirësimet ligjore dhe ato administrative, përdorimi i teknologjisë se informacionit, eliminimi ligjor i abuzimeve me pronat si dhe realizimi në shkallë gjithnjë e më të lartë të procesit të kthimit e kompensimit të pronave do të përbëjnë drejtimit bazë të reformës pronësore. Suksesi i reformës pronësore shihet jo vetëm një e drejtë individuale por edhe një kusht për vetë zhvillimin ekonomik dhe harmoninë sociale të vendit.
- Për promovimin e parimeve të barazisë gjinore, si dhe forcimin e instrumenteve ligjore dhe institucionale mbrojtës për të siguruar politikat gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes.

<sup>17</sup><http://km.gov.al/?fq=preprog/programi>

- Të iniciojë programe konkrete për të siguruar trajnimi dhe kualifikim profesional falas dhe skema punësimi për gratë kryefamiljare dhe ato të komuniteteve të marginalizuara. Programet sociale do të kenë në fokus rritjen e shërbimeve sociale për gratë kryefamiljare, nënat me shumë fëmijë, vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara, gratë e komunitetit rom dhe ato që janë viktime të trafikimit apo rrezikohen të jenë viktime.
- **Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, 2011-2015<sup>18</sup>**, gjithashtu planifikon politikat dhe masat e veprimit që do të garantojnë një barazi reale mes dy gjinive.

Ky dokument fuqizimin ekonomik të vajzave dhe grave e sheh si të rëndësishëm në arritjen e barazisë gjinore de facto. Strategjia parashikon masa për fuqizimin ekonomik të grave, sidomos atyre në zonat rurale. Për këtë arsye në objektivat strategjike të saj ajo e ka fuqizimin ekonomik si zë të vecantë, ku një ndër objektivat e vendosur është dhe rritja dhe përmirësimi i aksesit në kapitalin financiar dhe asete për një pjesëmarrje më aktive në jetën ekonomike të grave.

Kjo strategji në kuadër të nxitjes së sipërmarrjes së grave, dhe dhënies së një statusi të qartë ligjor për gruan, të pavarur nga burri, kërkon ndër të tjera:

- Rishikimin e legjislacionit bankar për t'i dhënë mundësi grave për të marrë kredi lehtësuese
- Rishikim të legjislacionit mbi zotërimin e pronësisë. Amendamentet duhet të adresojnë veçanërisht vakumin ekzistues ligjor në rastet e martesës ose zgjidhjes së saj.

Me qëllim arritjen e këtij objektiv në planin e masave parashikohet që:

- Të ngrihet rrjet kreditimi për gratë
- Të organizohen sesione informimi për menaxhimin e biznesesve dhe përdorimin e kredive
- Të mundësohet akses i grave rurale në pronë dhe në asete të tjera si pyjet, burimet natyrore nëpërmjet rregullimit të kuadrit ligjor për pronën.
- **Strategjia ndërsektoriale “Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012 – 2020”**

Edhe kjo strategji parasheh të drejtat e pronësisë nën një perspektivë gjinore. Për këtë arsye parashihet që prioritetet strategjike do të përshkohen nga perspektiva gjinore për të mundësuar aksesin e grave dhe kontrollin e tyre mbi burimet produktive dhe ekonomike në funksion të

<sup>18</sup>Miraturar me vendimin nr.573, datë 16.6.2011 të Këshillit të Ministrave.



fuqizimit të tyre. Fokus i vecantë i jepet gjendjes sëgrave në zonat rurale e cila shihet si e pafavorshme.

Për këtë arsye, ndër masat e planifikuara për tu marrë, në kuadër të planifikimeve strategjike parashikohet:

- Respektimi si dhe promovimi barazisë gjinore, në procesin e regjistrimit të pronave.
- Vlerësimi i legjislacionit ekzistues me qëllim harmonizimin dhe thjeshtëzimin e tij, respektimin e barazisë gjinore dhe ndërmarrja e nismave të reja ligjore në fushën e të drejtave të pronësisë;
- Respektimi i të drejtave të barazisë gjinore në dhënien e vendimeve për çështjet e pronësisë
- rritjen e aksesit të grave në institucionet për të drejtat e pronësisë,
- trajnime të stafeve qendrore dhe lokale që merren me të drejtat e pronësisë, fushata sensibilizuese për informimin dhe promovimin e të drejtave të grave.

Këto masa janë planifikuar të merren në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore e Dhunës në Familje.

#### ➤ **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2007-2013).**

Synimi i kësaj Strategjie në fushën e barazisë gjinore është “arritja e barazisë gjinore nëpërmjet integritit të perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e hartimit dhe zbatimit të politikave. Kjo do të thotë pjesëmarrje e barabartë e grave/vajzave dhe e burrave/djemve në jetën shoqërore, ekonomike e politike të vendit, si dhe mundësi të barabarta për shërbime publike, duke siguruar rezultate të barabarta për të dyja gjinitë, në mënyrë që të gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre dhe t'i vënë në shërbim të shoqërisë potencialet individuale”. Vizioni i saj është krijimi i një vendime nivel të lartë jetese, të integruar në strukturat europiane dhe euro-atlantike, demokratik dhe garantues të lirive e të drejtave themelore të njeriut.

Ndër përparësitë strategjike, në kuadër të këtij studimi, mund të përmendim:

- Përmirësimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe institucional, i cili garanton barazinë gjinore
- Fuqizimin ekonomik të grave përmes rritjes së numrit të tyre si sipërmarrëse
- Mbështetje për gratë dhe vajzat e pambrojtura përmes fuqizimit të strukturave publike.

#### **4. Analizë e akteve ligjore në këndvështrim gjinor dhe të barazisë gjinore: Problematikë ligjore apo mentalitete zakonore**

Shqipëria është duke përjetuar momente të rëndësishme historike në drejtim të aspiratës të saj europiane, i cili padiskutim duhet të shoqërohet me thellimin e reformave, në funksion të përafrimit të legjislacionin shqiptar me atë të vendeve më të përparuara të Bashkimit Europian. Një nga fushat që duhet të analizohet në funksion të përjasjes së legjislacionit të brendshëm me standardet më të mira europiane legjislacioni mbi të drejtën e pronësisë, parë nga këndvështrimi gjinor dhe i barazisë gjinore. Aktualisht, aktet dhe mënyrat për fitimin e të drejtave të pronësisë janë të shumta, por zbatimi i tyre praktik, tregon se gruaja ende nuk ka rolin që i takon të gëzimit dhe administrimit të pronës, si mënyra e vetme për zhvillimin social dhe ekonomik të saj.

### ***i. Mënyrat e fitimit të të drejtës së pronësisë***

Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji. Në bazë të legjislacionit shqiptar, ajo fitohet sipas mënyrave të caktuara në Kodin Civil dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë<sup>19</sup>. Kodi Civil liston një sërë mënyrash të fitimit të kësaj të drejte, dhe lë mundësinë që mënyra të tjera të mund të parashikohen edhe me ligje të posacme që mund të dalin në bazë të nevojave që mund të sjellë koha. Aktualisht, sic mund të shihet në vijim, tituj pronësie sot janë krijuar edhe me një sërë ligjesh specifike.

Duke pasur si fokus gratë, ndër mënyrat kryesore sipas të cilave bëhet fitimi apo gëzimi i të drejtave të pronësisë, mund të përmendim:

- ▶ Veprimet juridike;
- ▶ Familjen bujqësore;
- ▶ Trashëgiminë;
- ▶ Martesën;
- ▶ Ligjet specifike.

#### **a. Mënyrat e fitimit të pronësisë në bazë të një veprimi juridik**

Fitimi i pronësisë nëpërmjet veprimit juridik është një nga mënyrat më të përhapura që parashikohet në Kodin Civil. Kodi Civil jep kuptimin e kontratave të ndryshme, kushtet e lidhjes dhe të vlefshmërisë së tyre. Nëpërmjet kontratave një ose disa pale krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike<sup>20</sup>. Sa i takon kontratave nuk ka kufizime në lidhjen e tyre apo në shprehjen e vullnetit të lirë përsa i takon grave.

Në kuadër të këtij studimi, mund të vecojmë dy nga kontratat që ndikojnë drejtpërdrejt në gëzimin e kësaj të drejte nga gratë, kryesisht në cilësinë e tyre si bashkëshorte:

---

<sup>19</sup>Neni 149 dhe 163 i Kodit Civil

<sup>20</sup>Neni 659 I Kodit Civil

- ▶ Kontrata e shitjes/kontrata e blerjes;
- ▶ Kontrata e dhurimit.

Sa i përket kontratës së shitblerjes Kodi Civil jep kuptimin e saj duke përcaktuar se kjo kontratë ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi<sup>21</sup>. Po kështu përcakton se kontrata e shitjes së sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm.<sup>22</sup>

Shpesh për shkak të mentalitetit mbizotërues, është bashkëshorti ai që kryen veprime juridike me të tretët dhe në kontratat e shitjes, vullneti i tyre shpesh është përcaktues. Ky mentalitet mbizotërues është i lidhur ngushtë jo vetëm me zhvillimin dhe emancipimin e shoqërisë shqiptare, por vjen si rrjedhojë e zbatimit të disa traditave të trashguara brez pas brezi nga e kaluara. E drejta zakonore i njihje tagra të shumta Kryefamiljarit, dhe pushteti e tagrat e tij shpreheshin ekskluzivisht në të drejta e pronësisë, pasi vetëm ai kishte të drejtë të blinte, të shiste tokën, shtëpinë, bagëtinë ose çdo pasuri tjetër.

Aktualisht vërehet se në jo pak raste duke qenë se veprimet juridike kryehen nga bashkëshortët, pronat të cilat blihen figurojnë në kontratë në emër të tyre, pavarësisht kontribit të gruas në blerjen e kësaj pasurie, apo faktit që mund të jetë pasuri e fituar gjatë marrëdhënies matesore dhe për pasojë, sipas ligjit, prezumohet në bashkëpronësi të burrit dhe gruas. Një pasqyrim i tillë në kontratë reflektohet edhe në regjistrimin e pronës në ZRPP. Aktualisht ZRPP nuk mban të dhëna mbi ndarjen në përqindje mbi gjininë e pronarëve të pasurisë së paluajtshme<sup>23</sup>. Megjithatë, praktikat e punës kanë treguar se numri i kërkesave të grave për regjistrim pasurie, është i ulët dhe larg barazisë me burrat.

Nga ana tjetër, mungesa e regjitrimit të gruas si bashkëpronare, passsjell “zhveshjen” e saj nga e drejta e pronësisë në mënyrë jo të drejtë. Kjo për faktin se noterët në jo pak raste nuk bëjnë verifikimin nëse prona objekt kontratë është pronë që bën pjesë në pasurinë vetjake të bashkëshortit apo bën pjesë në pasurinë e përbashkët të tyre. Ato mjaftohen në kontrollin e dokumentit të pronësisë, ku figuron emri i pronarit, por pa bërë vlerësime nëse aplikohen dispozitat ligjore mbi regjimin pasuror martesor. Pavarësisht se mosekzistenca e emrit të gruas nuk e privon në asnjë rast atë nga e drejta e pronësisë mbi një pasuri të vënë gjatë ekzistencës së martesës, në kushtet e gjendjes përbashkët të kryera të shitjes së pasurive, rrugë e vetme e realizimit të së drejtës së pronësisë mbetet gjykata. Megjithëse nga praktika gjyqësore rezulton se edhe kjo e drejtë në rrugë gjyqësore kërkohet vetëm në rastin e zgjidhjes së martesës, pasi gjatë ekzistencës së saj shumë rrallë mundë të ndodhë që bashkëshortet të paraqesin padi për pjesëtim

<sup>21</sup>Neni 705 I Kodit Civil

<sup>22</sup>Neni 83 dhe neni 750i Kodit Civil

<sup>23</sup> Sistemi i ri elektronik i regjistrimit të pasurive të paluajtshme ka planifikuar përfshirjen e një ndarje të tillë, por të dhënat nuk përpunohen ende.

pasurie gjatë martesës. Gjithashtu, në jo pak raste padijenja e të drejtave ose paaftësia dhe pamundësia e realizimit të tyre, vecanërisht për gratë në zonat rurale apo në zonat e thella të Shqipërisë, mund të bëjë që ato mos arrijnë të fitojnë gjyqësisht të drejtën e tyre.

Edhe në rastin kur prona mund të jetë në emër të të dy bashkëshortëve, mund të ndodhë që vullneti i tyre pavarësisht se mund të shprehet të mos rezultojë realisht. Pavarësisht se ato mund të figurojnë në kontrata apo në ZRPP si bashkëpronare, përcaktues në shitjen e objektit është vullneti i bashkëshortit. Pavarësisht se ligji jep garanci të mjaftueshme për gruan që të shprehë vullnetin e saj, qoftë nëpërmjet aktit të përfaqësimit apo shprehjes së vullnetit në kontratë si bashkëpronare, në praktikë rezulton që zakonisht këto garanci nuk përdoren me qëllimin për të cilin janë vendosur. Ndodh që vullneti i gruas të jetë formal, vetëm për plotësimin e kriterëve të vlefshmërisë së kontratës. Kjo është e lidhur ngushtësisht me ekzistencën e mentalitetin se burri është Kryefamiljarë dhe si i tillë vendimet e rëndësishme mbi çështjet familjare (përfshirë edhe ato të lidhura me pronën) duhet të merren prej tij. Një mentaliteti i tillë ka ekzistuar që nga e drejta zakonore dhe vazhdon në jetë prezen edhe sot.

Po kështu, i njëjti problem mund të rezultojë edhe me kontratat e dhurimit. Sipas Kodit Civil, dhurimi është një kontratë me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat ajo i pranon<sup>24</sup>. Kodi përcakton se dhurimi i sendeve të paluajtshme duhet të bëhet me akt publik dhe të regjistrohet, përndryshe është i pavlefshëm. Pranimi mund të bëhet me po atë akt, ose me akt të mëvonshëm. Në këtë rast dhurimi quhet i përfunduar nga momenti kur akti i pranimi i është njoftuar dhuruesit.<sup>25</sup>

Problemet në praktikë lidhur me dhurimin vijnë për shkak të mosverifikimit nga noterët kur bëhen veprime juridike të statusit të pasurisë që dhurohet, nëse ajo është pasuri e përbashkët e bashkëshortëve apo hyn në pasuritë individuale të tyre. Për faktin se pronat mund të jenë në emër të bashkëshortit ai, mund të mos ketë pengesë në dhurimin e një pasuri të përbashkët në emër të të afërmeve të tij, pa marrë pëlqimin e bashkëshortes. Pavarësisht se mund të provohet ekzistenca e pronës në bashkëpronësi, rruga gjyqësore mbetet alternativë e vetme e rimarrjes në posedim të pronës dhe të drejtës së pronësisë.

E gjithë kjo praktikë bën të pamundur ndërmarrjen e iniciativave ekonomike nga ana e gruas. Ajo, në çdo rast do të jetë e dobët në raport me burrin, duke iu nënshtruar vullnetit dhe vendimmarrjes së tij. Mospasja e një ekonomie të pavarur ka qenë shpesh arsyeje që edhe pse në kushte jo të favorshme emocionale apo familjare, bashkëshortet të kenë vijuar bashkëjetesën edhe pa vullnetin e tyre, por të diktuar nga rrethanat dhe pamundësitë e një jete të pavarur.

---

<sup>24</sup>Neni 761 i Kodit Civil

<sup>25</sup>Neni 764 i Kodit Civil

## **b. Të drejtat e pronësisë në kuadër të bashkëpronësisë midis anëtarëve të familjes bujqësore**

Një ndër format e bashkëpronësisë së detyrueshme ligjore, është dhe bashkëpronësia midis anëtarëve të familjes bujqësore.<sup>26</sup> Pronësia mbi pasurinë në këtë rast u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara, kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore<sup>27</sup>. Në pasurinë e kësaj familjeje nuk përfshihen sendet e përdorimit thjesht vetjak të anëtarëve, si dhe sendet që anëtari ka fituar me të ardhurat e tij vetjake, me dhurim ose me trashëgim<sup>28</sup>.

Në kuadër të pjesëmarrjes në familjen bujqësore gratë mund të gëzojnë të drejta pronësie mbi pasurinë, si anëtare të familjes, për shkak të lidhjeve gjinore, të birësimit apo martesës që kanë me anëtarët e familjes.<sup>29</sup> Ato, si anëtare të saj, gëzojnë të drejtën e pronësisë, si bashkëpronare me anëtarët e tjerë të familjes bujqësore, kryesisht në sajë të kontributit të përditshëm që japin në mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Në marrëdhëniet pasurore me të tretët familja bujqësore përfaqësohet nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj. Ligji nuk bën ndonjë dallim sa i përket gjinisë së kryetarit dhe nuk ka pengesë që edhe vete gratë të jenë të tilla, megjithatë në kushtet e mbizotërimit të një mentaliteti patriarkal, kryetarë të këtyre familjeve janë burrat. Kjo lidhet jo vetëm me rolin mbizotërues të burrit ndaj gruas, por edhe për shkak të figurës autoritare që ka babai karshi fëmijëve të tij.

Edhe pse gratë gëzojnë të drejtat e pronësisë në bashkëpronësi, ligji u jep mundësinë atyre që të mund të kërkojnë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore. Në këtë rast pjesa vlerësohet dhe jepet në para, duke marrë parasysh sidomos:

- a) pasurinë që i përket tërë familjes;
- b) numrin e anëtarëve të familjes;
- c) kontributin e në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

Pjesëtimi i pasurisë së familjes bujqësore, bëhet sipas rregullave të caktuara në Kodin Civil, për pjestimin e sendit të përbashket. Të drejtën për të marrë pjesë në natyrë ligji e lidh vetëm me rastin kur pjesëtimi kërkohet nga disa pjesëtarë të familjes bujqësore, me qëllim që të krijohet një

---

<sup>26</sup>Neni 222 e në vijim I Kodit Civil

<sup>27</sup>Neni 222 i Kodit Civil

<sup>28</sup>Neni 225 i Kodit Civil

<sup>29</sup>Neni 223 i Kodit Civil

familje tjetër bujqësore, me kusht që toka bujqësore që u mbetet familjeve të ndara, të mos jetë nën minimumin e njësisë minimale të kultivimit<sup>30</sup>.

Pavarësisht kësaj të drejtë që ligji i njih grave si anëtare të familjes bujqësore, në praktikë ajo thuhet nuk aplikohet. Gratë, në pjesën më të madhe, nuk janë të ndërgjegjshme për të drejtën e kërimit të pjesës së tyre, si në rastin kur kur banojnë në familjen e origjinës, ashtu edhe kur shkeputen prej saj në rastin e martesës. Zakonet e zonës kanë treguar se pasuria i mbetet djemëve, të cilët vazhdojnë të jenë të lidhur me tokën dhe kujdesen për kultivimin dhe mirëmbajtjen e saj. Kjo praktikë ka impakt të drejtëpërdrejt në pasurimin dhe pavarësinë ekonomike të gruas, e cila në rast të zotërimit të pasurisë që i takon me ligj, do të kishte një pozitë tjetër shoqërore, duke u ndjerë e barabratë me burrin.

Gjithashtu, nëse do të mbanim parasysh të ardhurat e këtyre familjeve, kjo e drejtë do të ishte edhe e vështirë për tu materializuar realisht. Madje ajo që rezulton është që gratë në cilësinë e vajzave, në momentin e martesës në mënyrë të heshtur heqin dorë nga pasuria e familjes bujqësore në favor të vëllezërve të tyre dhe pjesëtarëve të tjerë meshkuj të familjes. Ato konsiderohen se i humbin këto të drejta në familjen e origjinës për faktin se do të kenë akses në pasurinë e familjes së bashkëshortit të tyre. Kurse përsa i përket rastit të krijimit të një familjeje tjetër, sipas të cilit pasuria e familjes do të ndahej në natyrë, kjo është një e drejtë që zakonisht përdoret nga anëtarët meshkuj në rastin e martesave dhe krijimit të familjeve të reja.

Në mungesë të mentalitetit të gruas për të kërkuar të drejtat e saj të pronësisë, do të ishte e arsyeshme që vetë ligji të parashikonte një mekanizëm ligjor për të garantuar që pjesa që i përket gruas nga pasuria e familjes bujqësore të ishte e ndarë. Në këtë mënyrë, kjo do të shmangte fenomenet kur pasuria, edhe pse e regjistruar në emër të anëtarëve të familjes bujqësore, të administrohej nga burri, i cili në mënyra të ndryshe e konsideron veten pronarë të vetëm të pasurisë.

### **c. Fitimi i së drejtës së pronësisë nga trashëgimia**

Të drejtat e grave në lidhje me të drejtën e tyre për ta trashëguar pronën janë një ndër treguesit kryesorë për realizimin e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në ekonomi. Mos realizimi në praktikë i të drejtave trashëgimore, sidomos atyre mbi sendet e paluajtëshme, ndikon në mënyrë të drejtë në rolin social të grave, sidomos në zonat rurale. Në sajë të mosrealizimit të kësaj të drejte, ato shumë pak kanë mundësi të jenë sipërmarrëse të bizneseve të ndryshme apo të kenë kolateralin e nevojshëm për të marrë kredi nga bankat.

---

<sup>30</sup>Neni 227 dhe neni 228 i Kodit Civil

Edhe pse të barabartë para ligjit, si rezultat i kulturës, traditës apo nivelit arsimor, gratë nuk i përfitojnë të gjitha të drejtat nga trashëgimia. Në këtë kontekst, mënyra e ndarjes së pasurisë në rastin e trashëgimisë zakonisht bëhet pa marrë në konsideratë të drejtat e saj. Madje, të përhapura janë edhe rastet, sidomos në zonat rurale, kur ato heqin dorë në mënyrë vullnetare nga pjesa që u takon nga trashëgimia, duke ua lanë mundësinë që këtë pasuri ta gëzojnë anëtarë të tjerë të familjes. Në shumë familje në zonat rurale gratë nuk trashëgojnë pronë kur u vdesin baballarët ose burrat.

Kështu, mënyra tradicionale e gëzimit të së drejtave që burojnë nga trashëgimia vazhdon të jetë për gratë faktor përjashtues nga vendimmarrja në kuadër të familjes dhe njëkohësisht legjitimon rolin dominant dhe superior të burrit apo kryefamiljarit duke I dhënë asaj një status jot ë barabartë social.

Në ndryshim nga sa u përmend më sipër, për të drejtën zakonore, sipas legjislacionit të sotëm gruaja është anëtar me të drejta të plota në familje. Dispozitat e kodit civil që rregullojnë këtë institut të rëndësishëm të së drejtës dhe mënyrë të fitimit të pronësisë janë bashkëkohore dhe rregullojnë pa diskriminim çështjen e të drejtës së trashëgimisë së grave. Pavarësisht se në cfarë cilësie trashëgon ( bashkëshorte, vajzë, motër, nënë, etj) gruaja, në Kodin Civil ka një pozitë të barabartë me burrin. Megjithëse Kodi nuk ka një dispozitë specifike ku të përmendet shprehimisht barazia e dy gjinive sa u përket të drejtës për të trashëguar, kjo del nga fryma e tyre dhe nga parimet e përgjithshme të kodit të cilat garantojnë gëzimin e të drejtave të barabarta për të gjithë. Po kështu gjuha asnjëanëse e përdorur nuk përbën pengesë në gëzimin e të drejtave të barabarta midis burrave dhe grave. Rregullimi i të drejtave trashëgimore në legjislacionin shqiptar bëhet në dispozitat e Kodit Civil, nenet 316- të tij. Trashëgimia përkufizohet si kalim me ligj ose me testament i pasurisë (trashëgimit) të personit të vdekur, një ose më shumë personave (trashëgimtarë)<sup>31</sup>.

Në këtë mënyrë Kodi njih dy lloj trashëgimie, atë ligjore dhe testamentare. Dispozitat e trashëgimisë ligjore kanë karakter lejues. Në këtë mënyrë ato janë të aplikueshme vetëm në rastet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament, ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij, ose kur testamenti është tërësisht ose pjesërisht i pavlefshëm. Kritere kryesore që mbahen në konsideratë në ndarjen e trashëgimisë sipas Kodit dhe në përcaktimin e rrethit të trashëgimtarëve janë martesë dhe lidhjet e gjakut.

Në kuadër të trashëgimisë ligjore gratë mund të trashëgojnë në cilësinë të ndryshme. Rrethi i trashëgimtarëve ligjorë ka në përbërje fëmijët, fëmijët e fëmijëve, bashkëshortin, prindërit, vëllezërit e motrat, fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur, gjyshin e gjyshen e të paralindurit e tjerë, personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, të afërmit e tjerë

---

<sup>31</sup>Neni 316 I Kodit Civil

deri në shkallën e gjashtë, si dhe shtetin. Gjuha e përdorur nuk lë shkas për të bërë dallime midis dy gjinive.

Kodi Civil parashikon radhën e thirrjes në trashëgim duke përcaktuar si në vijim.

1. Kështu **në radhë të parë** thirren fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta. Kur përveç bashkëshortit, nuk ka trashëgimtarë të tjerë, të radhës së parë, në trashëgimi thirren ata të radhës pasardhëse, të parashikuar dhe kur nuk ka të tillë, thirren trashëgimtarët e radhës tjetër pasardhëse. Në çdo rast bashkëshorti merr 1/2 pjesë të trashëgimit. Kur nuk ka trashëgimtarë të radhëve të sipërme, trashëgimi I mbetet bashkëshortit pasjetues.
2. Në **radhë të dytë** thirren në trashëgim prindërit e trashëgimlënësit dhe personat e paaftë për punë, të cilët të paktën 1 vit para vdekjes së trashëgimlënësit, bashkëjetonin me atë si anëtarë të familjes dhe në ngarkim të tij.
3. Në **radhë të tretë** thirren në trashëgim personat e paaftë për punë në ngarkim të trashëgimlënësit, kur nuk ka trashëgimtarë të tjerë të radhës së dytë, gjyshi e gjyshja, vëllezërit e motrat, si dhe fëmijët e vëllezërve e të motrave të paravdekur. Të sipërmit trashëgojnë në pjesë të barabarta, pa u bërë dallimi ndërmjet vëllezërve e motrave të një ati ose vetëm të një nëne, ndërmjet gjyshit e gjyshes nga ana a babës ose e nënës.
4. Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë të paslindur, as prindër ose të paralindur të tjerë, as vëllezër ose motra, apo të paslindur të këtyre, pasuria e trashëgimlënësit u kalon të afërmit më të afërt të tij, pa bërë dallim ndërmjet vijës atërore dhe asaj amësore, por gjithsesi jo më tej se shkalla e gjashtë.
5. Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, thirret në trashëgim shteti.

Trashëgimtarët e një radhe të mëpasme thirren në trashëgim vetëm kur nuk ka trashëgimtarë të radhës së mëparëshme ose kur këta të gjithë janë bërë të padenjë ose kanë hequr dorë nga trashëgimi ose janë përjashtuar nga trashëgimi, përveç kur nga trashëgimtarët e radhës së dytë mbetet trashëgimtari i paaftë për punë dhe ka trashëgimtarë të radhës së tretë.

Sa i përket, të drejtave që gëzojnë gratë nga këto dispozita, shohim se ka një lloj përkrahje nga ligji për bashkëshorten. Ajo, zë një vend të rëndësishëm në hierarkinë e trashëgimtarëve, duke dalë që në radhën e parë të tyre. Ligji ka pasur si qëllim të tij që të përmirësojë gjithnjë e më shumë situatën e bashkëshortit pasjetues e në këtë mënyrë edhe atë të bashkëshortit femër. Kjo pasi të drejtat trashëgimore të saj duhet të vihen në balancë me atë të trashëgimtarëve të tjerë me qëllim për ti garantuar kushte normale jetese edhe pas vdekjes së bashkëshortit, duke marrë në konsideratë që zakonisht në një familje ato kontribuojnë kryesisht me mirëmbajtjen e saj apo rritjen e fëmijëve.



Hierarkia e trashëgimtarëve ka në krye të listës bashkëshortin që është gjallë, vetëm apo në konkurrencë me trashëgimtarë të tjerë. Që bashkëshorti të përfitojë të tilla të drejta është e nevojshme që martesë të ketë qenë e vlefshme deri në ditën e vdekjes së trashëgimlënësit. Në këtë mënyrë, Kodi Civil i njeh këto të drejta vetëm gruas në cilësinë e bashkëshortes që buron nga një martesë e vlefshme, duke mosnjohur të drejtën e grave bashkëjetuese, të cilat mund të kenë një kohë të caktuar bashkëjetese apo edhe fëmijë. Në kushtet e aplikimit në një masë të madhe të bashkëjetesave kjo mund të shihet si mangësi. Kodi mund të marrë në konsideratë edhe të drejtat e kësaj kategorie grash, duke e lidhur këtë të drejtë me një kohë të caktuar bashkëjetese dhe me ekzistencën e fëmijëve, në mënyrë që të mos i vërë ato në një pozitë të disfavorshme e duke marrë në konsideratë edhe të drejtat e tyre pronësore.

Një fakt tjetër që bie në sy, në trashëgiminë ligjore është konkurrenca midis bashkëshortit dhe të afërmit të trashëgimlënësit. Ajo, në këtë mënyrë nuk hyn në rrethin e trashëgimtarëve ekskluzivë të radhës së parë, ashtu sikurse janë fëmijët. Në rast se në radhë të parë ajo është e vetmja trashëgimtare, zbret në radhën pasardhëse dhe konkurrenca me trashëgimtarët e radhës së dytë nëse ka apo të radhës tjetër pasardhëse. Privilegji i bashkëshortes pasjetuese është në faktin që ajo në cdo rast merr gjithmonë ½ e trashëgimisë.

Norma ligjore, sic shihet, ka njohur të drejtën e bashkëshortes dhe ka përcaktuar dhe pjesën e saj, por problemet hasen në praktikë. I tillë është problemi i hasur në rastin kur si trashëgimtare ligjore, gruaja nuk ka fëmijë e për pasojë konkurrenca me paraardhësit apo të afërmit e tjerë. Ndodh shpesh që në këto raste ajo rikthehet në familjen e saj dhe të drejtat e saj të trashëgimisë kontestohet nga trashëgimtarët e tjerë. Madje mungesa e ndërgjegjësimit bën shpesh që ajo as të mos i pretendojë të drejtat që i burojnë nga trashëgimia, në cilësinë e bashkëshortes. Pavarësisht se një veprim i tillë nuk ka justifikim ligjor, ai mbështetet në tradita dhe zakone kulturore.

Po ashtu problemi i hasur në praktikë është edhe kur ajo trashëgon me cilësinë e motrës së trashëgimlënësit. Në praktikë shumë rrallë ndodhë që motra të trashëgojë dhe ndodh që ajo nën presionin e traditës zakonore të heqë dorë nga pasuria që buron nga trashëgimia, në favor të trashëgimtarëve meshkuj.

Përsa i përket vajzave/bijave, ligji nuk bën ndonjë dallim midis vajzave dhe djemeve. Vajza njihen si trashëgimtare me të drejta të plota ashtu si dhe djemtë. Ligji nuk e lidh përfitimin apo humbjen e të drejtave nga trashëgimia për vajzat me ndonjë moshë të caktuar apo me ndryshimin e statusit civil të tyre nëpërmjet martesës. Por rëndom haset tradita kur vajza mund të heqë dorë nga trashëgimia në favor të fëmijëve meshkuj, apo të mos pretendojë e të heqë dorë prej saj në rastin e martesës. Kjo gjë ndodh normalisht për shkak të pozitës inferiore të gruas në shoqëri dhe për shkak të influencës së të drejtës zakonore.

Në rastin e trashëgimisë testamentare, Kodi parashikon që pasuria disponohet nga trashëgimlënësi lirisht brenda rrethit të trashëgimtarëve ligjorë. Nëse trashëgimlënësi nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në favor të çdo personi fizik apo juridik.

Kodi parashikon rezervën ligjore, të fëmijëve të mitur dhe personave të paaftë për punë, duke përcaktuar që në cdo rast trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim, në vend të prindërve të vdekur, si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar. Edhe këtu nuk bëhet dallim midis vajzave dhe djemve, por vërehet që bashkëshortja nuk gëzon të drejtën e rezervës ligjore.

Sa i përket trashëgimisë testamentare nën ndikimin e mentalitetit pasuria lihet kryesisht tek pasardhësit meshkuj, duke përjashtuar vajzat por në jo pak raste edhe bashkëshortet nga trashëgimia. Kuptohet që në rastin e testamentit testatori disponon lirisht e sipas vullnetit të tij, por është ndikimi i madh i mentalitetit patriarkal dhe normave zakonore që cënojnë në një farë mase të drejtat pronësore të grave.

Nga ana tjetër, në zonën e bregdetit të jugut vërehet se familjet e reja zakonisht i bashkohen familjes ekzistuese dhe jetojnë sëbashku me prindërit e djalit. Në këtë rast, e gjithë pasuria e vënë gjatë martesës, regjistrohet në emër të Kryefamiljarit, i cili korrespondon edhe me babain e djalit. Për këtë arsye, në rast të vdekjes së bashkëshortit, gruaja e ka të vështirë të arrijë të provojë kontributin e saj në blerjen e pasurisë, shtuar këtu edhe mentalitein mbizotësues në këtë zonë, sipas të cilit gruaja nuk mund të kërkojë ndarjen e pasurisë.

Nga sa më sipër rezulton se pengesat kryesore që ndikojnë në gëzimin e të drejtave pronësore që vijnë nga trashëgimia për gratë janë:

- Zbatimi i dobët i rregullimeve ligjore për trashëgiminë;
- Mungesa e informacionit dhe ndërgjegjësimit për rregullimet ligjore dhe të drejtat që burojnë për gratë nga trashëgimia me ligj;
- Ndikimi i traditës dhe zakonisht nën ndarjen faktike, apo në disponimin e pasurisë trashëgimore në rastin e testamentit, në kundërshtim me të drejtat që u njeh grave Kodi Civil;
- Mungesa e ndërgjegjësimit të grave mbi pasojat ekonomike dhe sociale që ka mostrashëgimi i pasurisë.

Edhe në këtë rast, roli që luan e drejta zakonore në fitimin e pasurisë me trashëgim nga gruaja është domethënëse. Kjo bën që ajo gjithmonë të jetë e varur nga burri dhe pasuria e tij, duke u nënshtruar vullnetit të tij, mbi menaxhimin ekonomik të pasurive të familjes.

#### **d. Të drejtat e pronësisë nga martesë**

Marredheniet ndërmjet dy bashkeshortëve dhe raporti mes tyre përveç natyrës personale kanë edhe natyrë pasurore. Për shkak të rëndësisë që mbartin raportet me natyrë pasurore, përveç rregullimit të përgjithshëm që gjejnë në normat e së drejtës civile, bëhet një rregullim i posaçëm edhe nga vetë kodi I familjes.<sup>32</sup> Kodi kërkon pëlqimin e të dy bashkeshortëve lidhur me banesën e tyre bashkeshortore, administrimin e pasurisë, lidhjen e kontratave martesore, zgjedhjen e regjimit pasuror dhe madje edhe për rastet e zgjidhjes së martesës me pëlqimin e palëve.

Për të kuptuar të drejtat pasurore që mund të gëzojnë gratë, gjatë martesës, apo me përfundimin e saj, duhet mbajtur në konsideratë regjimi pasurore martesor i zgjedhur. Sa i përket raporteve të natyrës pasurore që burojnë nga këto regjime martesore, Kodi trajton në mënyrë të barabartë të dy bashkeshortët pavarësisht gjinisë së tyre.

Në rastin e *zgjidhjes së martesës me pëlqim reciprok të bashkeshortëve*, në marrëveshjen e përbashkët midis tyre ata mund të rregullojnë me vullnetin e tyre pasojat e zgjidhjes së martesës, përfshirë këtu edhe rregullimin e marrëdhënieve të tyre pasurore. Kur Gjykata krijon bindjen për vullnetin e palëve, miraton dhe marrëveshjen midis tyre.

#### Regjimet pasurore martesore

Regjimet pasurore martesore sipas Kodit të ri të Familjes ndahen në:

1. Regjime martesore ligjore, ku bën pjesë regjimi i bashkësisë ligjore.
2. Regjime martesore me marrëveshje, ku bëjnë pjesë:
  - a) regjimi i bashkësisë me kontratë;
  - b) regjimi i pasurive të ndara

Regjimi pasuror i bashkësisë ligjore tashmë nuk ka më karakter detyrues, pasi Kodi u jep mundësi bashkeshortëve që me vullnet të zgjedhin një nga regjimet që u përgjigjet më mirë interesave të tyre. Nëse bashkeshortët nuk kanë lidhur kontratë, ata do të konsiderohen kundrejt të tretëve si të martuar nën regjimin pasuror martesor të bashkësisë ligjore.

Bashkeshortët mund që të lidhin një marrëveshje të veçantë, ku ata parashikojnë regjimin që dëshirojnë. Kontrata e martesës është një akt formal i cili duhet të hartohet me shkrim dhe të

---

<sup>32</sup>Pjesa I Titulli III i Kodit të Familjes

bëhet para noterit me pelqimin e njëkohshëm të dy bashkeshortëve të ardhshëm. Kontrata është e nevojshme të jetë e shkruar jo vetëm për efekte provueshmërie por edhe për vlefshmëri të marrëveshjes martesore. Kontrata e martesës nuk kufizohet vetëm në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve. Ajo rregullon edhe të drejtat pasurore të familjes që do të themelohet, pasurinë, administrimin, përcakton fatin e pjesës më të madhe të veprimeve juridike që bashkeshortët do të bëjnë me të tretët gjatë jetës së tyre të përbashkët.

Sic shihet, Kodi i Familjes, u ka ofruar bashkeshortëve mundesine qe te zgjedhin njerin nga regjimet pasurore martesore te parashikuara ne te, bazuar në lirine e vullnetit te tyre. Në këtë mënyre gratë, sipas kodit të familjes konsiderohen të lira që me vullnetin e tyre dhe me pëlqimin e bashkeshortit te zgjedhin, para martesës, rregjimin pasuror që u konvenon më tepër. Por nga praktika rezulton që për shkak të mosnjohjes së ligjit dhe kësaj të drejte të ketë pak raste ku aplikohen rregjimet martesore me marrëveshjen e të dy bashkeshortëve. Rastet kur kryesisht këto regjime aplikohen janë ato të diferencve psurore midis dy bashkeshortëve apo kur bashkeshortët gëzojnë pasuri individuale para lidhjes së martesës. Në rastin e mungesës së pasurive para martese aplikimi i këtyre regjimeve eshte shumë I pakët, ndërkohë që në zonat rurale aplikimi I tyre është thuajse inekzistent.

a. Regjimi pasuror martesor i bashkësisë ligjore

Ky regjim është ai që gjen zbatim në përqindjen më të madhe të rasteve në rregullimin e marrëdhënieve pasurore midis dy bashkeshortëve në praktikë. Bashkësia në këtë rast përbëhet nga:

- a) pasuria e fituar nga të dy bashkeshortët, së bashku ose veç e veç, gjatë martesës;
- b) të ardhurat nga veprimtaria e veçantë e çdo bashkeshorti gjatë martesës, nëse nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;
- c) frytet e pasurisë së çdo bashkeshorti, që janë marrë dhe nuk janë konsumuar deri në mbarimin e bashkëpronësisë;
- ç) veprimtaria tregtare e krijuar gjatë martesës.

Në pasurinë e përbashkët bashkeshortore nuk përfshihet pasuria vetjake<sup>33</sup> e secilit prej bashkeshortëve. Pasuria e bashkeshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkeshorti provon karakterin e saj vetjak. Gjithashtu nuk përbën pasuri të fituar nga

---

<sup>3333</sup>Pasuria vetjake përfshin:

- a) Pasuri e fituar përpara martesës në bashkëpronësi me persona të tjerë;
- b) Pasuri e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, legut apo trashëgimisë;
- c) Paritë e përdorimit ngushtësisht vetjak, si bizhuteritë apo mjete të tjera personale;
- d) Mjetet e nevojshme për ushtrimin e profesionit;
- e) Pasuria e fituar nga shpërblimi e dëmit vetjak;
- f) Pasuri e fituar nga shitja apo shkëmbimi i pasurive të parashikuara në shkronjën (b).

martesa, të ardhurat e përfituara, si pasojë e një ankandi ose forme tjetër, të një pasurie të paluajtshme, ku njëri nga bashkëshortët është bashkëpronar në pjesë të pandarë, me përjashtim të kompensimit që duhet t'i bëhet bashkësisë për shpenzimin që ajo ka bërë.

Pra ligji ka konsideruar që çdo send i fituar gjatë periudhës së martesës si pjesë të bashkësisë, por për të përcaktuar nëse është fituar ky send gjatë martesës, duhet bërë referim në dispozitat e së drejtës civile. Në lidhje me momentin e fitimit të sendeve të përbashkëta, është e qartë se ai duhet të jetë fituar në datë të mëvonshme se data e martesës. Meqenëse Kodi i Familjes nuk parashikon dispozita të posaçme datë e fitimit do të konsiderohet momenti në të cilin e drejta e pronësisë mbi sendin apo të drejta të tjera reale hyjnë në pasurinë e njërit ose të dy bashkëshortëve (duke përjashtuar sendet vetjake).

Kodi duket të garantojë të drejtën e gruas si bashkëpronare të pasurisë që buron nga martesa. Qënia bashkëshorte, është cilësi e mjaftueshme për të fituar këtë të drejtë pronësie. De juro nuk ka rëndësi nëse në aktin e fitimit të një pasurie figuron emri i të dyve apo i njërit bashkëshort, mjafton që fituesi i të drejtës të jetë i martuar dhe sendi i kalon direkt bashkësisë. Ky rregull vlen edhe për regjistrimin e sendit, ai mund të bëhet në emër të njërit apo të dyve, gjithsesi ai është pjesë e bashkësisë.

Megjithatë problem që rezulton nga praktika është që ekzistenca në aktet e fitimit të pronësisë, apo në ZRPP i emrit të bashkëshortit i vë shpesh ato në pozitë të pafavorshme. Jo të pakta janë rastet nga praktika kur ato nën efektin e padijenisë, mentalitetit patriarkal të bashkëshortit apo edhe keqbesimit nuk ushtrojnë tagrat e pronarit mbi pasurinë e përbashët bashkëshortore. Në zonat rurale ka një shkallë padijenie mbi pasurinë e përbashkët që buron nga martesa. Ato nuk interesohen të verifikojnë nëse një pronë e caktuar bën pjesë ose jo në pasurinë e përbashkët që buron nga martesa. Vërehet gjithashtu që në rastin e veprimeve juridike mbi tjetërsimin e një pasurie të paluajtshme, noterët dhe zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, kur bëjnë akte mbi disponimin po tjetërsimin e pasurisë nuk verifikojnë nëse pasuria, objekt kontrate është ose jo pronë e përbashkët.

### Mbarimi i bashkësisë

Nga dispozitat e Kodit të Familjes rezulton se bashkësia mbaron me:

- a) vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, shpalljen i zhdukur ose i vdekur të njërit prej tyre, shpalljen të pavlefshme dhe zgjidhjen e martesës;
- b) pjestimin e pasurive;
- c) ndryshimin e regjimit pasuror martesor, kur sjell mbarimin e bashkësisë.

Në parim, mbarimi i bashkësisë ka vend në datën kur shkakua për të cilin mbaron bashkësia, realizohet. Në realitet, ky parim është absolut vetëm në rastin e vdekjes së një bashkëshorti.

Vdekja e njërit bashkëshort është një shkak normal që sjell mbarimin e martesës dhe të bashkësisë njëkohësisht. Pasojat, në këtë rast janë komplekse, sepse në të njëjtën kohë çelet dhe trashëgimia e bashkëshortit të paravdekur. Në këtë rast bëhet inventari i pasurisë në mbrojtje të interesave të trashëgimtarëve, sidomos kur janë të mitur dhe njëkohësisht ndahen të ardhurat dhe pasuritë e bashkësisë të cilat i takojnë bashkëshortit që është gjallë. Në këtë rast në procesin e pjestimit të pasurisë do të marrin pjesë - në cilësinë e bashkëpronarëve - bashkëshorti pasjetues dhe trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur.

Gruaja, në cilësinë e bashkëshortit pasjetues është titullare e :

- të drejtës së pronësisë mbi sendet e përbashkëta të fituara gjatë martesës, pra i gjysmes së pasurisë në bashkësi dhe
- të drejtës së trashëgimisë mbi sendet dhe pasuritë e bashkëshortit të vdekur.

Përsa i takon së drejtës së trashëgimisë, ajo varet nga rrethi i trashëgimtarëve me të cilët konkuron. Pasuria që bashkëshorti i paravdekur lë në trashëgim të bashkëshortit tjetër dhe trashëgimtarëve të tjerë përbëhet nga gjysma e pasurisë në bashkësi dhe pasuria personale (vetjake) e tij. Në rastin e shpalljes së zhdukur ose të vdekur të njërit bashkëshort, vendimi i gjykatës prodhon të njëjtat efekte si në rastin e vdekjes, për mbarimin e bashkësisë dhe për pjestimin e pasurisë. Ndërsa në rastin e pavlefshmërisë martesë konsiderohet se nuk ka ekzistuar ndonjëherë.

#### *Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi në rastin e zgjidhjes së martesës*

Barazia e bashkëshortëve gjen zbatim edhe pas zgjidhjes së martesës, kur bëhet fjalë për pjesëtimin e pasurisë dhe zgjidhjen e çështjeve të tjera. Kodi I Familjes<sup>34</sup> parashikon se gjykata mund të urdhërojë njërin bashkëshort që t'i paguajë tjetrit një kontribut që ka për qëllim të kompensojë pabarazinë në nivelin e jetesës që mund të rrjedhë nga pjesëtimi i pasurisë. Nga ana tjetër, i jep të drejtën bashkëshortit jopronar të vazhdojë të përdorë banesën bashkëshortore edhe pas zgjidhjes së martesës kur atij/asaj i besohet përgjegjësia prindërore, ose kur bashkëshorti pronar ka braktisur familjen<sup>35</sup>.

Zgjidhja e martesës i jep fund të drejtës së bashkëpronësisë ndërmjet bashkëshortëve. Pjesëtimi i pasurisë në bashkësinë ligjore bëhet duke u nisur nga barazia e aktivitetit dhe pasivitetit të saj. Pasi të jenë zbritur nga bashkësia detyrimet që ajo ka ndaj bashkëshortëve ose të tretëve, pasuria që mbetet ndahet në pjesë të barabarta midis bashkëshortëve. Sendet e përbashkëta do të ndahen edhe në natyrë ndërmjet bashkëshortëve. Pjestimi i sendeve të përbashkëta pas zgjidhjes së martesës mund të bëhet në mënyrë vullnetare, dhe vetëm nëse bashkëshortët nuk bien dakort, pjestimi do të bëhet në rrugë gjyqësore.

<sup>34</sup>Neni 147 I Kodit të Familjes

<sup>35</sup>Neni 153 I kodit të Familjes

Në rastin e zgjidhjes së martesës, gjykata, në bazë të nevojave të fëmijëve dhe nga fakti se kujt do ti besohen ata, mund të vendosë në favor të një bashkëshorti kalimin e një pjese të pasurisë së bashkësisë që i takon bashkëshortit tjetër. Mbarimi i bashkësisë sipas Kodit nuk është lënë në vullnetin e lirë të bashkëshortëve. Sipas kodit pjestimi i pasurisë nuk mund të bëhet gjatë vazhdimit të bashkësisë, edhe në rast të një mosmarrëveshje në mes bashkëshortëve.

Pavarësisht garancive që jep Kodi i Familjes, në rastin e zgjidhjes së martesave gratë shpesh cënohen në të drejtat e tyre të pronësisë. Në jo pak raste të divorceve ndarja e pasurisë nuk respekton të drejtat e grave. Kjo për shkak të pdijenisë së tyre për të drejtat apo edhe për faktin se burrat një pjesë të pasurive të vëna gjatë martesës mund ti vendosin në emer të familjarëve të tyre. Një ndër pasuritë kryesore të një bashkësie është banesa ku çifti zhvillon jetesën e përbashket. Megjithëse sipas Kodit shtëpia i lihet prindit të cilit i lihet kujdestaria e fëmijës/ve, dhe përgjithësisht gjykatat vendosin në favor të gruas, ato ngarkohen me barrën e për ti paguar, në lekë, pjesën që i takonte bashkëshortit nga banesa. Në kushtet e pamundësisë së pagimit të kësaj vlere, shpesh zgjidhje e vetme mbetet shitja e banesës së përbashkët dhe në një farë mase kemi privim të tyre dhe nga kjo e drejtë mbi pronësinë e banesës.

Pavarësisht se gjejnë një aplikim të pakët në praktikë Kodi njih edhe rregjimin martesor me kontrtë.

#### *b. Rregjimi i bashkësisë me kontratë*

Në këto raste, bashkëshortët, në kontratën e martesës, mund të ndryshojnë bashkësinë ligjore me marrëveshje. Ata në kontratën e martesës, mund të bien dakord:

- të caktojnë pjesë jo të barabarta për pasurinë në bashkësi, ndryshe nga bashkësia ligjore
- të vendosin një bashkësi universale të pasurisë së tyre, të luajtshme dhe të paluajtshme, që ekziston dhe që do të vihet në të ardhmen, me përjashtim të pasurisë vetjake.

Në përgjithësi në Shqipëri, por edhe në zonën e bregdetit të jugut, kjo formë e rregullimit të të drejtës së pronësisë nuk aplikohet. Kjo situatë vjen për faktin e ekzistencës së mentalitetit shqiptar, por jo vetëm, se gruaja dhe burri lidhin martesën për gjithë jetën, dhe se ndarja e pasurisë me kontratë martesore është e panevojshme. Gjithashtu, mosaplikimi i këtij regjimi pasuror, vjen edhe si pasojë e mosnjohjes së ligjit. Duke qenë se kjo mundësi është përfshirë në Kodin e ri të Familjes, dhe nuk ka qenë e njohur nga e drejta zakonore, gratë pothuajse janë të painformuara mbi këtë mundësi.

#### *c. Regjimi i pasurive të ndara*

Me këtë regjim nuk krijohet një pasuri në bashkëpronësi të bashkëshortëve. Në këtë rast, pasuritë midis dy bashkëshortëve mbeten të ndara. Përsa i përket përbërjes së pasurisë në regjimin e pasurive të ndara, nuk kemi një aktiv ose pasiv të përbashkët, si në rastin e bashkësisë, por dy pasuri të pavarura, pasuri vetjake të bashkëshortëve, me përjashtim të pasurive të pandara ku të dy bashkëshortët janë bashkëpronarë.

Në rastin e zgjidhjes së martesës, nëse pasuria e njërit prej bashkëshortëve është shtuar nga lidhja e martesës, bashkëshorti tjetër, në rastin kur ai ka kontribuar në një mënyrë ose në një tjetër për këtë shtim, ka të drejtën të kërkojë kthimin e pjesës së shtuar nga kontributi i tij.

## *ii. Akte juridike të posacme mbi bazën e të cilave janë krijuar të drejta pronësie*

Pas periudhës së komunizmit, Shqipëria ka ecur me hapa domethënëse në favor të privatizimit të pronës shtetërore dhe njohjes dhe promovimit të të drejtës së pronës personave privat. Ky proces i vullshëm dhe në disa raste i ngutshëm dhe i pa studiuar mirë, ka arritur prodhimin e një numri të konsiderueshëm aktesh ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me fitimin e të drejtës së pronësisë. Në përgjithësi, qëllimi ka qenë forcimi i rolit të personave privatë në gëzimin e të drejtës së pronësisë. Mirëpo, ky proces nuk ka mbajtur në konsideratë nevojën për të siguruar një barazi reale mbi të drejtat pronësore të gruas dhe burrit.

Akte të ndryshe ligjore të miratuara pas viteve 90', duken të mos kenë patur në fokus të trajtimit të tyre pikërisht këtë çështje. Megjithatë, nga analiza e mëposhtme e tyre do të kuptohet se përmbajtja e e legjislacionit në vetvete nuk parashikon ndonjë formë të hapur diskriminimi, por përgjithësisht njeh të drejtën e gruas por të patur pronë, por nuk përcakton mekanizmat e nevojshëm për ta promovuar atë.

Të gjitha aktet e miratuara pas viteve 90', që kanë trajtuar çështjen e të drejtës së pronës, kanë qenë një mundësi e mirë për njohjen e të drejtave pronësore të grave, si dhe fuqëzimin ekonomik të tyre. Mirëpo, trashëgimi i një të kaluarë ku e drejtave e pronësisë private nuk njihej, apo rrënjësia e të drejtës zakonore që ishte në disfavor të gruas, bën që edhe pse mundësitë ligjore ekzistonin, gruaja të mos gëzonte plotësisht të drejtat e saj pronësore. Kjo mungesë padyshim sjell një pozitë sociale të dobët të gruas në shoqëri dhe ka impakt në zhvillimin ekonomik të saj.

### **a. Ligji nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për Tokën, i ndryshuar**

Me kalimin nga sistemi komunist i centralizuar në sistemin e ekonomisë së tregut, ndodhën dhe reformat e para të cilat institucionalizuan një sistem demokratik i cili bazohej në transferimin e pronës shtetërore, sidomos pasurisë së paluajtshme, në pronësisë private. Privatizimi i ish-kooperativave bujqësore u formalizua me miratimin e ligjit nr 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” .



Ky ligj rregulloi kalimin nga shteti, pa shpërblim, në pronësi a përdorim të tokës bujqësore tek personat fizikë a juridikë vendas. Toka bujqësore përfshinte toka të zëna me bimët e arave, pemishtet, vreshtat dhe ullishtet, kudo që ndodhen, në fshatra, në qytete e në qendra të tjera të banuara.

Sipas tij toka jepej në pronësi për anëtarët e familjeve anëtare të kooperativave bujqësore, ndërkohë që për familjeve me banim në fshat, që nuk ishin anëtarë të kooperativës bujqësore dhe familjeve që punonin e banonin në ndërmarrjet bujqësore, toka bujqësore jepej në përdorim. Vetëm me pas, me hyrjen në fuqi të ligjit Nr.8053, datë 21.12.1995 “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, familjet bujqësore ose individët që e kanë pasur në përdorim tokën bujqësore janë bërë pronare të saj.

Ligji, nuk parashikoi që pronat të ktheheshin në familjet e prekura nga Reforma Agrare. Në ndarjen e tokës nuk merrej në konsideratë pronësia e mëparshme, apo madhësia dhe kufijtë e saj para kolektivizimit. Në të gjitha rastet toka ndahej përpjesëtimisht për çdo familje, anëtare të kooperativës bujqësore sipas numrit të frymëve të gjendjes civile në datën 1 gusht 1991. Në numrin e frymëve të familjes anëtare të kooperativës bujqësore llogariteshin gjithë frymët e saj si, fëmijët, nxënësit, studentët, ushtarët, pensionistët, anëtarët e familjeve kooperativiste që punojnë me kontratë provizore dhe refugjatët, pavarësisht nga seksi, duke përjashtuar anëtarët e familjes që në momentin e ndarjes së tokës janë në marrëdhënie pune të përhershme me sektorin shtetëror ose privat.

Meqënëse në ndarjen e tokave nuk u mbajt parasysh pronësia e mëparshme ish-pronarët kompensoheshin sipas ligjit nr 7699, datë 21/04/1993 "Për kompensimin në vlerë të ish pronarëve të tokës bujqësore kullotave, livadheve, tokave pyjore dhe pyjeve" Ky ligj u njohu të drejtën e pronësisë për efekt kompensimi në vlerë të tokës bujqësore ish-pronarëve, personave fizikë e juridikë, që e kanë pasur atë në pronësi në kohën e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945 "Për reformën agrare, dhe me pas, në vitin 1995 kjo e drejtë iu njoh dhe trashëgimtarëve të tyre dhe ishpronarëve të shpronësuar gjatë periudhës nga 29.11.1944 deri më 29.8.1945.

Vendimet mbi shpërndarjen e tokës dhe certifikatat e pronësisë, jepeshin nga Komisionet e e ndarjes së tokave në fshat. Këto të fundit kanë ndarë tokat bujqësore të 420 ish kooperativave në rreth 383,600 familje bujqësore, duke u shpërndarë rreth 500,000 ha nga kooperativat me një mesatare prej 1.25 ha tokë bujqësore për familje<sup>36</sup>. Toka jepej nëpërmjet Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, ndërkohë që për çdo familje që merrte tokë lëshohej certifikata e pronësisë (Tapia). Tapia tregonte ndër të tjera, emrin e kryefamiljarit, një listë e parcelave të caktuara për familjen, zonën ku ndodheshin, përdorimin kryesor të tokës për çdo parcelë, dhe pronarët e parcelave kufitare.

---

<sup>36</sup>Albania country brief: property rights and land markets rache l s a b a tes-ëhe e l e r a nd myr tha ëai t e, fq 7

Tokë që kalonte në pronësi e në përdorim regjistruar në Kadastër, që ishte organi shtetëror i specializuar për evidencimin e të dhënave për tokë. Gjithashtu, në kadastrën e tokëve regjistruar çdo ndryshim i bërë në fakt pas regjistrimit fillestar.

Sa i përket administrimit të kësaj kategorie pronësie, zbatohen rregullat e përgjithshme të administrimit të pasurisë së familjes bujqësore. Anëtarët e familjes bujqësore nuk mund të bëjnë kalimin në pronësi të asnjë pjese të tokës bujqësore, pyjore, livadhe dhe kullota të familjes bujqësore, pa bërë më parë pjestimin e saj. Anëtarët e familjeve, gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqen e tokës e mund ta japin atë me sipas dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e qirasë. Sa i përket trashëgimisë për këtë pasuri zbatohen dispozitave ligjore për trashëgiminë. Si fillim shitblerja e kësaj kategorie pronësie ishte e ndaluar, por me miratimin e ligjit Nr.8337, datë 30.04.1998, kjo kategori mund të disponohet lirisht nga familjet bujqësore.

Pra sic shihet, pavarësisht se ligji nr. 7512 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, i cili bëri të mundur kalimin në një sistem ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë, një të drejtë e pronës private të individëve mbi pasuritë e paluajtshme, ligji i tokës fut konceptin e pronës familjare. Kjo më pas u njoh edhe nga Kodi Civil I 1994, si një ndër rastet e bashkëpronësisë së detyrueshme. Ligji pavarësisht se njohu të drejtën e pronësisë së familjes bujqësore si entitet, nuk përjashtoi në asnjë rast anëtarët e saj nga e drejta e pronësisë. Megjithatë nën efektin e traditës, normave zakonore apo dhe natyrës patriarkale të familjes në zonat rurale, të drejtat e pronësisë së gruas de facto kanë rezultuar jo shumë efektive.

Tapia dilte në emër të kryefamiljarit dhe kjo në vetvete nuk duhej të përbente ndonjë problem nëqoftëse do të mbahej në konsideratë konteksti i logjikës së përdorur që kryefamiljari përfaqëson familjen dhe vepron gjithmonë në interes të saj. Megjithatë kjo ka sjellë që efektivisht gëzimi i të drejtës së grave mbi pronën të varej nga vullneti i kryefamiljarit. Ekzistenca në Tapa e emrit të kryefamiljarit, jo rrallë herë në praktikë ka krijuar perceptimin e gabuar se prona i përket titullarit të tapisë ose të paktën se ai gëzon më tepër të drejta në administrimin e saj. Shpesh herë si përfaqëues i interesave të familjes vullneti i tij është dominant edhe nëse shprehej vullneti nga anëtarët e tjerë të familjes. Raste në praktike tregojnë se prona është tjetërsuar pa marrë në konsideratë vullnetin e pjesëtarëve të tjerë të familjes, e sidomos të grave apo të vajzave, ose duke marrë një vullnet fiktiv. Konkretisht, sipas të dhënave për Zonën Kadastrale Cuko/Aliko, nga 568 Akte të Marrjes së Tokës në pronësi të lëshuara në këtë zonë, vetëm rreth 40 prej tyre janë lëshuar në emër të grave.

**b. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.452, datë 17.10.1992, “Për ristrukturimin e ndermarrjeve bujqësore”**

Nëpërmjet këtij akti u shpërnda toka e ndërmarrjeve bujqësore ose njësive të tyre të cilat kanë qenë pronë e ish-kooperativave bujqësore. Ajo u jepej në pronësi familjeve të ndërmarrjeve bujqësore. Në ndarjen e tokës zbatoheshin të njëjtat kritere si për ndarjen, e tokës bujqësore. Për ndërmarrjet që kanë qenë kooperativa bujqësore të formuara nga qytetarë toka jepej në përdorim për punonjësit e këtyre ndërmarrjeve me banim në qytet dhe anëtarët themelues të kooperativës ose ndërmarrjes bujqësore që banojnë në territorin e ndërmarrjes.

Tokat e përfituara nga bonifikimi, shpyllëzimet dhe shtetëzimet, të cilat ndodheshin në territorin e atyre ndërmarrjeve bujqësore ose njësive të tyre, mbeteshin prone e shtetit dhe u jepeshin në përdorim familjeve të ndërmarrjeve bujqësore. Punonjësit e ndërmarrjeve bujqësore me banim në qytet e merrnin atë në përdorim, mbi bazën e frymëve që kishin në ngarkim për efekt të kompensimit ushqimor. Toka jepej në përdorim me qira për një kohë të përcaktuar në kontratë.

Toka, për të dy rastet, ndahej për familjet që kanë gjendje subjekti më 1 gusht 1991, duke llogaritur ndryshimet në numrin e pjesëtarëve të tyre gjer më 1 tetor 1992. Nuk përfitonin tokë familjet që ishin vendosur në territorin e ndërmarrjeve bujqësore në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Kufiri maksimal i sasisë së tokës për frymë që jepet në pronësi ose në përdorim, ishte i njëjtë me sasinë e tokës për frymë që jepej në ish-kooperativat e zonës ku ndodhej ndërmarrja. Pasuria e ndërmarrjeve ose njësive të tyre shitej me të drejtën e parablerjes nga punonjësit e ndërmarrjeve.

Edhe ky akt ndan kategorinë e tokës së ish ndërmarrjeve në pronësi të familjeve bujqësore, duke përdorur të njëjtën procedurë dhe logjikë si në ligjin nr. 7501 ndiqej edhe për ndarjen e kësaj kategorie toke. Edhe ai njeh pronësinë e familjes bujqësore dhe jo atë individuale, duke e ndarë pasurinë e ndërmarrjeve për tu gëzuar nga familjet në bashkëpronësi. Edhe në këto raste tapia apo akti I përdorimit lëshohej në emër të kryefamiljarit. Ajo që mund të shihet si problematikë e ardhur nga ky akt është se në sasinë e pasurisë që ndahej merrej si bazë gjendja e familjes nga 1 gusht 1991 deri në 1 tetor 1992, e cila të krijon perceptimin se vetëm ata anëtarë kanë të drejta pronësie mbi pasurinë e këtyre familjeve, pavarësisht se cdo pjestar tjetër I kësaj familjeje mund të gëzonte të drejtë pronësie mbi këto pasuri për shkak të lidhjeve të gjakut (fëmijët e lindur pas kësaj date), apo atyre martesore (gratë të cilat kanë hyrë në këto familje nëpërmjet martesave pas kësaj daten) .

### **c. Ligji nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”**

Pavarësisht procesit të ndarjes së tokës nëpërmjet ligjit nr. 7501 “Për Tokën” një numër tokash mbetën të pandara në pronësi dhe administrim të shtetit. Për këtë arsye ligji nr. 8312 bëri rregullimin juridik të kësaj kategorie toke<sup>37</sup>.

Këto toka u ndanë për t’u marrë në pronësi:

- familjeve bujqësore ose individëve, të cilëve u janë dhënë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7. 1991 “Për tokën”, por që i kanë refuzuar.
- për t’u plotësuar me normë të plotë për frymë, familjeve fshatare, që me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” kanë marrë tokë bujqësore ½ e normës për frymë.
- u jepet në pronësi familjeve që përfitojnë të drejta ligjit nr. 7514, date 30.9.1991 “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” dhe që janë subjekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”.

Familjet fshatare apo individët që u trajtuan me këtë ligj detyroheshin ta përdorin atë sipas dispozitave të ligjit nr. 7501, date 19.7.1991 “Për tokën”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Sic shihet edhe ky ligj ruajti të njëjtën logjikë si ligji nr. 7501, datë 19.7. 1991 “Për tokën”, duke vazhduar me konceptin e pronësisë së familjes dhe jo konceptin e pronësisë së individit mbi tokën.

### **d. Ligji nr. 8337, datë 30.04.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave”**

Ky ligj bëri të mundur kalimin e pronësisë mbi tokën bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave për personat fizikë dhe juridikë vendas. Veprimi juridik i kalimit të pronësisë së tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave bëhet me akt noterial, sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ligji njohu të drejtën e familjes bujqësore për të tjetërsuar tokën bujqësore, pyjore, livadhet, kullotat tek çdo shtetas, person fizik dhe juridik vendas sipas kërkesave ligjore për kalimin e pasurisë së paluajtshme. Veprimet për kalimin e pronësisë mund të bëheshin vetëm pas regjistrimit fillestar të pasurisë së paluajtshme.

Pavarësisht rregullave të përgjithshme për administrimin e pasurisë së familjes bujqësore ky ligj parashikon shprehimisht rregulla specifike për administrimin e saj. Kështu, parashikohet që anëtarët e familjes bujqësore nuk mund të bëjnë kalimin në pronësi të asnjë pjese të tokës

---

<sup>37</sup>Toka bujqësore të pandara konsideroheshin sipërfaqet e kadastruara në zërin tokë bujqësore më 1.8.1991, brenda kufijve të një njësie të caktuar administrative (fshat, komunë ose bashki që ka toka bujqësore jashtë vijave kufizuese), të cilat nuk ishin ndarë nga komisionet e tokave ose që ishin refuzuar të merreshin nga familjet apo individë të ndryshëm dhe që nuk kanë ndryshuar zërin kadastral deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji

bujqësore, pyjore, livadhe dhe kullota të familjes bujqësore, pa bërë më parë pjestimin e saj sipas dispozitave të Kodit Civil.

Vërehet se pronësia e familjes bujqësore vazhdon të ruhet edhe me këtë ligj, por në ndryshim nga ligjet e mëparshme ofrohen disa garanci për gartë në kuadër të marrjes së pëlqimit të tyre në në rastin e tjetërsimit të tokës bujqësore, pyjore, livadheve, kullotave.

Ligji parashikon që gjatë kalimit të pronësisë së këtyre sipërfaqeve, në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme përveç dokumentave të tjerë paraqiten edhe:

- aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes, si dhe
- prokurë noteriale e përfaqësimit , për rastet kur kalimi i pronësisë nuk kryhet nga gjithë anëtarët e familjes bashkëpronarë të pasurisë së paluajtshme.

Këto garanci, kanë pasur si qëllim marrjen e vullnetit të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes, dhe kryesisht grave, të cilat nuk kanë qenë të ndërgjegjësuar për të drejtën e pronësisë që u buron si anëtare e familjes bujqësore. Por, praktika tregon se edhe në rastin kur gratë nënshkruajnë prokura noteriale, shpesh nuk janë të ndërgjegjshme për rëndësinë dhe vlerën e tyre, duke e lënë që vullneti i shprehur të jetë fiktiv.

Megjithatë, pavarësisht kësaj ligji detyron ZRPP-në që të mbajë në konsideratë pjesën e tyre në pronësisë në regjistrimin e pronës, bazuar në aktet që vërtetojnë përbërjen e familjes bujqësore në çastin e kalimit të pronësisë, të vërtetuar nga certifikata e gjendjes civile, vërtetimi i pushtetit lokal dhe deklarata e përbashkët e anëtarëve të familjes.

Përgjatë reformave të bëra në këto vite në lidhje me ndarjen e kategorive të ndryshme të tokës, u evidentuan edhe veprimeve të kundërligjshme në dhënien e titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, si në sipërfaqet e dhëna në pronësi, të cilat jo kurdoherë kanë figuruar në zërin kadastral si "tokë bujqësore", ashtu edhe në subjektet e trajtuara me tokë, të cilat mund të mos ishin subjekte të njohura nga ligji. Për këtë arsye, në vitin 2008, me ligjin Ligji nr. 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", u krijua një mekanizëm për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore, i cili synon konsolidimin e tregut të tokës bujqësore dhe zhvillimin e një ambienti të përshtatshëm për investime në fushën e bujqësisë.

#### **e. Ligji Nr.7652, datë 23.12.1992 “ Për privatizimin e banesave shtetërore”**

Procesi i privatizimit të banesave shtetërore filloi në vitin 1992 me miratimin e ligjit nr. 7652, “Per privatizimin e banesave shtetërore”, i cili u dha të drejtën qiramarrësve të këtyre banesave

për t'u bërë pronarë me të drejta të plota mbi to. Ligji parashikonte kushtet dhe menyrat e privatizimit të banesave shtetërore. Pronësia mbi banesën fitohej me kryerjen e veprimeve përkatëse, sipas ligjit dhe regjistrimin e aktit të pronësisë në zyrat e hipotekës.

Banesat që u privatizuan regjistroheshin në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij, duke bërë në këtë mënyrë bashkëpronare edhe bashkëshortete apo vajzat mbi 18 vjec. Nëse banesa përdorej nga disa qiramarrës, ajo kalonte në pronësi të çdo qiramarrësi, në bazë të pagesës që ka në kontratën e qirasë. Kur qiramarrësit binin dakort midis tyre, banesa mund të kalonte tërësisht në pronësi të njërit qiramarrës.

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, merrej për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezultonte në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1 dhjetor 1992. Trualli që zinte ndërtesa e banimit vlerësohej si zë i veçantë dhe kalonte në bashkëpronësi të pronarëve të banesës. Kur privatizohej një banesë e veçantë e rrethuar me oborr, i cili është përdorur e mirëmbajtur në mënyrë të përhershme nga qiramarrësit, oborri kalonte në bashkëpronësi të tyre. Sa i përket administrimit pronarëve u njihej e drejta për të tjetërsuar, lëshuar me qira apo për ta hipotekuar banesën e tyre.

Megjithatë referuar realitetit, në zbatimin e këtij ligji problemet kanë ekzistuar për të drejtat pronësore të personave të cilat nuk ishin në certifikatat e përbërjes familjare në datën 1 dhjetor 1992. Nëse martesë para kësaj date i bënte ato bashkëpronare, martesat e mëvonshme i konsideronin keto banesa pasuri të vëna para martesës e për pasojë gratë nuk kishin të drejta pronësie mbi to. Në kushtet kur në qytete pasuria e paluajtëshme përbëhet kryesisht nga banesa ku bashkëshortët jetojnë, kuptohet mungesa e aksesit që mund të kenë gratë mbi këtë kategori banesash.

Po kështu edhe në shitblerjen e tyre rezulton që pavarësisht shprehjes së vullnetit të grave në momentin e tjetërsimit të pronës, edhe kur ato janë bashkëpronare, shpeshherë është vullneti i burrit ai që dominon në vendimet e tjetërsimit të banesave. Po kështu, hipotekimi për efekte marrje kredie me titullare gratë, rezulton të mos jetë i praktikuar. Në shumicën e rasteve janë burrat ata që janë titullarë në kontratat e kredisë dhe në hipotekimin e banesve.

#### **f. Ligji nr. 9235, datë 29.07.2004 “ Për kthimin dhe kompensimin e pronës”**

Me zbatimin e reformës agrare 1945 -1946, ish-pronarët u shpronësuan dhe toka u bë pronë kolektive. Në kuadër të proceseve të privatizimit të pronës shtetërore u miratuan edhe një sërë aktesh të cilat garantonin të drejtat e subjekteve të shpronësuara nga reformat e ndërmarra në vitet e kolektivizimit të pronës. Kështu u miratua ligji nr. 7698, datë 15.04.1993 mbi "Kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve " dhe një sërë aktesh në zbatim të tij, të cilat njohën të drejtën e pronësisë së pronarëve ose trashëgimtarëve në pronat e shtetëzuara apo shpronësuara.

Po kështu u miratua Ligji nr.7699, datë 21.04.1993 "Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve e tokës bujqësore" dhe dekreti nr. 1254, datë 19.10.1995, "Për kompensimin e ish-pronarëve të bujqësisë , toka jobujqësore dhe të trojeve të zëna me troje në zonat turistike dhe qendrat e banuara", të cilët kompensojnë në vlerë ish pronarët.

Pas ratifikimit të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 1996 dhe pas miratimit të Kushtetutës në vitin 1998, me qëllim adoptimin e standardeve të reja për garantimin e të drejtës së pronës, të orientuara drejt parimeve të interesit publik, shpërblimit të drejtë, të paanshmërisë e të proporcionalitetit, u miratua ligji 9235, datë 29.7.2004. Ky akt shfuqizoi aktet e mëparshme duke bërë një rregullim të ri të procesit të kompensimit duke rritur kufirin maksimal të sipërfaqes së tokës bujqësore për njohje, kthim apo kompensim; u zgjeruan mënyrat e kompensimit; u vendos detyrimi për krijimin e fondit të pronave të paluajtshme për kompensim fizik, si dhe detyrimi për krijimin e fondit për kompensimin financiar.

Ligji i njeh çdo subjekti të shpronësuar të drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944<sup>38</sup>. Në bazë të njohjes së pronësisë, prona mund të kthehet apo të kompensohet fizikisht apo financiarisht.

Subjekteve të shpronësuara u njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen pa kufizim pronat e paluajtshme, tokë pyjore, pyje, livadhe, kullota, troje dhe ndërtesa, sipas kushteve të përcaktuara nga ligji. Për pronat për të cilat është i pamundur kthimi fizik, shteti kompensojnë subjektet e shpronësuara me një ose më shumë nga format e mëposhtme:

- a) me pronë tjetër të paluajtshme të të njëjtit lloj, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit;
- b) me pasuri të paluajtshme publike në zonat, që kanë përparësi zhvillimin e turizmit;
- c) me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit.

Në këto raste akti i njohjes së të drejtës së pronësisë është vendimi i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronës "Për njohjen e së drejtës së pronësisë, kthimin dhe kompensimin". Sipas vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë ky ligj nuk krijon një situatë të re, por ristabilizon ligjshmërinë dhe drejtësinë<sup>39</sup>. Vendimi jepet në emër të subjektit të shpronësuar dhe kur ai nuk është gjallë në emër të trashëgimtarit/ëve ligjorë të tij, ku pjesët takuese të gjithsecilit renditen sipas dëshmisë së trashëgimisë, pa bërë dallim ndërmjet dy gjinive. Të drejtat e pronësisë sipas këtyre vendimeve rregjistrohen pranë zyrave të ZRPP në territorin e të cilave ndodhet prona.

Nëse do të analizonim të drejtat e pronësisë që mund të gëzojnë gratë në kuadër të këtij ligji na rezulton, që ai rikonfirmon apo njeh tituj pronësie të subjekteve të shpronësuara. Ligji dhe aktet

<sup>38</sup>Fusha e veprimit të këtij ligji shtrihet edhe për pasuritë e paluajtshme të shtetasve shqiptarë, të krijuara përpara datës 7 prill 1939 dhe që janë sekuestruar sipas nenit 14 të ligjit nr.37, date 13.1.1945 "Ligji i tatimit të jashtëzakonshëm për fitimet e luftës".

<sup>39</sup>Vendimit Unifikues I Gjykatës së Lartë nr.24/13.3.2002

nënligjore në zbatim të tij nuk bëjnë dallimin midis gjinisë së subjekteve, por nëse i referohemi akteve të kohës kur ka ndodhur shpronësimi, del që subjekte të të drejtave pronësore mbi pasuritë e paluajtshme kanë qenë burrat si kryefamiljarë, e për pasojë janë ata që përfitojnë.

Gratë në këto raste mund të përfitojnë të drejta pronësie, sipas rregullave të trashëgimisë ligjore e cila sipas Kodit Civil, në cilësinë e bashkeshorteve, vajzave, motrave apo nënave të trashëgimlënësit. Vendimi i Kthimit apo Kompensimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përcakton sipas dëshmisë së trashëgimisë subjektet që kanë të drejtë pronësie mbi pasuritë që kthehen apo kompensohen fizikisht. Megjithatë praktika, sidomos ajo gjyqësore ka treguar që ka pasur një tendencë në përjashtimin nga trashëgimia të grave, sidomos në cilësinë e vajzave për prona të paraardhësve të tyre.

#### **g. Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar**

Vitet e para të periudhës së tranzicionit u shoqëruan me një lëvizje migratore të popullsisë të zonave rurale drejt atyre urbane, dhe kryesisht atyre më të populluara. Këto lëvizje u shoqëruan me një kërkesë të madhe të blerjes së trojeve apo tokave dhe përdormit të tyre për ndërtim banesash apo objekteve të natyrave të tjera. Shpeshherë këto transaksione rezultojnë të rregullta, por në jo pak raste tregu karakterizohet nga informaliteti. Kryesisht toka apo trualli blihet nga pronarët, por ndodhte që tokat private apo shtetërore të ziheshin dhe mbi to të bëheshin ndërtime pa respektuar rregullat e legjislacionit përkatës mbi urbanistikën.

Me qëllim shmangien e informalitetit u miratuan ligje<sup>40</sup> të cilat do të legalizonin ndërtimet apo shtesat pa leje. Aktualisht ky proces rregullohet nga ligji nr. 9482 I cili shfuqizoi aktet e mëparshme dhe bëri të mundur legalizimin e ndërtimeve informale dhe mundësoi kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje. Ligji zbatohet për të gjitha objektet e ndërtuara pa leje, të ngritura para datës së hyrjes në fuqi të tij, pavarësisht nëse ato kanë funksion strehimi, veprimtarie ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, të ngritura dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar e që veprojnë sipas të drejtës tregtare shqiptare.

Akti që legalizon poseduesit mbi ndërtimin, shtesën apo parcelën ndërtimore është Leja e legalizimit, e cila jepet nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI). Për gëzimin nga gratë banuese në to, të së drejtës së pronësisë mbi objektet që legalizohen ligji parashikon si dokumentacion të nevojshëm për nxjerrjen e lejës së legalizimit, edhe certifikatën e përbërjes familjare.

---

<sup>40</sup>Ligjet nr.9304, datë 28.10.2004 "Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale" dhe nr.9209, datë 23.3.2004 "Për legalizimin e shtesave në ndërtime",



Kur ndërtimi pa leje disponohet nga një subjekt, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore dhe objektit që legalizohet regjistrohen në emër të subjektit që disponon objektin.

Kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet:

- në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve;
- në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit, pranë njësisë së urbanistikës. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

Të njëjtat rregulla ndiqen edhe për shtesat në ndërtime.

Procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të legalizuara, kryhen nga ALUIZNI.<sup>41</sup> Me qellim garantimin efektiv të të drejtave pronësore të grave, në cilësinë e bashkëshorteve, mbi objektet e legalizuara, ligji ka vendosur që e drejta e pronësisë që rezulton nga martesat të evidentohet në certifikatat e pronësisë. Në këtë rast ligji i referohet bashkëpronësisë sipas rregjimit pasuror martesor në bashkësi, duke vendosur detyrimin për ZRPP-në për të dispozitat e ligjit nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i familjes”, kreu II “Regjimi pasuror martesor në bashkësi” për regjistrimin e pronës së legalizuar. Megjithatë, nga praktika vërehet se Këshilli i Ministrave në miratimin e listës së pasurive të paluajtshme që tjetërsohen në favor të poseduesve informal, shënon si pronarë kërkuesin, i cili në shumicën dërrmuese të rasteve është Kryefamiljari.

#### **h. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 29.8.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”**

Edhe ky akt përbën mënyrë për fitimin e pronësisë për ato sipërfaqe që kanë të shënuar “oborre në përdorim”. Kalimi i kësaj sipërfaqe toke në pronësi bëhet pas një procesi administrativ të kryer nga AKKP-ja. Sipërfaqja duhet të jetë e lirë nga ndërtimet informale, si dhe nuk duhet të jetë trajtuar me njohje dhe kthim të pronës ish-pronarit.

Në këtë rast, vendimi i Këshillit të Ministrave nuk bën ndonjë dallim midis burrit dhe gruas në kalimin e të drejtës së pronësisë sipas këtij vendimi. Megjithatë, nga praktika rezulton se në pjesën dërrmuese të rasteve aplikues për të përfituar të drejtën e pronësisë sipas këtij vendimi janë burrat. Kjo bën që vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi oborrin në përdorim të jepet në favor të kërkuesit (që është burri). Një përcaktim i tillë bën që edhe regjistrimi i vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së në

---

<sup>41</sup>Leja e legalizimit, e shoqëruar nga dokumentacioni teknik dhe kartela e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme të legalizuar paraqiten nga ALUIZNI në ZRPP për regjistrimin fillestar të objektit në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të bëhet në favor të subjektit që përmendet në vendimin e AKKP-së, pra në favor të burrit.

**i. Vendimi nr. 608, datë 05.09.2012 “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre.**

Ky vendim ka si objekt përcaktimin e institucionit të autorizuar dhe procedurave të kalimit në pronësi të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, në rastet kur nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë. Vendimi pasi përcakton procedurat që kryejnë organet e qeverisjes vendore, që janë institucione të autorizuar për kalimin e pronësisë, specifikon se organi bën kalimin e pronësisë së pasurisë së paluajtshme e të truallit funksional të tyre në emër të personave, sipas përbërjes familjare që figuron në certifikatën familjare deri më 10.08.1991. Nga kjo praktikë, duket se është mbajtur në konsideratë nga Këshilli i Ministrave, e drejta pronësore e gruas, duke e bërë atë bashkëpronare, së bashku me të gjithë personat e tjerë në përbërje të trungut familjarë në vitin 1991. Sfidë në këtë rast mbetet zbatimi praktik dhe ushtrimi efektiv i të drejtave pronësore nga ana e gruas.

**iii. Regjistrimi i pasurive të paluajtshme: Mënyrë fitimi pronësie apo publicitet**

Deri në vitin 1991 Shqipëria nuk ka patur pronësi private mbi tokën dhe ndërtesat dhe si pasojë nuk kishte institucion që kryente regjistrimin e të drejtave të këtyre pronarëve. Në atë kohë ekzistonte vetëm institucioni i kadastrës së tokave që merrej me evidentimin e hartezimit e tokave dhe një kadastrë pyjesh e kullotash dhe të ujrave.

Nevoja për regjistrimin e pronës private dhe për krijimin e një institucioni të posaçëm lindi pas vitit 1991, kur filloi dhe ndarja e parë e pronave shtetërore. Për këtë arsye u ndërmorrën hapa ligjore dhe institucionale që mundësuan ngritjen e një institucioni sic është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si dhe për regjistrimin nga e para të pasurive të paluajtshme nëpërmjet sistemit të ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

Detyrimi për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, si dhe fakteve që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre buron nga Kodi Civil.<sup>42</sup> Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, nuk

<sup>42</sup>Sipas nenit 144 të Kodit Civil: Sendet e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Regjistrohen dhe ato sende të luajtshme për të cilat kërkohet shprehimisht në ligj. Po kështu në nenin 192 të tij është parashikuar se “Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykates apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji”.

mund të tjetërsohen apo të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme<sup>43</sup>.

Në doktrinën juridike, ka ekzistuar debati nëse rregjistrimi i pasurive në regjistrin publik, sipas legjislacionit shqiptar, ka karakter krijues apo thjesht publikues. Këtij debati i ka dhënë zgjidhje Vendimin nr 1, datë 06.01.2009, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas interpretimit në këtë vendim regjistrimi realizohet nepermjet mbajtjes së regjistrit publik dhe ka si objekt regjistrimin e akteve që krijojnë, ndryshojnë ose perfundojnë të drejta reale mbi pasuritë e paluajtshme dhe pasuritë e luajtshme të regjistruara. Sipas legjislacionit shqiptar sistemi i regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk ka efekt krijues, por thjesht publikues, njohës, pasi janë aktet baze mbi të drejtat reale të pronësive që krijojnë, ndryshojnë apo mbarojnë të drejtat perkatese dhe jo regjistrimi i akteve. Sistemi i transkriptimit të pasurive të paluajtshme bazohet në parimin e vazhdimësisë së transkriptimeve.

Nga interpretimi i dispozitave ligjore të Kodit Civil, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se:

- Rregjistrimi i veprimit juridik (kontrates) në regjistrat e pasurive të paluajtshme është shumë i rëndësishëm për të tretet pasi vetëm pas regjistrimit, kontrata bëhet e njohur prej tyre dhe mund të kundërshtohet.
- Mosrregjistrimi i veprimit juridik (kontrates) për një pasuri të paluajtshme në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk cenon vlefshmërinë e kontrates, por nuk i jep mundësinë bleresit që ta tjetërsojë atë tek të tretet dhe nderkohe mund të sjellë pasoja dhe rrezik për bleresin për faktin se shitësi në keqbesim mund të tjetërsojë perseri sendin.

Nga sa më sipër rezulton e qartë rëndësia që ka për qarkullimin civil të sendeve, rregjistrimi i titujve të pronësisë në Zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, dhe sigurisht personi në emër të të cilit janë të regjistruar këto tituj.

Deri në mars të vitit 2012 rregullimi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme bëhej bazuar në ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 “Per regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar. Regjistrimi i titujve të pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale për pasuritë e paluajtshme bëhej duke mbajtur në konsideratë rregjimin juridik të pronësisë që ka ekzistuar pas vitit 1991. Për këtë arsye si subjekte në emër të të cilëve rregjistrohen pasuritë njiheshin individët, familjet dhe personat juridikë, privatë apo shtetërorë. Ai i njëjtë, në kuadër të efektit të regjistrimit, çdo personi si individ, si bashkëpronar apo si përfaqësues i familjes, të drejtën për të disponuar pasurinë e paluajtshme.

---

<sup>43</sup>Neni 195 i Kodit Civil

Rregjistrimi i pasurive në ZRPP bëhet mbi aktet e paraqitur nga personi i interesuar që kishte fituar të drejtën e pronësisë mbi bazën e:

- ligjit,
- vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin ose kalimin e së drejtës së pronësisë, apo
- të aktit të një organi administrativ.

Në këto raste bëhet rregjistrimi duke shënuar pronar shtetin, personin, fizik ose juridik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë. Ligji njihet të drejtën e regjistrimit si individë apo në bashkëpronësi dhe nuk shihet ndonjë pengesë që pronat në rastin e një regjimi martesor të caktuar të regjistrohen në emër të të dy bashkëshortëve. Nga praktika rezulton që kërkesat për regjistrim të bëhen nga bashkëshortët apo kryetarët e familjeve si dhe në të shumtën e rasteve pronat të regjistrohen në emër të tyre. Nuk ka ekzistuar ndonjë praktikë e konsoliduar që gjatë dorëzimit të dokumentacioneve në rastin e regjistrimit të një pasurie të kërkohet ndonjë dokument provues, si psh çertifikata familjare, që të mund të provojë ekzistencën e një martese apo regjimi martesor të caktuar që do të mundësonin shënimin si bashkëpronare në kartela edhe të bashkëshortëve. Këto raste i janë lënë në dorë aplikuesve.

Është pikërisht mosnjohja e ligjit dhe e të drejtave që burojnë prej tij si edhe mungesa e këtyre instrumentave të cilat kanë bërë që në raste të rralla gratë të figurojnë si bashkëpronare në rregjistrat e pronësisë. Kuptohet që kjo ka pasojat e veta sociale qoftë në vështirësinë e pjesëmarrjes së grave në qarkullimin civil të pasurive të paluajtshme, ashtu edhe në të drejtën e tyre për të vendosur barrë mbi këto prona.

Ndërkohë rregjistrimi i pasurive të paluajtshme aktualisht bëhet nëpërmjet ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i cili ka vetëm pak muaj që është miratuar dhe është ende në fazën e plotësimit me akte nënligjore. Edhe ky ligj ashtu si ligji I mëparshëm njihet e pasurive të paluajtshme në favor të tre kategorive të subjekteve: Individë; Familje Bujqësore; Bashkëpronësi. Në varësi të llojit të titujve të pronësisë apo të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme të cilat regjistrohen pranë Zyra të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, vlerësohet se ky dokumentacion mund të jetë: vendim gjyqësor; akt noterial; akt administrative.

Ligji i ri sjell një risi sa i përket regjistrimit të pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi duke vendosur një dispozitë garantuese për regjistrimin e pasurisë së përbashkët bashkëshortore.<sup>44</sup>Në

---

<sup>44</sup>Neni 41 i ligjit nr 33/2012 parashikon se “Aktet, që përmbajnë fitimin e pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale mbi pasurinë e paluajtshme, të cilat u përkasin bashkërisht dy apo më shumë personave, regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme, duke treguar identitetin dhe pjesët e secilit bashkëpronar, kur kjo është e mundshme. Nëse pasuria, objekt i kontratës së kalimit të pronësisë, realizuar në favor të personave fizikë, të cilët në regjistrin e gjendjes civile kanë statusin e të martuarit, është pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76 të Kodit të Familjes, regjistrimi në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.

45 Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak.

rastin e regjistrimit të një kontrate të kalimit të pronësisë, nëse pasuria, objekt i saj është, realizuar në favor të personave fizikë, të cilët në regjistrin e gjendjes civile kanë statusin e të martuarit, kjo pasuri merr statusin e pasurisë së fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76 të Kodit të Familjes<sup>45</sup>, dhe regjistrimi në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve.

Në këtë kuadër, ky parashikim i ri ligjor është e vetmja mënyrë për të siguruar efektivisht të drejtën pronësore të gruas. Regjistrimi i pasurisë në emër të të dy bashkëshortëve do të shmangte rastet e evidentuara në praktikë, ku për shkak se prasuret e vëna gjatë martesës ishin të regjistruara në emër të bashkëshortit, gratë shpesh nga padituria, dhe në disa raste për mungesë besimi ndaj sistemit gjyqësor, hiqnin dorë në mënyrë të pavullnetshme, nga kërkimi i pjesës që i takonte nga pasuria e përbashkët martesore. Në këtë kuptim, parashikimit e ligjit të ri nr. 33/2012 të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, duhet të zbatohet në mënyrë korrekte nga nëpunësit e ZRPP-së dhe për këtë qëllim do të ishte e nevojshme që të kryeheshin edhe trajnime të vazhdueshme të tyre. Për këtë arsye, sfida kryesore në këtë drejtim është njohja e të drejtës së pronës për gruan dhe aplikimi me përpikmëri i dispozitave ligjore nga nëpunësit e ZRPP.

#### **iv. Administrimi dhe tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme**

E drejta e pronësisë nuk mund të kuptohet pa të drejtën e administrimit dhe tjetërsimit të saj. Pasja vetëm e emrit në regjistrat publik të pasurive të paluajtshme, si pronare e pronës, e pa shoqëruar me një mekanizëm konkret që garanton rolin e gruas në vendimmarrje për çështjet që lidhen me administrimin dhe tjetërsimin e pronës. Pavarësisht se kjo është një çështje që lidhet me shume me mentalitetin, sesa me përmbajtjen e kuadrit ligjor, vlerësohet e domosdoshme që të krijohen mekanizmat e nevojshëm për ndrgjegjësimin e publik mbi këtë fenomen, vecanërisht mbi domosdoshmërinë për ushtrimin efektiv të të drejtës së pronës nga gratë dhe forcimin e rolit të tyre në jetën ekonomike dhe sociale të vendit.

##### **a. Administrimi dhe tjetërsimi i pronës së familjes bujqësore**

Rregullat mbi administrimin e pasurisë në familjen bujqësore gjejnë pasqyrim në Kodin Civil, por edhe në ligjet specifike të miratuara pas vitit 91 të cilat bënë ndarjen e pasurisë shtetërore, kryesisht kategorive të ndryshme të tokave që u përkisnin kooperativave apo ndërmarrjeve bujqësore. Megjithatë ligji nuk përbën ndonjë pengesë, gratë duket të kenë pak rol në administrimin e pasurisë së familjes bujqësore. Në marrëdhëniet pasurore me të tretët familja bujqësore përfaqësohet nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj<sup>46</sup>. Nuk ka kushte mbi gjininë

---

<sup>46</sup>Neni 224 I Kodit Civil

e kryetarit, megjithatë si kryetar i saj zgjedhet kryefamiljari i kësaj familjeje. Megjithëse ligji e përcakton atë si përfaqësues të familjes në marrëdhëniet pasurore me të tretët, në të vërtetë ai kryen veprimet juridike apo tjetërsimin shpeshherë në bazë të vullnetit të tij. Kjo edhe për faktin se pasuritë e kësaj familjeje, sidomos ato mbi kategoritë e ndryshme të tokave që u ndanë pas vitit 91, përcakton si titullar të saj në Tapi, kryefamiljarin. Pavarësisht për tjetërsimin e pasurive të tilla të përbashkëta kërkohet vullneti i gjithë bashkëpronarëve, vullneti i grave, bashkëshorte apo vajza, në këto raste shpesh herë mbetet formal, për shkak të mentalitetit patriarkal mbizotërues.

Sa i përket tjetërsimit të pasurisë së familjes bujqësore, nga gratë vetë, me cilësinë e një anëtri të familjes bujqësore, kodi përmban kufizimin që asnjë pjesë e pasurisë së familjes bujqësore, nuk mund të tjetërsohet pa u bërë më parë pjesëtimi i saj. Në rastin e pjesëtimin të kësaj pasurie, pjesa e antarit jepet në të holla dhe vetëm kur pjesëtimi kërkohet nga disa pjesëtarë të familjes bujqësore, me qëllim që të krijohet një familje tjetër bujqësore, pjesa mund të jepet në natyrë. Pjesa përcaktohet duke marrë parasysh sidomos:

- a) pasurinë që i përket tërë familjes;
- b) numrin e anëtarëve të familjes;
- c) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.<sup>47</sup>

Megjithatë kjo e drejtë nga femrat e familjes thuhet mbetet e paaplikueshme, për faktin se edhe nëse martohen vajzat nuk e kërkojnë pjesën e tyre nga pasuria e familjes bujqësore.

## **b. Administrimi dhe tjetërsimi i pasurisë gjatë martesës**

Rregullat e administrimit të kësaj pasurie janë të parshikuara, për secilin nga rregjimet martesore në Kodin e Familjes. Ligji u njuh në mënyrë të njëjtë si grave dhe burrave të drejtën për të kryer veprimet e administrimit lidhur me pasurinë gjatë ekzistencës së martesës, në varësi të regjimit martesor të zgjedhur.

Në **rregjimin e bashkësisë ligjore**, secili prej bashkëshortëve ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të pasurisë në bashkësi dhe është përfaqësues ligjor edhe i bashkëshortit tjetër përpara organeve administrative dhe gjyqësore për çështje që kanë të bëjnë me administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi.

Kryerja e veprimeve që kapërcejnë administrimin e zakonshëm u takon bashkërisht të dy bashkëshortëve. Në rast largësie ose pengese tjetër të njërit bashkëshort dhe në mungesë të prokurës ose autorizimit të gjykatës, bashkëshorti tjetër mund të kryejë veprimet që janë të

---

<sup>47</sup>Neni 227 I Kodit Civil

nevojshme edhe në rastin kur kërkohet pëlqimi i të dy bashkëshortëve<sup>48</sup>. Aktet e kryera nga njeri bashkeshort pa marre pelqimin e nevojshem te bashkeshortit tjetër në lidhje me sendet e paluajteshme, janë të anulueshme me kerkesen e bashkeshortit tjetër<sup>49</sup>.

Gjykata mund te vendose perjashtimin nga administrimi i njerit bashkeshort ne rast se ai per nje kohe te vazhdueshme ndodhet jashte gjendjes per te shprehur vullnetin e tij, si dhe kur eshte ne keqbesim dhe i paafte te administroje pasurine ne bashkesi. Ne rast te tejkalimit te drejtave ne administrim te bashkesise nga njeri bashkeshort, bashkeshortit tjetër mund te kerkoje anulimin e veprimit ose te jape pelqimin per veprimin e kryer. Per te realizuar kete te drejte Kodi i Familjes parashikon edhe mundesine per t'iu drejtuar gjykates<sup>50</sup>.

Secili bashkëshort ka të drejtë të administrojë dhe të disponojë lirisht pasuritë vetjake. Nëse gjatë martesës njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij vetjake, zbatohen rregullat e përfaqësimit. Nëse njëri nga bashkëshortët administron pasurinë vetjake të tjetrit, me dijeninë e këtij të fundit dhe pa pasur kundërshtim nga ana e tij, konsiderohet se ka marrë një akt përfaqësimi në heshtje, që mbulon veprimet e administrimit dhe të përdorimit, me përjashtim të tagrit të disponimit. Në këtë rast, ai përgjigjet kundrejt bashkëshortit tjetër me cilësinë e përfaqësuesit. Në këtë rast, bashkëshorti i dëmtuar ka të drejtën të drejtohet gjykatës për anulimin e veprimit të kryer.<sup>51</sup>

Gjatë vazhdimit të bashkësisë nuk mund të bëhet pjesëtimi i pasurisë, edhe në rast të një marrëveshjeje të bashkëshortëve. Pjesëtimi i pasurisë në bashkësi mund të kërkohet në gjykatë në rast paaftësie dhe administrimit të keq të njërit prej bashkëshortëve, kur mënyra e administrimit të pasurisë prej tij vë në rrezik interesat e bashkëshortit tjetër ose të familjes, ose kur njëri nga bashkëshortët nuk kontribuon për nevojat e familjes, në proporcion me gjendjen e tij dhe me aftësinë për punë dhe kur ka ndodhur një pjesëtim faktik i pasurisë në bashkësi.<sup>52</sup>

Gjatë **bashkësisë me kontratë** administrimi i pasurisë i nënshtrohet marrëveshjes së palëve. Bashkëshortët mund të bien dakord që ta administrojnë së bashku bashkësinë. Në këtë rast, aktet e administrimit dhe të disponimit të pasurisë së bashkësisë bëhen me nënshkrimin e përbashkët të dy bashkëshortëve dhe përmbajnë detyrimin solidar të tyre.<sup>53</sup>

Në **regjimin e pasurive të ndara**, secili prej bashkëshortëve, ka të drejtën e administrimit, përdorimit dhe disponimit të lirë mbi pasurinë e tij. Në rast se gjatë martesës, njëri nga bashkëshortët i beson tjetrit administrimin e pasurisë së tij, zbatohen rregullat e përfaqësimit.

---

<sup>48</sup>Neni 90 i K.F

<sup>49</sup>Neni 94

<sup>50</sup>Neni 91 i K.F

<sup>51</sup>Neni 95 i KF

<sup>52</sup>Neni 97

<sup>53</sup>Neni 111 i KF

Nëse njëri nga bashkëshortët administron pasurinë e bashkëshortit tjetër, me dijeninë e këtij të fundit dhe pa pasur kundërshtim nga ana e tij, konsiderohet se ka marrë një mandat të heshtur, i cili mbulon veprimet lidhur me administrimin, por jo ato të disponimit<sup>54</sup>.

Përsa i përket veprimeve të **administrimit lidhur me banesën**, Kodi i Familjes parashikon një garanci më tepër, pavarësisht regjimit të zgjedhur, duke e vecuar atë nga pasuria tjetër. Bashkëshortët nuk mund të disponojnë banesën bashkëshortore dhe pajisjet e saj pa pëlqimin e tjetrit, cilido qoftë regjimi pasuror martesor. Bashkëshorti që nuk ka dhënë pëlqimin për veprimin juridik të kryer nga tjetri, lidhur me banesën bashkëshortore, mund të kërkojë anulimin e tij brenda 1 viti nga data kur ai ka marrë njoftim për këtë veprim juridik, por jo më tepër se 1 vit nga data që regjimi pasuror martesor ka marrë fund<sup>55</sup>. Pra banesa bashkëshortore merr një status të vecantë pavarësisht nëse është pasuri vetjake apo e përbashkët. Kjo dispozitë është shumë pak e njohur në praktikë nga gratë të cilat gjenden shpesh përballë tjetërsimeve të bashkëshortëve pa u marrë pëlqimin.

**Sa i përket bashkëjetesës** Kodi i Familjes njeh mundësinë për të lidhur marrëveshje përpara noterit ku të përcaktohen pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës. Në këtë rast, të drejtat pronësore pasurore rregullohen sipas dispozitave të KC mbi bashkëpronësinë.<sup>56</sup>

### c. Të drejtat e gruas në administrimin e pasurisë së fëmijës

Të drejtat pasurore të grave duhet të shihen edhe në kuadër të administrimit të pronës së fëmijëve të tyre të mitur, në cilësinë e nënës. Kodi i Familjes rregullon çështjen e administrimit të pasurisë së të miturit nga ana e prindërve të tij, duke u njohur atyre të drejta dhe përgjegjësi të njëjta kundrejt fëmijëve, si përsa i takon të drejtave personale ashtu edhe atyre pasurore. Ai u njeh prindërve, pa bërë dallim në gjininë e tyre, të drejtën e administrimit dhe të përdorimit të pasurisë së fëmijës së tyre.<sup>57</sup>

Pasuria e të miturit që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç administrohet nga prindërit në dobi të fëmijës, kurse pasuria e të miturit që ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç administrohet nga vetë i mituri, por gjithmonë me pëlqimin paraprak të prindërve. Administrimi i pasurisë së fëmijës bëhet nga të dy prindërit bashkërisht, në rastin kur ata e ushtrojnë përgjegjësinë prindërore bashkërisht dhe në rastet e tjera ose nga i ati apo nga nëna nën

---

<sup>54</sup>Neni 117 dhe 118 | K.F

<sup>55</sup>Neni 57 | KF

<sup>56</sup>Neni 162 dhe neni 163 | K.F

<sup>57</sup>Neni 231 | K.F



kontrollin e gjykatës. Ndërkohë e drejta e përdorimit të pasurisë së fëmijës u takon të dy prindërve bashkërisht ose atij që është i ngarkuar me administrimin e pasurisë së fëmijës<sup>58</sup>.

Kodi i Familjes<sup>59</sup> përmend disa prej veprimeve juridike mbi pasurinë e paluajtshme të fëmijës së mitur, duke vënë si kusht për kryerjen e tyre interesin i të miturit dhe autorizimin e gjykatës. Veprimet që lidhen me administrimin përfshijnë: tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme, lënien hipotekë të kësaj pasurie, ngarkimin me një barrë të pasurisë, marrjen hua në emër të të miturit, heqjen dorë nga trashëgimia apo legu ose mospranimin e një dhurimi, si dhe përgjithësisht veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit.

Këto veprime juridike, në rast se janë kryer pa u marrë autorizimi i gjykatës, mund të shpallen të pavlefshme. Prokurori, prindi ose kujdestari i të miturit, kanë të drejtë që sipas Kodit të drejtshëm gjykatës me një kërkesë për shpalljen e pavlefshëm të veprimit juridik të kryer. Nëse pala e interesuar, për një veprim juridik të kryer pa autorizim, i drejtohet gjykatës, me kërkesë, dhe gjykata e jep pëlqimin më vonë lidhur me veprimin juridik të kryer, atëherë veprimi juridik nuk shpallet i pavlefshëm<sup>60</sup>.

Pavarësisht se ligji nuk bën dallime midis të dy prindërve, nga praktika rezulton që kryesisht veprimet për administrimin e pronës së paluajtshme të fëmijës kryhen nga babai i tyre. Nëna mund të kryejë veprime të tilla administrimi në rastet kur ajo është kryefamiljare, në rastet e mungesës së babait për shkak të vdekjes apo divorcit, si dhe kur ka kujdestarinë e fëmijës.

#### **d. Administrimi i pronës dhe zhvillimi ekonomik i gruas (Kredia, huaja bankare, ndihma hipotekare dhe forma të tjera të kreditit financiar)**

Administrimi efektiv i pronës nga gruaja është i lidhur ngushtësisht me zhvillimin ekonomik të gruas dhe rolin e saj në shoqëri dhe familje. Një pjesë e rëndësishme e administrimit të pronës është edhe përdorimi i saj për përfitimin e kredive, huave bankare, ndihmës hipotekore dhe formave të tjera të kreditit financiar. Është shumë e rëndësishme që, me qëllim të bëhet realitet barazia në martesën dhe marrëdhëniet familjare, të edukohen aspektet e autonomisë financiare dhe kontraktore të bashkëshortëve. Kjo mungesë autonomie bëhet pengesë dhe kufizon seriozisht aftësinë e grave për të siguruar pavarësi ekonomike për veten dhe fëmijët e saj dhe për të përdorur format e kredisë financiare.

Kërkesa për kredi dhe huamarrje në pjesën dërrmuese të tyre merren nga burrat. Ata janë individët që veprojnë me cilësinë e kryefamiljarëve. Pranohet gjerësisht se gratë kanë vështirësi

---

<sup>58</sup>Neni 236 I K.F

<sup>59</sup>Neni 234 i Kodit të Familjes

<sup>60</sup>Neni 234 I Kodit të Familjes

për të marrë kredi financiare për shkak se zotërojnë shumë pak pasuri të paluajtshme. Për këtë arsye, gratë perceptohen se kanë rol mbështetës në ekonominë e familjes. Gjithashtu, për shumë banka politika e huasë kërkon që aplikuesi/sja të ketë kapital, ndërsa në të vërtetë pak gra e kanë një gjë të tillë. Mungesa e informacionit kontribuon gjithashtu në paaftësinë për të përdorur efektivisht bankat.

Në legjislacionin bankar, përfshirë edhe aktet rregullatore të Bankës së Shqipërisë, apo edhe Manualet dhe Rregulloret për kredidhënien të bankave të nivelit të dytë, nuk ka ndonjë specifikë dalluese favorizuese për femrat. Ndërkohë duhet nënvizuar se gjithashtu nuk ka asnjë klauzolë ligjore, rregullatore apo teknike, që të bëhet pengesë për gratë. Megjithatë, pranohet se pengesë në këtë drejtim përbën mentaliteti i zonës, ku grua nuk mund të jetë e pavarur ekonomikisht dhe të mund të ndërmarrë iniciativa të tilla që implikojnë pasurinë e familjes.

*Do te përpunohet/detajohet edhe mëtej pas marrjes se informacionit nga Banka e Shqipërisë.*

## **5. Aksesi në drejtësi në mbrojtje të të drejtave të pronësisë dhe statusi aktual i përpunimit të të dhënave zyrtare**

### *a. Aksesi në gjykatë dhe praktika gjyqësore*

Garantimi i aksesit në drejtësi përbën një nga elementët bazë të funksionimit të shtetit të së drejtës. Ai është i lidhur ngushtë me respektimin e të drejtave të njeriut dhe përbën bazën e mbrojtjes së të drejtave kushtetuese dhe ligjore. Vetëm nëpërmjet një sistemi juridik të aftë për të garantuar, jo vetëm aksesin në drejtësisë, por mbi të gjitha mbrojtjen efektive të të drejtave, mund të pranohet se sistemi gjyqësor luan rolin e tij në një shtet ligjor.

Legjislacioni shqiptar parashikon mundësitë që gratë t'i drejtohen gjykatës. Koncretisht, Kodi Civil parashikon padinë e pjesëtimit të sendit, të cilat mund të përdoren nga gratë për të kërkuar përcaktimin e pjesës së tyre nga një pasuri në bashkëpronësi. Megjithatë, praktika gjyqësore ka treguar se këto padi kryesisht paraqiten gjatë zgjidhjes së martesës ose pas tyre. Frenimi i grave për të kërkuar pjesëtimin e pasurisë edhe gjatë martesës lidhet kryesisht me zakonet e zonës, ku pasuria e familjes, ashtu si edhe vetë kjo e fundit, janë një dhe e përbashkët. Gratë shpesh hasin vështirësi në kërkimin e pjesës së tyre të pasurisë për shkak se pasuria e paluajtshme kryesisht, pavarësisht kontributit të gruas në krijimin e saj, janë të regjistruara në emër të bashkëshortëve.

Nga ana tjetër, gratë nuk kanë as informacionin e duhur mbi ekzistencën e mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave të tyre pronësore. Ky tregues i mosnjohjes së të drejtave të tyre pronësore i pengon gratë që të kërkojnë vetadministrimin e pasurisë së tyre, duke i krijuar mundësinë burrit

që të kryejë administrimin e pronës së përbashkët në mënyrën që ai vlerëson të përshtatshme dhe duke shpërfillur vullnetin e gruas.

Një tjetër shkak që mund të cenojë aksesin e gruas në drejtësi, për të kërkuar të drejtat e tyre pronësore është edhe mungesa e mjeteve financiare të pavaruara. Padijeni dhe mungesa e informacionit të gruas mbi të drejtat e veta të pronësisë mund të kompensohet nëpërmjet kërkesës për asistencë juridike pranë një avokati. Por ky shërbim është i kushtueshëm dhe për pasojë gratë duhet të posedojnë mjetet të mjaftueshme financiare për të kërkuar mbrojtjen me avokat.

Për këtë arsye, edhe aksesin në drejtësi është i ndërlidhur me faktorët që pengojnë gruan në gëzimin e të drejtave të veta pronësore. Edhe pse ligjërisht ekzistojnë mundësitë që grua të ketë akses në drejtësi, faktorë të tjera kanë impakt në realizimin efektiv të kësaj të drejtë. Mungesa e pasurisë apo e mjeteve financiare të pavaruara është një faktor përcaktues që passjell vështirësi në përdorimin e rrugës gjyqësore për kërimin e të drejtave pronësore.

#### ***b. Aksesin në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme***

Kërkues në ZRPP për regjistrimin e një pasurie të paluajtshme apo për përfitimin e shërbimeve të tjera që ofron ky institucion mund të jenë edhe gratë. Por, në praktikë vërehet se mungesa e informacionit mbi rregullat që përmban legjislacioni në fuqi, apo largësia e vendndodhjes së institucionit nga qendra e banimit, vecanërisht për zonat rurale, passjell një pengesë reale në drejtësi të aksesit të gruas në ZRPP. Megjithatë, ligji nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” nuk përmban asnjë pengesë në drejtësi të aksesit, procedurat burokratike apo vështirësitë që shoqërojnë në praktikë procesin e regjistrimit, bëjnë që gratë të ndjehen në pamundësi për të ndjekur të vetme këto procedura.

Në drejtësi të aksesit në ZRPP, hap përpara vlerësohet dixhitalizimi i procesit të regjistrimit, i cili shmang kontaktet e vijueshme me punonjësit e ZRPP dhe thjeshton procedurat e aplikimit për përfitimin e shërbimit. Por edhe në këtë rast, mungesa e informacionit për gratë në zonat rurale, mbi mënyrën e përdorimit të sistemeve elektronike mund të bëhet pengesë serioze për akses real në ZRPP.

Kreu VII i ligjit nr. 33/2012 parashikon edhe rregullat për aksesin në informacionin e poseduar nga ZRPP. Pronari ose personi që provon se ka interes legjitim, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë të marrë të dhëna dhe kopje të dokumenteve, që janë në regjistrat e pasurive të paluajtshme, kartela, në harta kadastrale, në dokumentacione të depozituara me kërkesën për regjistrim dhe në dokumentacionin që mbahet e administrohet nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Megjithatë, në mungesë të regjistrimit të gruas si bashkëpronare në pasurinë e përbashkët, sepse në pjesën më të madhe të rasteve përpara hyrjes në fuqi të ligjit të ri

pasuria e venë gjatë martesës regjistrohej në emrin e burrit, aplikimi i kësaj dispozite në praktikë mund të hasë vështirësi përsa i përket marrjes së informacionit. Kjo për faktin se shprehja “person që ka interes legjitim” i krijon mundësi funksionarit publik që në raste kur vlerësohet prej tij të refuzojë kërkesën për informacion.

### *c. Statusi aktual i përpunimit të të dhënave zyrtare*

Një nga problematikat e vazhdueshme që haset në Shqipëri është statusi i përpunimit të statistikave zyrtare. Kultura e përpunimit të statistikave, si tregues i domosdoshëm për formulimin e politikave dhe evidentimit në praktikë të problematikeve, është ende e dobët në Shqipërisë. Nga ana tjetër, edhe në rastet kur statistikave mbahen, metodologjia për mbledhjen apo përpunimin e tyre nuk është në përputhje me standardet e kërkuara. Në fakt, mungesa e statistikave mbi çështjen objekt të këtij studimi, edhe për faktin se bëhet fjalë për një zonë të posacme, sic është zona e bregdetit të jugut, ka qenë vështirësia kryesore e tij. Në këtë kuptim mund të themi se përpunimi i statistikave zyrtare është ende i dobët dhe jo në përputhje me funksionin që ato duhet të luajnë.

**Ministria e Drejtësisë** është një nga institucionet që publikon Vjetorin Statistikor të të dhënave gjyqësore. Mirëpo, nga analiza e këtij vjetari rezulton se mungon informacioni mbi ndarjen e çështjeve civile apo llojit të padive mbi baza gjonore. Kjo mungesë informacioni lidhet ngushtësisht edhe me mënyrën e përpunimit të statistikave nëpër **gjykata**. Mbledhja dhe përpunimi i statistikave bëhet në mënyrë manuale dhe ende nuk është i dixhitalizuar. Për këtë qëllim, një nga aplikacionet e përfshira në portalin e ri të gjykatave [www.gjykatat.gov.al](http://www.gjykatat.gov.al) është edhe gjenerimi automatik i të dhënave statistikore. Mirëpo, ende portali nuk ka mundur të prodhojë rezultate në këtë drejtim, edhe për faktin se fillimi nga funksionimi i tij daton vonë.

Nga ana tjetër, Ministria e Drejtësisë, edhe pse ka një Drejtor të posacme për koordinimin e çështjeve të pronësisë, nuk ka parashikuar një strukturë apo nëpunës të vecantë për të përpunuar statistika në fushën e pronësisë. Përpunimi i këtyre statistikave, do të ndihmonë të gjitha institucionet në formulimin e politikave të sakta dhe të qarta për adresimin e problematikës që haset në këtë fushë. Nga ana tjetër, gjenerimi i të dhënave mbi baza gjonore, nuk është i aplikueshëm, fakt ky që pamundëson vlerësimin mbi baza statistikore të gjendejes së respektimit të të drejtave pronësore të grave.

**Noterët** janë funksionarët publik, të cilëve i është deleguar ushtrimi i kompetencave për të bërë redaktimin dhe hartimin e akteve noteriale. Duke qenë profesion i lirë, me karakter publik, noterët duhet të luajnë rolin edhe të burimit të informacionit për institucionet publike. Aktualisht, në zyrat noteriale nuk mbahen të dhëna mbi llojet dhe numrin e akteve noteriale apo veprimeve noteriale të kryera, apo të dhëna mbi baza gjonore. Të dhënat mbi baza gjonore do të mundësonin vlerësimin realisht të pjesëmarrjes së gruas në kryerjen e transaksioneve. Megjithatë, plani

ambicioz për dixhitalizimin e sistemit të noterisë, jo vetëm nëpërmjet krijimit të Sistemit “One Stop Shop”, por mbi të gjitha nëpërmjet krijimit të regjistrimit elektronik noterial, duhet domosdoshmërisht të shoqërohet edhe me aplikacionet për gjenerimin e statistikave të plota, përfshirë edhe statistikave mbi baza gjinore.

Aktualisht edhe **Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme** nuk gjeneron të dhëna statistikore mbi baza gjinore. Në sistemin elektronik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme është përfshirë aplikacioni i gjenerimit të të dhënave statistikore, por rezultatet e tij janë ende të paprekshme, për shkak edhe të kohës së shkurtër të funksionimit të tij. Mbajtja e statistikave zyrtare nga ZRPP do të mundësonte një panoramë të qartë të raportit të gruas me pasuritë e paluajtshme. Vetëm nëpërmjet tyre mund të kuptohet realisht gjendja pasurore e grave.

**INSTAT**, ndonëse është institucion i krijuar me ligj për gjenerimin dhe përpunimin e statistikave zyrtare, aktualisht nuk disponon statistika përse i përket të drejtave pronësore të grave. Ky është një konstatim shqetësues, për shkak se INSTAT ka në përbërje të tij personel të specializuar jo vetëm për mbledhjen dhe administrimin e statistikave, por edhe për përpunimin dhe interpretimin e tyre. Në këtë drejtim, vlerësohet e domosdoshme që INSTAT të gjenerojë statistika me bazë gjinore, vecanërisht përse i përket statusit ekonomik të gruas, duke përfshirë edhe të drejtat pronësore të saj.

Roli i **organizatave jofitimprurëse** në një shoqëri demokratike është domethënëse. Leximi dhe interpretimi i statistikave prej tyre bëhet në mënyrë të pavarur dhe mund të japë rezultat në drejtim të ndërmarrjes së politikave të duhura, në mbrojtje të të drejtave të grave në përgjithësi, dhe të drejtave pronësore të tyre në vecanti. Megjithatë, organizatat jofitimprurëse nuk janë në gjendje për të gjeneruar vetë të dhëna statistikore, sepse për këtë kërkohet domosdoshmërisht kontributi i institucioneve shtetërore. Në këtë drejtim, mos gjenerimi i të dhënave nga institucionet shtetërore paraqet impaktin e tij edhe në mungesën e gjenerimit të të dhënave nga ana e OJF-ve për çështjet që lidhen me të drejtat pronësore të grave.

#### **KAPITULLI IV: STUDIM MBI NJOHURITË DHE PERCEPTIMIN E GRAVE MBI TË DREJTAT E PRONËSISE DHE KAUDRIN LIGJOR AKTUAL**

*Ky kapitull do të plotësohet me të dhënat dhe analizën e përgatitur nga IDRA. Në funksion të të dhënave dhe përmbajtjes së analizës së përgatitur nga IDRA do të vlerësojmë në këto të dhëna do të përfshihen në Kapitull më vete apo do të integrohen në pjesën përkatëse të analizuar më sipër.*

## KAPITULLI V: KONKLUSIONE

*Kapitulli V dhe VI do të detajohen edhe mëtej pasi Konkluzione dhe Rekomandime më të sakta dhe konkrete mund të japim vetëm pasi të kemi marrë edhe të dhënat dhe analizën e përgatitur nga IDRA. Konkluzionet e paraqitura paraprakisht janë vendosur me qëllim orientues.*

### 1. Kuadri ligjor

Nga analiza e legjislacionit mbi barazinë gjinore por edhe ligjeve specifike që garantojnë të drejtat e pronësisë apo trashëgimisë, vërehet se ka një përpjekje për të mos bërë dallim në gëzimin e të drejtave midis burrave dhe grave. Legjislacioni njeh të drejtat e pronësisë individuale mbi pasurinë e paluajtshme si dhe të drejtën për ta gezuar dhe trashëguar në mënyrë të lirë ate. Ajo që bie në sy është që sa i përket pronësisë një sërë ligjesh njohin të drejtat individuale mbi pronën, të njëjta si për burrat, gratë, në cilësinë e bashkëshortëve apo fëmijëve, një sërë ligjesh kanë njohur dhe të drejtën pronësore të familjes, si entitet.

Fillimisht pronësia e familjes bujqësore mbi tokën është instaluar nga ligji nr. 7501 “Për tokën” dhe më pas edhe vete Kodi Civil njeh familjen bujqësore si kategori që gëzon në bashkëpronësi pasurinë që i përket kësaj familjeje, përfshirë tokën bujqësore, jobujqësore, pyjet, kullotat apo livadhet.

Në fakt problem nuk qëndron në njohjen e dy llojeve të pronësisë, asaj individuale apo familjare, por në mundësinë për të ushtruar në mënyrë të njëjtë të gjitha tagrat që rezultojnë nga e drejta e pronësisë. Për më tepër nën efektin e normave zakonore lidhur me të drejtat e pronësisë, ka një diferencë jo të vogël midis të drejtave që garanton ligji dhe të drejtave që perceptohen si të tilla. Pra me fjalë të tjera ka një diferencë midis të drejtave pronësore të garantuara nga legjislacioni dhe të drejtave *de facto* të pronësisë.

Ligjet nuk kanë përjashtuar nga e drejta e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme gratë, megjithatë influenza e normave zakonore apo influence që vazhdon të ketë, sidomos në zonat rurale familja patriarkale, kanë bërë që shpesh anëtarë të caktuar të familjes, si gratë apo vajzat, të mos ushtrojnë në mënyrë efektive të drejtat e pronësisë apo të mos kenë influencë mbi përdorimin apo disponimin e pasurive. Shpesh padijeni con në perceptimin se të drejtat e pronës për to nuk njihen apo janë të cinguara.

Në këtë kuptim, përsa i përket njohjes së të drejtës së pronësisë për gruan, edhe pse legjislacioni shqiptar përgjithësisht paraqitet i plotë, për shkak edhe të influencës që ka e drejta ndërkombëtar, formulimin i garancive të qarta për ushtrimin efektiv të saj, nëpërmjet mekanizmave që crrënjisin zakonet apo mentalitetet, me parashikimeve ligjore të detyrueshme për zbatim, do të

ishite e nevojshme. Influenca që ka e drejta zakonore apo tradita në këtë çështje, është e tillë që pamundëson ushtrimin e të drejtës së pronësisë nga gruaja sipas parashikimeve aktuale ligjore.

## **2. Kuadri institucional**

Shqipëria ka një sërë institucioneve të cilat aktualisht trajtojnë çështjet e pronësisë. Shpesh, ekzistenca e shumë institucioneve duhet sikur krijon mbivendosje kompetencash dhe sjell një konfuzion në përcaktimin e rolit të gjithësecilit. Megjithatë, krijimi i një strukture të posacme koordinimi për të gjitha institucionet që trajtojnë çështjet e pronës duket të jetë një hap pozitiv përpara.

Pavarësisht kësaj, roli i institucioneve mbikëqyrëse për të gjitha agjencitë qeveritare që trajtojnë çështjet e pronave duhet të forcohet dhe të ketë në fokus të tij edhe mbikëqyrjen e respektimit të të drejtave të pronësisë së grave. Nga ana tjetër, noterët duhet të kryejnë verifikime të plota në rastin e tjetërsimit të pasurive për të vlerësuar nëse prona është në bashkëpronësi edhe të gruas, dhe nëse vullneti i saj është shprehur në rastin konkret. Gjithashtu, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme duhet të tregojë kujdesin e duhur për regjistrimin e pronave të vënë gjatë martesës si pronë e përbashkët e të dy bashkëshortëve. Një tjetër çështje me interes është forcimi i kapaciteteve dhe zhvillimi i trajnimeve për stafin e institucioneve që trajtojnë çështjen e të drejtave pronësore të grave.

Mbledhja dhe administrimi i të dhënave statistikore është një aspekt që kërkon reformim të thellë, me qëllim krijimin e të dhënave të mjaftueshme që kontribuojnë në hartimin dhe përpilimin e politikave të sakta për adresimin e problematikave të hasura. Kryerja nga ana e institucioneve e vlerësimeve periodike mbi situatën e të drejtave pronësore të grave do të forconte rolin e tyre në garantimin me efikasitet dhe promovimin e të drejtave pronësore të grave.

## **3. Politika sociale dhe ekonomike**

Ndërgjegjësimi i grave për të njohur të drejtat e tyre duhet të jetë e vazhdueshme jo vetëm përmes aktiviteteve të OJF por edhe këshillimit bërë prej institucioneve siç janë noterët, avokatët, zyrtarë të ZRPP. Mungesa e ushtrimit me efikasitet të të drejtave të pronësisë nga ana e grave bën të pamundur forcimin e rolit të tyre në shoqëri, si dhe forcimin dhe pavarësinë ekonomike të tyre.

Është e domosdoshme të theksohet se kjo situatë është burimi kryesor i pozitës jo të fortë të grave në shoqëri. Për këtë qëllim, nevojiten politika të qarta sociale dhe ekonomike që promovojnë rolin e gruas në zhvillimin ekonomik të vendit, duke respektuar të drejtat pronësore

të tyre. Mbështetja e gruas në kërkimin e të drejtave të saj, si dhe ushtrimin me efikasitet të tyre, do të ishte një hap përpara drejt forcimit të rolit të gruas në shoqëri. Ndjenja e inferioritetit dhe mungesa e informacionit mbi çështjet në interes të saj, passjellim mohimin e të drejtave pronësore të gruas në disa raste.

## **KAPITULLI VI:REKOMANDIME:**

*Kapitulli V dhe VI do të detajohen edhe mëtej pasi Konkluzione dhe Rekomandime më të sakta dhe konkrete mund të japim vetëm pasi të kemi marrë edhe të dhënat dhe analizën e përgatitur nga IDRA. Rekomandimet e paraqitura paraprakisht janë vendosur me qëllim orientues.*

### **1. Kuadri ligjor dhe aplikimi i tij në praktikë**

- ▶ Duhet të rishikohen aspektet ligjore lidhur me dispozitat lidhur me familjen bujqësore, institutin e trashëgimisë, probleme të pasurisë bashkëshortore gjatë martesës dhe në mbarim të saj, çështjet e aksesit në kredi, aspekte të lidhura me administrimin e pasurisë së të miturve, apo mundësinë e frenimit të ndikimeve që ka e drejta zakonore në çështjen e të drejtave pronësore të grave.
- ▶ Duhet të tregohet një rol i posacëm në hartimin e një legjislacioni me mekanizma të qarta të garantimit të zbatimit në praktikë të të drejtave pronësore të grave.
- ▶ Respektimi si dhe promovimi barazisë gjinore, në procesin e regjistrimit të pronave, në aspektin ligjor dhe praktik.
- ▶ Vlerësimi i legjislacionit ekzistues me qëllim harmonizimin dhe thjeshtëzimin e tij, respektimin e barazisë gjinore dhe ndërmarrja e nismave të reja ligjore në fushën e të drejtave të pronësisë.
- ▶ Duhet treguar kujdes i vecantë në zbatimin nga gjykata të legjislacionit, me qëllim që të forcohet besimi i grave tek sistemi gjyqësor dhe rritja e aksesit të tyre në drejtësi.
- ▶ Forcimi mekanizmave ligjore për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional.

### **2. Ndryshimi praktikave dhe sjelljeve**

- ▶ Ndërgjegjësimi i gruas dhe shoqërisë mbi të drejtat pronësore të grave.
- ▶ Trajnime të stafëve të institucioneve që merren me të drejtat e pronësisë, fushata sensibilizuese për informimin dhe promovimin e të drejtave të grave.



- ▶ Noterët duhet të kryejnë në cdo rast, verifikimin e statusit juridik të pasurisë, për të vlerësuar nëse është apo jo pasuri e vënë gjatë martesës, si dhe të kërkojnë pëlqimin e gruas në rastet e tjetërsimit të pasurive të paluajtshme.

### **3. Hartimi i politikave të reja**

- ▶ Hartimi i politikave të reja, që kanë në fokus gëzimin dhe administrimin e pronës nga gruaja, nëpërmjet parashikimit të mundësive për fuqizimin e rolit të gruas në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e statusit social të saj.
- ▶ Hartimi i politikave zhvillimore, që kanë në fokus gruan dhe promovimin e të drejtave pronësore të saj.
- ▶ Mbledhja, përpunimi dhe administrimi i statistikave të plota mbi këtë çështje, si bazë për formulimin e politikave reformatore mbi të drejtat pronësore të gruas.